



Njohuri dhe teknika specifike për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore

Manual për Ofruesit e Shërbimit Psiko-Social në shkolla

Manual për ofruesit e shërbimit psiko-social në shkollë “Njohuri dhe teknika specifike për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të DHBGJ”

Manuali u përgatit nga:

Dr. Daniela Kalaja

Msc. Etleva Sheshi

Dr. Eliona Bimbashi (Kulluri)

“Realizimi i këtij Manuali u bë i mundur në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi DHBGJ”, me mbështetjen financiare të UNICEF Shqipëri dhe fondeve të Qeverisë Suedeze. Përmbajta e këtij manuali është përgjegjësi e vetme e Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë – Shqipëri, e cila jo domosdoshmërisht pasqyron politikën e UNICEF-it.



© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara të Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	5
HYRJA	9

KAPITULLI I

KONCEPTET E DHUNËS NË FAMILJE, DHUNËS ME BAZË GJINORE, ABUZIMIT TË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

9

1.1 Dhuna në Familje dhe format e shfaqjes së saj	10
1.2 Dhuna me bazë gjinore /Dhuna ndaj gruas dhe faktorët nxitës të saj	13
1.3 Abuzimi i fëmijëve dhe adoleshentëve dhe format e abuzimit	20

KAPITULLI II

SHENJAT E FORMAVETË NDRYSHME TË ABUZIMIT TEK FËMIJËT ADOLESHENTËT DHE TEKNIKA TË IDENTIFIKIMIT TË RASTIT.....

35

2.1 Treguesit e formave të ndryshme të abuzimit	37
2.2 Pasojat e abuzimit dhe profili i fëmijëve të abuzuar	40
2.3 Fëmijët/adoleshentët në rrezik dhe profili i familjeve në rrezik të lartë të abuzimit	51

KAPITULLI III

MENAXHIMI I RASTIT

55

3.1 Menaxhimi i rastit, procesi i menaxhimit të rastit	55
--	----

3.2 Parimet bazë të menaxhimit të rastit dhe modelet teorike mbi menaxhimin e rastit	63
3.3 Ndërtimi i një plani ndërhyrje për menaxhimin e rastit, trajtimi shumëplanësh	69

KAPITULLI IV

SISTEMI I MBROJTJES SË FËMIJËVE NË SHQIPËRI

4.1 Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	77
4.2 Mekanizmat në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve	88

KAPITULLI V

TEKNIKA TË INTERVISTIMIT DHE KËSHILLIMIT TË

FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

5.1 Teknika të intervistimit dhe këshillimit	97
5.2 Intervistimi dhe këshillimi i fëmijëve dhe adoleshentëve	126
5.3 Intervistimi dhe këshillimi i rasteve të abuzimit	131

KAPITULLI VI

PUNA ME GRUPET PËR NDËRGJEGJËSIM DHE PARANDALIM ..

6.1 Grupet edukuese	137
6.2 Grupet e rritjes.....	139
6.3 Grupet socializuese	140

LISTA E REFERENCAVE

SHTOJCA

ORGANIZATAT DHE STREHËZAT QË PUNOJNË ME

VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

LISTA E SHKURTIMEVE

SHKPS	Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë
SHPSSH	Shërbimi Psiko-social në Shkolla
PSHPSSH	Punonjësit e Shërbimit Psiko-Social në Shkolla
KSH	Këshillues Shkollorë
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
MR	Menaxhimi i Rastit
PI	Plane Individuale
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër Mbrojtje i Menjëhershëm

HYRJE

Shërbimi psiko-social në shkolla, si një strukturë relativisht e re në vendin tonë dhe me një rëndësi të veçantë në adresimin e një sërë problematikash që lidhen me mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve, luan një rol të rëndësishëm edhe në identifikimin, trajtimin dhe referimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore të adoleshentët.

Referuar studimit “*Vlerësimi i kapaciteteve të këshilluesve shkollorë mbi dhunën me bazë gjinore*” (SHKPS, 2013), rezultoi që DHBGJ tashmë është prezente tek adoleshentët në mjediset e shkollës dhe shpesh ofruesit e SHPSSH gjenden përballë një fenomeni jo shumë të hasur dhe shpeshherë të paqartë për mënyrat e identifikimit, trajtimit apo stukturat e referimit. Nisur nga nevojat e identifikuar, por edhe gjatë sesioneve të trajnimit me këshilluesit shkollorë, u pa i nevojshëm hartimi e një manuali pune lidhur me DHBGJ.

Manuali për punonjësit e Shërbimit psiko-social në shkolla “*Njohuri dhe teknika specifike për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të DHBGJ*” është i fokusuar kryesisht në njohuritë dhe aftësitë e punës me rastet e DHBGJ, identifikimin dhe adresimin e nevojave psiko-sociale të këtyre rasteve, mbështetjen e viktimave/fëmijëve/adoleshentëve me këshillim dhe referim në shërbime të specializuara.

Manuali synon:

- Të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive të ofruesve të shërbimit psiko-social në shkolla në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore midis

fëmijëve dhe adoleshentëve;

- *Të rrisë kapacitetet e ofruesve të SHPSSH në trajtimin dhe referimin e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në mesin e adoleshentëve.*

Ky manual do të jetë një bazë e mirë informacioni për ofruesit e shërbimit psiko-social në shkolla(SHPSSH) dhe do të ndikojë në rritjen e nivelit të njohurive dhe forcimin e aftësive të PSHPSSH me rastet e DHBGJ me fokus të veçantë tek adoleshentët dhe do të shërbejë si një instrument për SHPSSH jo vetëm për procesin e trajnimit por edhe në punën e tyre të përditshme me këto raste.

Manuali i drejtohet të gjithë ofruesve të shërbimit psiko-social në shkolla (psikologë dhe punonjës social) dhe specialistëve të tjerë të fushës, në punën e tyre me rastet e DHBGJ tek fëmijët dhe adoleshentët.

KAPITULLI I

KONCEPTET E DHUNËS NË FAMILJE, DHUNËS ME BAZË GJINORE, ABUZIMIT TË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Hyrje

Ky kapitull synon të përforcojë dhe thellojë tek këshilluesit shkollorë kuptimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore si dhe të krijojë një kuptueshmëri më të mirë dhe një përcaktim të unifikuar të konceptit të abuzimit të fëmijëve/adoleshentëve dhe formave të këtij abuzimi si ai fizik, seksual, emocional, psikologjik, neglizhimi, shfrytëzimi dhe trafikimi.

Dhuna manifestohet në shumë forma dhe të gjithë janë të rrezikuar, që në çaste të caktuara të jetës së tyre, të preken nga forma të caktuara të dhunës. Ajo prek fëmijët, të rriturit, të moshuarit, nuk ka dallim në seks, besim, vendndodhje gjeografike, klasë, status apo nivelin e të ardhurave. Dhuna manifestohet në shumë mjedise, si familje, shkollë, lagje, komunitet, mes fëmijëve, madje edhe në forma ekstreme, si lufta apo në konflikte. Fëmijët dhe adoleshentët, për fat të keq, janë një nga grupet më të prekura dhe më vulnerabël ndaj dhunës, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Ata mund të preken nga dhuna e bashkëmoshatarëve, e prindërve, e mësuesve, e të rriturve të tjerë apo e komunitetit. Ata dëmtohen dhe dhunohen psikologjikisht, edhe nëse ekspozohen dhe janë të pranishëm ndaj dhunës, si p.sh. në familje apo në shkollë, pavarësisht se mund të mos ushtrohet dhunë e drejtpërdrejtë fizike ndaj tyre. Dhuna dhe abuzimi ndaj fëmijëve, mund të manifestohet në forma të ndryshme, si p.sh. shfrytëzimi për punë, lypje, punët e rënda dhe trafikimi i fëmijëve.

Dhuna ndaj fëmijëve merr forma të ndryshme dhe ndikohet nga një seri faktorësh të ndryshëm, nga karakteristikat personale të viktimës dhe dhunuesit, nga kultura dhe mjedisi fizik ku ndodh, etj. Duhet mbajtur parasysh se një pjesë e madhe e dhunës ndaj fëmijëve mbetet e pa raportuar, për shumë arsye. Progresi i punës në

fushën e mbrojtjes së fëmijëve kërkon njohjen dhe pranimin nga të gjithë, që dhuna, keqtrajtimi, abuzimi ndodhin në forma dhe mënyra të ndryshme dhe se nevoja për ti njohur këto forma abuzimi, shenjat, si dhe pasojat e tyre është e madhe. Ka një sërë faktorësh, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhunën ndaj fëmijëve. Këtu mund të përmenden faktorë si proceset e socializimit që në moshë të hershme për fëmijët, varfëria, përjashtimi social, përkatësia gjinore, socializimi gjinor, aspektet e përkatësisë etnike, kulturës dhe aftësitë e kufizuara të fëmijës, të cilët janë disa nga faktorët specifikë që ndikojnë në rritjen apo zvogëlimin e vulnerabilitetit të një fëmije ndaj dhunës dhe abuzimit.

I.1 DHUNA NË FAMILJE DHE FORMAT E SHFAQJES SË SAJ

Familja përfaqëson një sistem kompleks të mbështetur mbi respektin, besimin dhe solidaritetin. Pra, në thelbin e vet familja mbështetet në një sistem ndjenjash, të cilat jo gjithnjë janë pozitive. Ndjenja të tilla negative si urrejtja, dhuna, etj., bëhen burim për sjellje devijante brenda familjes.

Familja përfaqëson njësinë sociale, ku mbrojtja e anëtarëve të saj është me mundësi maksimale, por në të njëjtën kohë, për shkak të ndjenjave negative, rrezikon të shndërrohet në njësinë me rrezikshmëri të lartë fizike e psikike, për anëtarët e saj.

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si “një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë” (QAGJZH, 2006).

Dhuna në familje është një fenomen global dhe prek të gjitha shtresat e popullsisë; të rinj dhe të moshuar, të arsimuar apo analfabetë, të martuar apo beqarë; prek çdo kombësi, klasë, racë apo grup etnik. Ajo përfshin dhunimin e të drejtave qytetare, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale. Të dhënat alarmante nga e gjithë bota lidhur me shkallën e dhunës në familje konfirmojnë faktin se dhuna në familje është një epidemi ndërkombëtare.

Disa arritje në adresimin e dhunës në familje në nivel botëror:

- Kuptim më i mirë i dhunës në familje, shkaqeve dhe pasojave të saj;
- Është arritur një konsensus ndërkombëtar për nevojën e adresimit të saj;
- Hapa pozitive të ndërmarra nga disa shtete për përmirësimin e

- legjislacionit ekzistues apo hartimit të ligjeve specifike për dhunën;
- Disa rajone kanë hartuar konventa specifike për adresimin e dhunës në familje. Aktualisht po bëhen përpjekje edhe në rajonin tonë për hartimin e një konvente për këtë qëllim, në kuadrin e Këshillit të Evropës.

Disa shqetësime dhe mangësi në trajtimin e dhunës në familje:

- Dhuna në familje është një krim që është i paraportuar dhe si rrjedhojë ka mangësi të dhënash mbi përhapjen e tij;
- Është e vështirë të dihet e vërteta në lidhje me dhunën në familje në vende të ndryshme për shkak të disa faktorëve kryesorë: natyra e fshehtë dhe konsiderimi i saj si çështje private; niveli i ulët i raportimit, si dhe raste të rralla të përcaktimit të dhunës në familje si krim duke mos u paraqitur kështu në të dhënat zyrtare;
- Mungesë ose pamjaftueshmëri trajnimesh për institucionet e drejtësisë, të policisë dhe shëndetësisë;
- Mungesa e informacionit lidhur me të drejtat e grave dhe të fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut;
- Mungesa e besimit tek institucionet e drejtësisë;
- Mungesa e rrjeteve të shërbimeve dhe ekipeve multidisiplinare në trajtimin e tyre;
- Progresi në adresimin e dhunës në familje ka qenë i ngadaltë, sepse mentaliteti, qëndrimet dhe sjelljet janë të rrënjësura thellë edhe janë të vështira për t'u ndryshuar.

Format e shfaqjes së dhunës në familje. Ekzistojnë disa forma të dhunës në familje, ndër të cilat më poshtë janë renditur ato më të përhapurat. Shpesh këto forma të ndryshme të dhunës në familje hasen të gërshetuara me njëra-tjetrën (QAGJZH, 2006).

Dhunë Fizike përfshin: shtyrje, goditje, gërvishtje, mbylljen në shtëpi, goditje me objekte të forta, kërcënim me thikë ose me armë tjetër, refuzim për ta ndihmuar viktimën kur është shtatzënë ose e sëmurë, tentativa për vrasje deri në formën më të rëndë vrasjen. Dhuna fizike në përgjithësi ushtrohet duke filluar nga format më të lehta për të arritur deri tek ato më ekstremet.

Dhuna Psikologjike/Emocionale përfshin talljet, kërcënimet, ndjekjen nga pas, mohimin e hapësirës për të marrë vendime, ndalimi për dalë

me shoqërinë apo dhe për të dalë vetëm, kritikën e vazhdueshme ndaj kulturës apo zakoneve, sharjet ndaj viktimës në shtëpi dhe në publik, ngarkimin me faj të viktimës për çdo gjë që shkon keq, kontrollin ndaj veshjes dhe garderobës, etj.

Dhuna Shpirtërore gjithashtu përfshihet në dhunën psikologjike dhe lidhet me ndalimin e shprehjes së besimit fetar ose normave kulturore, traditave dhe besimit shpirtëror.

Dhuna Seksuale përfshin marrëdhënien seksuale me forcë, trajtimin e partneres/partnerit si objekt seksual, detyrimin për të bërë seks pa dëshirën e partneres/partnerit, detyrimin për të realizuar seks në forma të padëshiruara dhe të papranueshme për partneren/partnerin, këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka që dëshiron partneri/partnerja, detyrimin për të bërë seks me një partner/partnere tjetër, realizimi i marrëdhënieve seksuale me një partnere tjetër në sy të bashkëshortes/bashkëshortit, deklarimi për një lidhje jashtëmartesore, detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike, detyrimi për të bërë prostitucion, detyrimi për të bërë striptizëm, etj.

Sulmi Seksual është një kontakt seksual jo-konsensual që nuk e përfshin penetrimin.

Dhuna Ekonomike përfshin, kontrollin e parave në mënyrë që të mos i lihet viktimës mundësia për të marrë vendime për çështje ekonomike, dhënia e një vlefte të vogël parash që nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme, refuzimi për të mbuluar shpenzimet e fëmijëve, forcimi për të vjedhur ose shitur gjërat e vlefshme, mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të bashkëshortes/bashkëshortit, etj.

Referuar statistikave të Institutit të Mjeksisë Ligjore dhe Policisë së Shtetit, situata e llojeve të dhunës dhe mes kujt ndodh paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Viti	Marrëdhënie seksuale me dhunë nën 14 vjeç	Marrëdhënie seksuale me dhunë mbi 14 vjeç	DHF	Dhunë nga persona të tjerë
2010	2	20	98	316
2011	3	7	107	253
2012	4	12	93	351
2013	4	14	141	321

Tabela 1. Llojet e dhunës

Dhuna në familje nuk ka të bëjë vetëm me dhunën ndaj njërit prej bashkëshortëve, e cila në më të shumtën e rasteve është e drejtuar ndaj gruas. Në konceptin e dhunës në familje sot përfshihen dhe nënkuptohen dhuna ndaj grave, dhuna e prindërve ndaj fëmijëve, dhuna midis fëmijëve, dhuna e fëmijëve, kryesisht e adoleshentëve ndaj prindërve, si dhe dhuna ndaj të moshuarve. Dhuna ndaj grave dhe dhuna ndaj fëmijëve ka tërhequr historikisht vëmendjen e studiuesve dhe të specialistëve të fushës. Dhuna ndërmjet fëmijëve, dhuna e fëmijëve ndaj prindërve, si dhe dhuna ndaj të moshuarve kanë marrë më pak ose aspak vëmendje nga studiuesit dhe specialistët. Kjo nuk do të thotë se këto forma të dhunës në familje janë më pak shqetësuese për publikun e gjerë dhe se ky i fundit nuk ka interes të informohet për to. Tashmë është një realitet se dhuna në familje, ndonëse është një problem që filloi të shihej me shqetësim nga publiku vetëm në mesin e shekullit të kaluar (vitet 60-të), ka kaluar nëpër një proces të gjatë përkufizimi, përcaktimi dhe identifikimi.

Përkufizimi i “viktimës” dhe i “të mbijetuarës”. Në këtë manual do të përdoren shpesh terma të tilla si “viktimë” dhe “i/e mbijetuar”. Në literaturën e sotme që citon vazhdimisht çështje të lidhura me dhunën me bazë gjinore, vihet re një parregullsi në përdorimin e termave të mësipërme. Shpjegimi i kësaj parregullsie vjen si rezultat i një ambivalence në të kuptuarin dhe në të diferencuarin e këtyre dy koncepteve që në pamje të parë duket se përfaqësojnë të njëjtën gjë: individin që është nën efektin e marrëdhënies abuzive. Ajo që më parë është konsideruar si “viktimë” për shkak të paafësisë për të dalë nga situata, më vonë është konsideruar si “e mbijetuar” që zotëron potencialin e nevojshëm për ndryshim. Pra, konotacioni në rastin e “të mbijetuarës” është më pozitiv se në rastin e “viktimës”.

Termi “viktimë” do të përdoret për t’iu referuar individit (gruaja, fëmija apo burri) i cili ndodhet ende në marrëdhënien abuzive; të cilin e karakterizon një ndërgjegjësim minimal ose mungesë ndërgjegjësimi për mënyrën sesi trajtohet nga të tjerët.

Termi “i/e mbijetuar” do të përdoret për t’iu referuar individit që ka bërë hapin e parë për t’u shkëputur nga marrëdhënia abuzive; të cilin e karakterizon një ndërgjegjësim i mjaftueshëm për të ndërmarrë hapat e ndryshimit.

1.2 DHUNA ME BAZË GJINORE DHE FAKTORËT NXITËSTË SAJ

Dhuna me bazë gjinore e cila më shpesh lidhet me dhunën ndaj grave ndikon negativisht në miliona fëmijë çdo vit dhe shpesh është e shoqëruar nga

forma të ndryshme të dhunës (verbale, fizike, emocionale dhe psikologjike), e cila shkatërron jo vetëm jetë dhe familje, por edhe shoërinë në një nivel më të gjërë. Shumica e burrave (të cilët janë statistikisht edhe më shpesh abuzuesit) përveç dhunës kundrejt bashkëshortes, shpesh ushtrojnë dhunë dhe ndaj fëmijëve dhe kjo dukuri ka pasojë negative në të gjithë komunitetin përreth.

Në vitin 2013, Instituti i Statistikave së bashku me Programin e Kombeve të Bashkuara dhe UNDP ndërmorën një studim kombëtar mbi dhunën në familje.¹ Ky vërtetim kombëtar, tregoi se nga 2590 gra të intervistuar, të paktën 56% pohuan se kishin pësuar një nga format e dhunës në familje. Lidhur me faktorët e riskut, studimi i nxori në pah se gratë të cilat nuk punonin jashtë shtëpisë kishin dukshëm shumë më tepër mundësi të përjetonin abuzim emocional sesa gratë të cilat punonin jashtë shtëpisë në kohën e studimit (82,5% kundrejt 4,3%); gratë me arsim universitar (46,0%) kishin më pak gjasa të përjetonin abuzim psikologjik krahasuar me gratë me arsim të mesëm (56,2%), me arsim nëntëvjeçar (56,9%), me arsim fillor (62,5%) dhe me ato të paarsimuara (66,7%). Po ashtu gratë me arsim universitar kishin shumë më pak gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht apo të abuzoheshin emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë me një nivel më të ulët arsimor. Gratë me arsim fillor (70,4%) ishin ato që raportuan më së shumti dhunën fizike të ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti/partneri i tyre. Gratë në zonat rurale, dëshmonin më shumë për dhunën emocionale dhe fizike, sesa gratë që jetonin në qytet. Është e dokumentuar tashmë se gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një formë të dhunës në familje,—emocionale, psikologjike, fizike ose seksuale, por shpeshherë ato përjetojnë njëherazi forma të shumfishta të dhunës. Abuzimi emocional është një parashikues i llojeve të tjera të abuzimit dhe dhunës në martesën ose lidhjen intime. 82% deri në 88% e grave të cilat kishin përjetuar dhunën në familje raportuan se dhuna — emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës ose të bashkëjetesës me bashkëshortin ose partnerin intim. Nga gratë që raportuan paaftësi për të punuar për shkak të prerjeve, maviosjeve dhe dhembjeve, 81,6% kishin vuajtur paaftësi të përkohshme për punë për një deri në katër ditë.

Problematike mbetet fakti se gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë nga organe të specializuara. 90,7% kanë kërkuar ndihmë nga familja e tyre, 34,0% kanë kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/ partnerit të tyre dhe 13,9% kanë kërkuar ndihmë nga të afërm të tjerë. Pra, nga ky studim vihet re ende një hezitim i grave për ta ngritur problemin e tyre përtej rrethit

¹ INSTAT; UNDP (2013), “Dhuna në familje në Shqipëri: Vërtetim kombëtar me bazë popullatën”

familjar. Dhuna në familje ndaj grave nuk ndodh gjithmonë nga bashkëshortët/partnerët aktualë ose të mëparshëm. Anëtarë të tjerë të familjes (p.sh. prindërit, vëllezërit, motrat, krushqit dhe të afërm të tjerë) kryejnë akte të dhunës fizike ndaj grave. Edhe pse shpeshherë dhuna pakësohet me zgjidhjen e martesës, 60% deri në 67% e grave të divorcuara ose të ndara, raportuan se aktualisht ato përjetonin një nga format e abuzimit emocional, krahasuar me 85% deri në 96% të grave të martuara ose të atyre që jetonin me një partner intim.

Shpesh dhuna ndaj grave dhe ajo ndaj fëmijëve bashkëjetojnë në familje. Fëmijët janë viktimat e harruara të dhunës në familje. Në vrojtim u konstatua se prej 146 fëmijëve që kishin qenë të pranishëm në akte dhune në familje, vetëm 23,6% i kanë thënë dikujt për këtë dhunë. Nga i njëjti vrojtim raportohet se nga 991 fëmijët e anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes. Fëmijët në zonat rurale (66,4%) kishin më shumë gjasa që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes krahasuar me fëmijët në zonat urbane (50,4%). Në dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve u vunë re edhe dallime gjinore. Kështu, djemtë kishin më shumë gjasa se vajzat të përjetonin dhunë fizike në familje. Në përputhje me konkluzionet e literaturës botërore se gratë e dhunuara kanë më shumë gjasa të dhunojnë fëmijët e tyre sesa gratë që nuk përjetojnë dhunë, vrojtimi vuri në dukje se dhuna ndaj fëmijëve ushtrohej kryesisht nga nëna (ose njerka), e pasuar nga babai (ose njerku) dhe vëllezërit e motrat. Gjithashtu, vihet re se baballarët dhunojnë më shumë djemtë e tyre sesa vajzat, ndërsa nënat dhunojnë më shumë vajzat, sesa djemtë, gjë që mund të jetë një tregues i ndarjeve gjinore të roleve të prindërve në “disiplinimin” e bijve apo bijave të tyre. Një fakt tjetër me rëndësi që u evidentua nga vrojtimi kombëtar i dhunës ishte lidhja mes nivelit arsimor të bashkëshortit me dhunën ndaj gruas. Gratë të cilat raportonin se nuk dhunoheshin emocionalisht, psikologjikisht, fizikisht apo seksualisht nga bashkëshorti, më së shumti raportonin edhe se bashkëshorti i tyre ishte me arsim të lartë.

Sipas statistikave të Policisë së Shtetit, situata e rasteve të dhunës paraqitet si në tabelën e mëposhtme. Për vitin 2014, rritja e besimit të komunitetit në strukturat e policisë ka sjellë edhe rritjen e numrit të denoncimeve, dhe rasteve të trajtuara me Urdhëra Mbrojtje, siç evidentohet më poshtë:

Viti	Raste të Evidentuara	Trajtuar me kërkesë -padi UMM/UM	Raste/DHkG	Raste/dhunë ndaj fëmijëve	Shkelje të UM
2010	1998	1234	1660	120	93
2011	2181	1345	1779	98	86
2012	2526	1562	2036	58	119
2013	3020	1851	2346	108	138
janar-qershor 2014	1893	1147	1448	95	64

Tabela 2. Situata e dhunës në vëndin tonë(Policia e Shtetit)

Lidhur specififikisht me dhunën ndaj gruas apo asaj që njihet ndryshe si dhuna me bazë gjinore sipas Institutit të Mjeksisë Ligjore, vihet re një rritje e rasteve ndër vite edhe tek femrat apo adoleshentet deri në 14 vjeç. Situata paraqitet si mëposhtë:

Viti	Femra nën 14 vjeç	Femra mbi 14 vjeç
2010	12	424
2011	17	353
2012	19	441
2013	18	462

Tabela 3. Situata e dhunës ndaj gruas(Instituti i Mjeksisë Ligjore)

“Dhuna ndaj grave është ndoshta shkelja më e turpshme e të drejtave të njeriut dhe ndoshta më e përhapura. Ajo nuk njihet kufi gjeografik, kulturor ose ekonomik. Sa kohë që vazhdon dhuna, ne nuk mund të pretendojmë se po bëjmë një progres të vërtetë drejt barazisë, zhvillimit dhe paqes” Kofi Anan, Ish - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara

Deklarata “Për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas” (DVAW) bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e paraqet dhunën si: “Një akt i bazuar në përkatësinë gjinore që rezulton në, ose mund të rezultojë në: lëndime fizike, seksuale apo psikologjike ose vuajtje të grave. Duke përfshirë kërcënime apo akte të tilla, detyrime apo nëvlefësime arbitrare, që ndodhin në jetën personale apo publik”

Në 1993, Deklarata e Vienës dhe Programin për Veprim, përkufizon dhunën ndaj grave si *“një akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton në dëmtim fizik, seksual ose psikologjik ose vuajtje të grave duke përfshirë kërcënimin për akte të tilla, shtrëngim ose deprivim të paarsyeshëm të lirisë, që ndodhin si në jetën private ashtu dhe në atë publike”* Ky përcaktim përfshin dhunën në familje, brenda komunitetit, si dhe dhunën e kryer nga shteti.

Një tjetër përcaktim për dhunën ndaj gruas është dhënë në Konventën e Eliminimit të Diskriminimit Ndaj Gruas (CEDAW) duke e njohur dhunën si: *“një manifestim i marrëdhënieve historikisht jo të barabarta mes burrave dhe grave”* si dhe e cilëson dhunën si *“një mekanizëm kryesor nga i cili gratë janë detyruar të qëndrojnë në një pozicion më të ulët krahasuar me burrat”* (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, 48/104, 1993.)

Sipas së drejtës ndërkombëtare, shtetet mbajnë përgjegjësi të parandalojnë, të hetojnë dhe të dënojnë dhunën kundër grave, si dhe të sigurojnë që viktimat marrin mjetet e duhura dhe dëmshpërblim, pavarësisht nëse akti është kryer nga agentë shtetërorë apo nga një person privat (Rekomandimi i përgjithshëm nr.19, neni 8; DVAW, neni 4)

Prevalenca e dhunës ndaj grave ndryshon shumë midis komuniteteve dhe vendeve të ndryshme. Përhapja e dhunës me bazë gjinore është kaq e lartë dhe ndodhia e saj kaq e shpeshtë, sa që gratë kanë zhvilluar një sindromë varësie, duke injoruar kapacitetet e tyre për të jetuar normalisht. Ky fakt e bën këtë çështje një problem thelbësor në procesin e zhvillimit.

Mënyra se si një shoqëri e caktuar reagon kundrejt dhunës së ushtruar ndaj grave është pasqyrë e rëndësishme për të kuptuar mënyrën se si ajo nënkupton marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave, sjelljet e tyre, mënyrën e tyre të bashkëveprimit brenda një konteksti të caktuar.

Ta konsiderosh dhunën ndaj grave, qoftë atë fizike apo psikologjike, brenda apo jashtë familjes në vendin e punës apo në rrugë, si një problem politik dhe social që krijon alarm në opinionin publik dhe të cilit i duhet dhënë përgjigje, kjo është një fitore, është rezultat i një procesi kulturor shumë kompleks të cilit tashmë gratë i kanë dhënë jetë.

1.2.1 Shkaqet e dhunës ndaj gruas/dhunës me bazë gjinore

Në thelb të kuptimit të dhunës ndaj gruas qëndron marrëdhënia gjinore që i imponohet gruas për shkak të hierarkisë shoqërore të roleve gjinore, të seksit dhe rolit riprodhues të saj, hierarki që e kthen gruan në pronë të burrit (ose këtë të dytin në “mbrojtës” apo edhe “disiplinues” të saj) (Kulluri. E., 2008).

Në qendër të marrëdhënies, siç shihet, qëndron *pushteti* dhe dhuna mbi bazën e përkatësisë gjinore ushtrohet pikërisht për të ruajtur pozitën superiore, pavarësisht nga ngjyrimet që kjo dhunë merr sipas kontekstit kulturor, politik dhe socio-ekonomik. Përgjithësisht kemi të bëjmë me një bashkëveprim forcash ku spikat tendenca mashkullore për dominim dhe pushtet. Një marrëdhënie e këtij lloji e vë gruan në një pozicion të vështirë dhe në kushtet e një vendi si Shqipëria, shpesh shoqërohet me varësi thuajse totale ekonomike, emocionale, pa mundësi zgjedhjeje dhe jete private.

Të gjithë kemi lindur meshkuj ose femra, dhe seksi ynë mund të përcaktohet thjesht duke parë organet tona seksuale. Por çdo kulturë ka mënyrat e saj për të vlerësuar vajzat dhe djemtë dhe për t'ju caktuar atyre role, përgjegjësi dhe attribute të ndryshme. I gjithë “paketimi” shoqëror dhe kulturor që bëhet për vajzat dhe djemtë që nga lindja e në vazhdimësi, pra procesi i socializimit quhet “gjinizim.”

Çdo shoqëri ngadalë transformon një mashkull ose femër në një burrë apo grua, në mashkullor dhe femërore, me cilësi, modele sjellje, role, përgjegjësi, të drejta dhe pritje të ndryshme. Ndryshe nga seksi, i cili është biologjik, identitetet gjinore të grave dhe burrave janë të përcaktuara psikologjikisht dhe shoqërisht - që do të thotë historikisht dhe nga ana kulturore.

“Përkatësia gjinore” është një çështje kulture, që i referohet klasifikimit social të grave dhe burrave në ‘mashkullorë’ dhe ‘femërorë.’” Që njerëzit janë meshkuj ose femra, kjo zakonisht mund të gjykohej duke iu referuar fakteve biologjike. Që ata janë mashkullorë dhe femërorë nuk mund të gjykohej në të njëjtën mënyrë: kriteret janë kulturore, që ndryshojnë në kohë dhe hapësirë. Qëndrueshmëria e seksit duhet pranuar, por gjithashtu edhe ndryshueshmëria e përkatësisë gjinore. “Përkatësia gjinore nuk ka origjinë biologjike, se lidhjet mes saj dhe seksit nuk janë aspak “të natyrshme”.

Roli dhe ndikimi i familjes në nivelin e dhunës në familje forcohet duke pasur parasysh dhe stereotipet lidhur me rolin e gruas dhe burrit në shtëpi, mitet që ushqejnë këtë dhunë dhe mentalitetin tradicional patriarkal që e mban gjallë dhe mbështet këtë dhunë. Dhuna me bazë gjinore është e lidhur ngushtë me rolet gjinore tradicionale që mësohen përmes procesit të socializimit.

Më poshtë analizohen disa nga shkaqet kryesore të dhunës ndaj gruas:

Përkufizimi i rolit të gruas/bashkëshortes në shoqëri: mjedisi ynë social-kulturor mbart vlera e botëkuptime patriarkale të trashëguara, si i tillë rëndon shumë pozicionin e grave, historikisht të rritura nën një traditë diskriminuese

gjinore. Gjithashtu vlerat kulturore që i tolerojnë sjelljet e dhunshme ndaj gruas e lehtësojnë ushtrimin e dhunës.

Papunësia apo stresi në punë: gjendja e vështirë që shkakton papunësia, ashtu si dhe pakënaqësia ndaj punës ose pagës, mund të ndikojë në gjendjen emocionale të burrit, sidomos duke vënë në pikëpyetje (në perceptimin e tij) zotësinë dhe aftësinë e tij si burrë dhe kryefamiljar, e cila mund të shprehet me sjellje të dhunshme ndaj gruas, duke riafirmuar kështu pushtetin e tij.

Varësia ekonomike e gruas: mentaliteti patriarkal ka pasoja të rënda edhe në varësinë ekonomike të gruas, që megjithëse detyrohet të mos punojë për të rritur fëmijët apo sepse kështu dëshiron partneri, konceptohet si barrë për t'u mbajtur. Varësia ekonomike kthehet në një thikë me dy presa për faktin se kjo varësi bëhet shkas për ushtrim dhune nga partneri dhe në të njëjtën kohë e pengon atë të largohet kur ushtrohet dhunë e vazhdueshme mbi të.

Ndjenja paaftësie: shumë meshkuj kur e gjejnë veten në rolin e kryefamiljarit, ndjehen të paaftë për t'i përmbushur me sukses detyrimet që i veshin këtij roli, dhe shumë shpesh ndjehen fajtorë apo të turpëruar. Këto ndjenja mund të çojnë në sjellje të dhunshme ndaj bashkëshortes.

Një kompleks faktorësh kulturorë, socialë, ekonomikë dhe personalë bëjnë që familja shqiptare të jetë e rrezikuar nga dhuna. Shumë njerëz mund të nxjerrin në pah ndjenjat e tyre agresive, në vend që t'i shprehin ato në mënyra jo të dhunshme. Përveç atyre që përmendëm më lart, *disa faktorë të tjerë mund të jenë:*

Shkaqe individuale - Që kanë të bëjnë me karakteristika dhe probleme të personalitetit si: varësia emocionale; papjekuria; kontrolli i dobët i vetes; ndjenja e inferioritetit; xhelozia; impotencia seksuale; konkurrenca intelektuale, profesionale dhe arsimore; vështirësi në mbajtjen e përgjegjësisë për veten; etj. Gjithashtu, për disa njerëz, dhuna kthehet në një mënyrë për të fituar fuqi dhe kontroll mbi anëtarët e tjerë të familjes.

Stresi - Shqetësimet në punë, paaftësia profesionale, problemet ekonomike, marrëdhëniet problematike, shtatëzënia e padëshiruar, mund të bëjnë që një person të ndjehet i tejngarkuar nga ana emocionale dhe kështu mund të shpërthejë në sjellje të dhunshme. Abuzimi i alkoolit dhe drogës gjithashtu ndihmon në përkeqësimin e situatës.

Gjithashtu mund të përmendim të tjerë faktorë stresantë që ndikojnë në shtimin e dhunës në familje si: numrin e madh të fëmijëve; bashkëjetesën në familje me disa kurora; ndërhyrjet në jetën e çiftit; prindërimi i vetëm; kufizimet

në mundësitë për një jetë normale; sëmundje të zgjatura apo kronike; vdekja e ndonjë personi të afërt; etj.

E kaluara e familjes - Studimet kanë treguar se shumë njerëz mësojnë të sillen në mënyrë të dhunshme me pjesëtarët e familjes, gjatë rritjes së tyre. Për shembull, fëmijët e abuzuar kur rriten, mund të manifestojnë dhunë ndaj familjes së tyre. Në shoqërinë shqiptare, e kaluara e dhunshme e familjeve të prejardhjes është një nga faktorët kryesorë që ndikon në lindjen dhe shtimin e sjelljeve të dhunshme brenda familjeve të reja.

Izolimi - Me komunikimin dixhital në shoqërinë e sotme, shumë njerëz vuajnë pasojat e një izolimi social, pra humbin kontaktin emotiv me familjen dhe miqtë, të cilët janë burimet kryesore të mbështetjes emocionale për të cilën secili nga ne ka nevojë. Këta njerëz mund të ndihen të vetmuar, pa ditur kujt t'i drejtohen për ndihmë dhe kjo mund të çojë në sjellje të dhunshme brenda familjes.

Pabarazitë gjinore - Gjithashtu, mënyra se si shoqëria e konsideron dhunën në përgjithësi dhe si reflektohet nga media, varfëria dhe papunësia, pabarazitë gjinore, niveli i lartë i stresit, rënia e konsiderueshme e nivelit të arsimimit, humbja e besimit në institucionet shtetërore, vështirësitë në zbatimin e ligjit mbi dhunën në familje, modelimi i sjelljeve agresive që shfaqen në sferën politike, mungesa e shërbimeve në mbështetje të familjeve, paqëndrueshmëria politike dhe ekonomike, varfëria, etj, janë faktorë që ndikojnë në shtimin e dhunës.

1.3 ABUZIMI I FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE DHE FORMAT E ABUZIMIT

Abuzimi i fëmijëve nuk është një fenomen i ri për shoqërinë moderne. Ai është ndeshur që në fillimet e shoqërisë njerëzore. Kështu, Ligji Romak i jepte babait të drejtë absolute mbi fëmijën. Kjo e drejtë kuptohej si një e drejtë për të vepruar mbi fëmijën me çdo mjet. Në Mesjetë fëmijët me prapambetje mendore digjeshin në turrën e druve (Haxhiymeri. E., Kulluri. E., Hazizaj. A., 2005).

Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore kanë ndryshuar dhe evoluar edhe sjelljet e qëndrimet ndaj fëmijëve. Prindërit në të shumtën e rasteve, ju kanë ofruar kujdes fëmijëve të tyre dhe kanë siguruar kështu mbijetesën e qenieve njerëzore. Pavarësisht nga diferencat kulturore, fetare apo morale rreth mënyrës së edukimit dhe rritjes së fëmijës, abuzimi i tyre asnjëherë nuk është pranuar nga shumica e shoqërisë. Familja është konsideruar gjithmonë

si institucioni që është përgjegjës për rritjen e fëmijës dhe jo për abuzimin e tij. Shtete të ndryshme kanë përjetuar periudha eksperiencash të ndryshme lidhur me qëndrimet ndaj abuzimit të fëmijëve.

Gjatë shekullit të kaluar qëndrimi ndaj problemeve të abuzimit të fëmijëve mori një kthesë të plotë. Mendimi psikologjik që gjatë kësaj periudhe shënoi një zhvillim epokal, theksoi për herë të parë rëndësinë kritike të moshës së fëmijërisë në zhvillimin e personalitetit dhe të karakterit të individit. Psikologët që në atë kohë dhe vazhdimisht po vënë theksin në përdorimin e metodave sa më njerëzore në edukimin e fëmijëve. Megjithatë shumë vende të botës e kanë të ndaluar me ligj abuzimin e fëmijës, prapë se prapë ai vazhdon të përdoret nga prindërit për qëllime disiplinimi. Ndërkohë autorë të ndryshëm vazhdojnë të debatojnë rreth problemit të përkufizimit të asaj se çfarë mund të konsiderohet abuzim i fëmijëve dhe çfarë disiplinim, dhe se a mund të vendoset një kufi ndarës midis këtyre dy lloj qëndrimeve.

Për herë të parë diskutimi rreth problemit të abuzimit të fëmijës u bë publik në vitet '60 të shekullit të kaluar, atëherë kur Frojdi botoi veprën e tij "Fëmija i dhunuar" që u pasua nga vepra "Sindroma e fëmijës së abuzuar" e Helfer dhe Kempe. Që nga ajo kohë interesi i publikut për problemet që lidhen me abuzimin e fëmijëve ka ardhur duke u rritur.

Edhe në vendin tonë qëndrimet lidhur me këtë problem kanë ndryshuar në vite. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar por, edhe në fillimet e shekullit të ri, probleme të tilla si abuzimi i fëmijëve, abuzimi i grave, trafikimi i qenieve njerëzore për qëllime përfitimi, prostitucioni, e të tjera si këto janë bërë pjesë e diskutimeve, debateve, shkrimeve dhe publikimeve, kërkimeve, politikave dhe shërbimeve në funksion të grupeve të rrezikuara.

Trajtimi i problemit të abuzimit të fëmijëve në Shqipëri si një problem social ka një histori jo shumë të gjatë. Ky problem filloi të diskutohej gjatë viteve '90, atëherë kur lëvizja qytetare nisi të merrte jetë si rezultat i ndryshimeve politike që po ndodhnin në vend. Interesi i publikut, i strukturave shtetërore dhe i specialistëve u rrit ndjeshëm falë punës së shumë organizatave jo-qeveritare të cilat jo vetëm organizuan fushata sensibilizimi në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, viktimat të dhunës, por dhe ofruan të parat shërbime psiko-sociale dhe mbështetje ligjore.

Nga pikëpamja sociologjike legjitimiteti i një problemi social kërkon domosdoshmërisht studimin e shkallës dhe përmasave të kërcënimit që ky problem i bën shoqërisë. Probleme si ky i abuzimit të fëmijëve, i cili përfshin shumë aspekte dhe që në shumicën e rasteve mbahet i fshehur, janë probleme të vështira për t'u diagnostikuar në mënyrë që të posedojmë një pamje reale

të realitetit social. Fakti që ky problem as që është diskutuar më parë, por edhe është mbajtur i mbyllur, i heshtur, e bën edhe më të vështirë studimin e tij. Duke qenë se interesi për problemin e abuzimit të fëmijëve ka qenë në nivele të ulta, sot ose nuk gjenden ose ka fare pak të dhëna dhe shifra statistikore për të ilustruar përmasat e problemit. Studimi më i mundshëm është ai që mund të bëhet mbi bazën e rasteve të trajtuara në shërbimet e ngritura për t'ju ardhur në ndihmë kësaj kategorie fëmijësh, ose dhe mbi bazën e opinioneve të testuara mbi bazë pyetësorësh.

Vitet e fundit situata e abuzimit të fëmijëve duket se ka ndryshuar. Gjithnjë e më shumë organizata dhe institucione të ndryshme kanë iniciuar aktivitete që synojnë uljen e frekuencës së dhunës ndaj fëmijëve. Problemi i abuzimit të fëmijëve po diskutohet gjithnjë e më shpesh në media duke ndihmuar edhe në shtimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët. Megjithëse ende nuk ka një sistem të specializuar për të ndihmuar fëmijët, dhe se ndryshimet në legjislacion janë bërë të domosdoshme për t'u realizuar në mënyrë që të zbatohen standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, fakti që shteti nuk ka më monopolin mbi problemet sociale, ka dhënë efektet e veta edhe në këtë aspekt të jetës së individit.

Përkufizimi operacional i abuzimit të fëmijëve. Në Shqipëri, mund të thuhet se përkufizimet ekzistuese të cilave ju referohen punonjësit në çdo hallkë të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, në aspektin ligjor apo klinik, janë së pari të pamjaftueshme dhe së dyti, nuk ka një marrëveshje për përdorimin e termave.

Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (2006)², me gjithë ndryshimet që solli, nuk arriti ta zgjidhë këtë situatë. Ky ligj sjell në nenin 1 përkufizimin e dhunës dhe dhunës në familje: 1. ‘Dhunë është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik’ dhe 2. ‘Dhunë në familje është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare’. Përkufizimi përfshin dhe dhunën ndaj fëmijëve, por kufizohet vetëm në dhunën në familje, është i pa detajuar dhe ligji nuk është specifikisht vetëm për fëmijët. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë në vitin 1999, përkufizimi i dhunës është si më poshtë:

“Abuzimi apo keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, lënien pas dore apo trajtimin neglizhues,

2 Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’. (2008, Korrik). Aksesuar në shtator 2008, nga <http://www.stopdhunes.org/wp-content/uploads/2008/07/ligji-nr-9669-date-18122006-kunder-dhunes-ne-familje.pdf>.

shfrytëzimin komercial apo i ndonjë lloji tjetër që shkakton dëmtim aktual apo të mundshëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënie përgjegjësie, besimi apo pushteti.”

Abuzim i fëmijës do të konsiderohet çdo lloj forme e keqtrajtimit ose neglizhencës që shkakton si pasojë dëmtimin ose plagosjen e fëmijës, e cila nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme. Abuzimi i fëmijës përfshin: abuzimin fizik, emocional dhe seksual, si dhe neglizhencën. Dhuna ndaj fëmijëve shfaqet dhe realizohet në disa forma: emocionale, fizike, seksuale dhe në formën e neglizhencës (Haxhiymeri. E., Kulluri. E., Hazizaj.A., 2005). Në praktikën e trajtimit të fëmijëve të dhunuar vihet re se nuk ka raste të pastra të një forme të dhunës. Dhuna tek fëmijët takohet në forma ku ndërthuren të gjitha ose disa nga format së bashku. Përkufizimet e mëposhtme ju referohen formave kryesore të abuzimit dhe kjo është bërë me qëllim që lexuesit të kuptojnë më mirë shkaqet që çojnë në forma të ndryshme të dhunës ashtu sikurse edhe karakteristikat specifike që fitojnë fëmijët që përjetojnë një ose disa nga këto forma.

Abuzim fizik do të konsiderohet çdo veprim, i cili rezulton në traumë jo-aksidentale, dëmtim ose plagosje të fëmijës. Dhuna fizike përfaqëson dhunim trupor të pa-arsyetuar ose një dënim të pajustificuar. Kjo ndodh zakonisht kur një prind ose kujdestar i nervozuar ose frustruar godet, shkund ose hedh tutje fëmijën. Dëmtimet nga abuzimi fizik vijnë si pasojë e goditjes me grushta, shkelma, rrahjes, djegies dhe çdo veprim tjetër që shkakton dëmtim tek fëmija. Ndonëse këto dëmtime mund të ndodhin tek fëmija aksidentalisht kur ai / ajo luan, abuzimi fizik duhet të dyshohet se ndodh në rastet kur dëmtimi ose plagosja e fëmijës nuk mund të justifikohet thjesht nga loja, ose nga shpeshësia e ndodhjes së tyre. Sa më shumë të zgjasë abuzimi, aq më serioze do të bëhen dëmtimet tek fëmija, dhe akoma më e vështirë bëhet eliminimi i sjelljes abuzive.

Goditja me shuplakë shpesh konsiderohet si një veprim që i shërben disiplinimit të fëmijës, por që në fakt është një formë e abuzimit të fëmijës, pavarësisht nëse lë shenja apo jo. Përdorimi i forcës fizike si dënim shkërmoq nevojat e fëmijëve për dashuri dhe e dëmton gjithë botën e fëmijës. Abuzimi fizik konfirmon edhe një herë dobësinë e moshës fëmijnore, frikën e fëmijës për mbrojtjen e tij dhe realitetin e pavarësisë së tij. Në shumë raste prindërit pasi i bërtasin fëmijës, nuk mundet t'i kontrollojnë më emocionet e tyre, dhe në vend që të mundohen të kuptojnë fëmijën dhe t'i shpjegojnë sjelljet e tyre, përdorin forcën fizike. Këto sjellje shpesh e justifikojnë me vendosjen e disiplinës prindërore. Abuzimi prek çdo lloj moshe tek fëmija nga lindja e tij deri në moshën 18 vjeç.

Abuzim seksual do të konsiderohet çdo lloj përdorimi i fëmijës për qëllime ose kënaqësi seksuale. Abuzimi seksual ndikon negativisht në zhvillimin normal dhe shëndetësor të fëmijës, si në drejtimin emocional ashtu edhe atë fizik. Shpesh fëmijët viktimë të abuzimit seksual vuajnë shqetësime të rënda emocionale nga ndjenja e tyre e turp, fajit, ose ndjenja të tjera të cilat shoqëria i imponon atyre. Në ekstremin e abuzimit seksual, përfshihet edhe marrëdhënia seksuale me fëmijën si dhe derivatet e saj. Këto sjellje mund të jenë veprimet finale të një abuzimi që ka nisur më parë. Për këtë arsye dhe për shkak të efekteve shkatërruese, ekzibicionizmi (tregimi i organeve seksuale), prekja dhe çdo kontakt tjetër seksual me fëmijën, do të konsiderohen abuzim seksual.

Abuzimi seksual ndodh në të gjitha shtresat e popullsisë, në zonat rurale dhe urbane, me nivele të ndryshme social-ekonomike dhe kulturore. Shkalla e dëmtimit të fëmijës varet nga natyra e abuzimit, mosha e fëmijës, dhe mjedisi që rrethon fëmijën. Dëmtimet që ka femija nuk janë vetëm dëmtimet e dukshme por edhe dëmtime të brendshme që e shoqërojnë fëmijën tërë jetën e tij/saj.

Llojet e abuzimit seksual

Veprime seksuale jo-prekëse, përfshijnë: Shfaqja ose tregimi i organeve seksuale; Ekspozimi i fëmijës përpara materialeve pornografike; Ekspozimi në mënyrë të qëllimshme i fëmijës i një marrëdhënieje seksuale; Masturbimi përpara fëmijës.

Veprime seksuale prekëse, përfshijnë: Ledhatimin, përkëdheljen e fëmijës, ose organeve seksuale të tij/saj; Detyrimi / ftesa ndaj fëmijës që të prekë organet seksuale të një të rrituri; Çdo lloj penetrimi në vaginën ose anusin e fëmijës me objekte, të cilat nuk janë për qëllime mjekesore.

Veprime seksuale shfrytëzuese, përfshijnë: Përfshirjen e fëmijës në prostitucion; Përdorimi i fëmijës për filma, fotografi ose modele pornografike.

Abuzim psikologjik/emocional do të konsiderohet çdo veprim i prindit ose kujdestarit që konsiston në përçmimin sistematik të fëmijës dhe që dëmton në mënyrë serioze zhvillimin e tij. Abuzimi emocional (psikologjik) është një nga format më pak të studiuar në Shqipëri të abuzimit të fëmijës, ndonëse është një nga format më të rënda dhe më destruktive të të gjitha llojeve të abuzimit.

Meqënëse abuzimi emocional godet psikikën e fëmijës dhe konceptin e fëmijës për vetveten, ku viktimë e shëh veten si të pavlerë për dashuri dhe afeksion nga familja. Fëmijët që në mënyrë të vazhdueshme ndjehen të turpëruar, të poshtëruar, të terrorizuar ose të papranuar nga familja, vuajnë po aq, ose edhe më tepër, sesa ç'mund të vuanin nga abuzimi fizik. Një fëmijë që privohet nga ushqimi emocional baze që në fëmijëri, ndonëse nga ana fizike mund të jetë i shëndetshëm dhe familja kujdeset për të, ka shumë mundësi që të mos përparojë asnjëherë në jetë dhe sigurisht kjo mund t'i shkaktojë edhe vdekjen. Deprivimi emocional i fëmijëve që në moshë të vogël mund të bëjë që fëmijët kur rriten të jenë të ankthshëm dhe të pasigurtë, që kanë vështirësi në zhvillimin e tyre ose që nuk kanë vlerësim për vetveten.

Llojet e abuzimit psikologjik dhe emocional

Refuzimi – Prindërit që nuk kanë aftësinë që të lidhen me fëmijën, shpesh shfaqin sjellje refuzuese ndaj tij. Ata mund t'i thonë fëmijës në mënyrë të ndryshme si ai / ajo janë fëmijë të padëshiruar. Ata mund t'i kërkojnë fëmijës që të largohet, mund t'i vendosin atij / asaj emra fyes, ose i thonë fëmijës se është i pavlerë. Prindërit mund të refuzojnë të flasnin me fëmijën, dhe fëmija mund të quhet fajtor për të gjitha problemet që ka familja.

Injorimi – Të rriturit që kanë patur probleme me plotësimin e nevojave të tyre emocionale, shpesh janë të paaftë t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve të tyre. Ata mund të mos tregojnë lidhje emocionale (attachment) me fëmijën e tyre, duke mos treguar ndaj tyre asnjë kujdes emocional. Ata (prindërit) mund të mos tregojnë asnjë interes ndaj fëmijës, shenjë afeksioni ose të njohin prezencën e fëmijës. Në shumë raste prindi është fizikisht aty, por emocionalisht ai / ajo mungon.

Terrorizimi – Prindërit mund ta vendosin fëmijën përpara kritikës ose dënimit. Ata mund ta përqeshin atë kur fëmija shfaq emocione normale për një fenomen të caktuar, ose presin nga fëmija diçka që është jashtë mundësive normale të fëmijës. Fëmija shpesh kërcënohet nga prindërit me vdekje, vrasje, prerje ose braktisje.

Izolimi – Një prind që abuzon me fëmijën nëpërmjet izolimit të tij, mund të mos e lejojë fëmijën që të përfshihet në aktivitete të moshës me fëmijët e tjerë, mund ta mbyllë fëmijën në dhomën e tij / saj, duke mos e stimuluar ekspozimin e tij / saj në shoqëri; ose e ndalon fëmijën adoleshent për të marrë pjesë në aktivitetet jashtë-shkollore. Prindërit mund të kërkojnë që fëmija të qëndrojë në dhomën e tij / saj që nga momenti kur kthehet nga

shkollë deri në mëngjezin e ditës tjetër, ose i kufizon fëmijës të ngrënë, duke e izoluar ose përjashtuar atë nga mjedisi në shtëpi

Korruptimi – Prindërit mund të lejojnë fëmijën që të përdorë drogën ose alkoolin, të keqtrajtojë kafshët, të shikojë materiale pornografike ose akte seksuale ndërmjet të rriturve; të vëzhgojë ose të marrë pjesë në aktivitete kriminale si: vjedhja, dhuna ndaj të tjerëve, prostituimin, lojra fati etj.

Neglizhenca ndaj fëmijës. Neglizhencë ndaj fëmijës do të konsiderohet mosdhënia e kujdesit të përshtatshëm për fëmijën, si psh: streha, ushqimi, veshja, arsimimi, supervizioni, ndihma mjekësore si dhe çdo lloj tjetër ndihme bazë, që është e domosdoshme për zhvillimin e kapaciteteve fizike, intelektuale dhe emocionale të fëmijës. Në dallim nga abuzimi fizik dhe seksual, neglizhenca zakonisht përcaktohet si një model i papërshtatshëm i kujdesit ndaj fëmijës dhe që mund të shikohet nga çdo individ që është në kontakt me fëmijën. Mjekët, infermjeret, mësuesit, të afërmit ose komshinjtë janë ata që në mënyrë të vazhdueshme dyshojnë dhe duhet të raportojnë për neglizhencën ndaj fëmijës.

Në punën për identifikimin e formave të neglizhimit duhet të tregohemi të kujdesshëm pasi ato edhe mund të keqinterpretohen. Kështu, të gjithë fëmijët mund të ndoten kur luajnë dhe kjo është pjesë e eksperiencave të tyre të lojës, por kur fëmija nuk lahet e ndërrohet për kohë të gjatë, atëhere kemi të bëjmë me raste të neglizhimit.

Llojet e neglizhencës ndaj fëmijës

Përsa i përket **neglizhimit**, vështirësia në përkufizim është e trefishtë (Erickson & Egeland, 2002). Së pari, ndryshon nga format e tjera të keqtrajtimit, pasi është një akt mungese, e jo një sulm. Së dyti, ekzistojnë një sërë sjelljesh apo mungesash në përkujdesje dhe supervizim, që mund të përfshihen nën termin neglizhim. Së treti, neglizhimi duhet konsideruar i lidhur me nivelin zhvillimor të fëmijës.

Joffe (2002) e ndan **neglizhimin në tre kategori**: neglizhim fizik, që përfshin dështimin jo organik të mbijetesës, supervizimin e papërshtatshëm, braktisjen dhe dështimin në plotësimin e nevojave fizike të fëmijës; neglizhim mjekësor, që përfshin refuzimin për të ofruar përkujdesin shëndetësor, apo një vonesë në përkujdesin shëndetësor; dhe neglizhimin arsimor, që përfshin lejin e mosfrekuentimit të shkollës, dështimin në dërgimin e fëmijës në shkollë apo regjistrimin dhe mungesën e vëmendjes ndaj nevojave arsimore të veçanta. Erickson & Egeland (2002) shtojnë neglizhimin emocional, i cili

përfshin mungesën e vëmendjes ndaj nevojave emocionale të fëmijës, dhe neglizhimin e shëndetit mendor, ku kujdestari refuzon të trajtojë çrregullimet e rënda emocionale apo sjellore tek fëmija.

Nga shumica e ekspertëve, neglizhimi shihet si një akt mungese, të cilin disa e ndajnë në tre kategori: neglizhim fizik, arsimor dhe emocional (Black & Duboëitz, 1999). Shumë studiues dhe klinikistë i referohen këtij përkufizimi për neglizhimin fizik (Sedlak & Broadhurst, 1996):

Refuzimi i kujdesit shëndetësor - Dështimi në ofrimin ose lejimin e kujdesit të nevojshëm, në përputhje me rekomandimet e një profesionisti kompetent të kujdesit shëndetësor për një dëmtim fizik, sëmundje, gjendje mjekësore ose traumë.

Vonesa në kujdes shëndetësor - Dështimi për të kërkuar kujdes shëndetësor të përshtatshëm dhe në kohën e duhur, për një problem serioz shëndetësor, të cilin çdo njeri joprofesionist do ta konsideronte si një problem që kërkon vëmendje mjekësore profesionale.

Braktisja - Braktisja e një fëmije pa rregulluar kujdes dhe supervizim të arsyeshëm.

Përzënia - Refuzime të tjera ekstreme të kujdestarisë, si përzënia e përhershme ose e papërcaktuar e një fëmije nga shtëpia, pa rregullime të përshtatshme kujdesi nga të tjerët, etj.

Çështje të tjera kujdestarie - Forma të tjera të mungesës së vëmendjes ndaj nevojave të fëmijës, përveç atyre të mbuluara tek braktisja dhe përzënia. Për shembull, shëtitja e përsëritur e një fëmije nga një shtëpi tek tjetra, për shkak të mungesës së dukshme të dëshirës për të mbajtur kujdestarinë e tij, etj.

Mbikëqyrje e papërshtatshme - Lënia e fëmijës pa mbikëqyrje ose nën mbikëqyrje të papërshtatshme për periudha të zgjatura kohe ose të lejuarit e tij të kalojë net larg, kur prindi/kujdestari nuk di (apo nuk përpiqet të përcaktojë) vendndodhjen e tij.

Neglizhim tjetër fizik - Mungesa e dukshme e vëmendjes ndaj rreziqeve të shmagshme në shtëpi; të ushqyerit, veshja apo higjiena e pamjaftueshme; dhe forma të tjera të pakujdesit mbi sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës, udhëtimi me makinë me fëmijën, në gjendje të pirë, etj.

Neglizhenca edukative dhe arsimore – ndodh kur një fëmijë lejohet që të braktisë ose mos ndjekë shkollën, në një kohë kur ai / ajo është në moshën e detyrueshme për t'u shkolluar. Neglizhenca edukative dhe arsimore mund të

shkaktojë mospajisjen e fëmijës me sjellje dhe njohuri bazë për t'u integruar në shoqëri, braktisjen përgjithmonë të arsimimit dhe shkollës, dhe / ose sjellje të vazhdueshme negative në shoqëri

Neglizhimi arsimor përcaktohet si:

Braktisja e lejuar e shkollës - Braktisja e bërë zakon, me një mesatare prej të paktën 5 ditësh në muaj, mund të hyjë në këtë lloj keqtrajtimi, në rastet kur prindi/kujdestari është informuar për problemin dhe nuk është përpjekur të ndërhyjë.

Dështimi në regjistrim/braktisje të tjera - Dështimi për të regjistruar një fëmijë të moshës shkollore, duke bërë që fëmija të humbë të paktën një muaj shkollë; ose një model i mbajtjes së një fëmije të moshës shkollore në shtëpi për arsye jo të ligjshme (për shembull për punë, për t'u kujdesur për vëllezërit/motrat), për një mesatare prej 3 ditësh në muaj.

Mungesa e vëmendjes ndaj nevojave të veçanta arsimore - Refuzimi ose dështimi në përfitim të shërbimeve arsimore të rekomanduara korrigjuese për çrregullime të diagnostikuara të të mësuarit tek fëmija, apo nevoja të tjera të veçanta arsimore, pa shkaqe të arsyeshme.

Neglizhenca emocionale - përfshin veprime të tilla si abuzimi i vazhdueshëm ose ekstrem ndërmjet prindërve në prezencë të fëmijës; lejimi i fëmijës të përdorë drogë ose alkool; refuzimi ose mos-dhënia e kujdesit psikologjik për fëmijën, përcmimi i vazhdueshëm dhe mos dhënia e afeksionit. Kjo mënyrë sjelljeje mund të sjellë imazh të keq për vetveten tek fëmija, abuzim me drogat ose alkoolin, dhe ndonjëherë edhe vetvrasje. Format më të rënda të neglizhencës mund të sjellin si pasojë mos-rritjen e fëmijës, keq-zhvillim ose vdekje.

Neglizhimi emocional është përcaktuar si:

Afeksion/përkujdes i papërshtatshëm - Mungesa e theksuar e vëmendjes ndaj nevojave të fëmijës për afeksion, mbështetje emocionale, vëmendje ose kompetencë.

Abuzimi kronik/ekstrem i bashkëshortit - Abuzimi kronik ose ekstrem i bashkëshortit apo tjetër lloj dhunë në familje, në prani të fëmijës.

Lejimi i abuzimit me drogën/alkoolin - Inkurajimi ose lejimi i përdorimit të drogave ose alkolit nga fëmija, kur prindi/kujdestari është i

informuar dhe nuk ka tentuar të ndërhyjë që ky abuzim të mos ndodhë.

Lejimi i sjelljeve të tjera të keqpërshtatura - Inkurajimi ose lejimi i sjelljeve të tjera të keqpërshtatura (për shembull, sulmet agresive, delinkuenca kronike), nën rrethana ku prindi/kujdestari ka arsye të jetë në dijeni të ekzistencës dhe seriozitetit të problemit dhe nuk është përpjekur të ndërhyjë.

Refuzimi i kujdesit psikologjik - Refuzimi për të lejuar një trajtim të nevojshëm dhe ekzistues për një problem apo traumë emocional ose sjellor, sipas rekomandimit të profesionistit.

Vonesa në kujdesin psikologjik - Dështimi për të kërkuar apo ofruar trajtimin e nevojshëm për një problem emocional ose sjellor, që çdo njeri joprofesionist do ta konsideronte si një problem që ka nevojë për vëmendje profesionale psikologjike (për shembull, probleme kronike të sjelljes dhe agresivitet, depresion i rëndë, tentativa për vetëvrasje).

Neglizhenca fizike – është një nga format kryesore të keqtrajtimin. Neglizhenca fizike përfshin refuzimin ose dhënien me shumë vonesë të ndihmës së nevojshme mjekësore, lënia pas dore e fëmijës, kontrolli i papërshtatshëm, lënia mënjanë e fëmijës e cila mund të shkaktojë largimin e fëmijës nga shtëpia, ose mos dhënia e kujdesit dhe mbrojtjes së përshtatshme për fëmijën për të plotësuar nevojat e tij/saj fizike dhe emocionale. Neglizhenca fizike mund të ndikojë rëndë në zhvillimin e fëmijës, duke i shkaktuar atij / asaj mungesë zhvillimi, kequshqyerje, sëmundje të rënda, dëmtim fizik në formën e prerjeve, djegieve dhe shenjave në trup, për shkak të mungesës së vëzhgimit të fëmijës.

Neglizhenca mjekësore - përfshin mosdhënien e ndihmës mjekësore për fëmijën, ndonëse familja ka mundësi financiare për ta ofruar këtë ndihmë. Në disa raste, prindi ose kujdestari mund të refuzojnë dhënien e ndihmës mjekësore të nevojshme gjatë praktikimit të besimit fetar. Neglizhenca mjekësore mund të sjellë si pasojë një shëndet të keq të fëmijës, si dhe probleme dhe sëmundje të vazhdueshme.

Shfrytëzimi është përdorimi i fëmijës për punë ose aktivitete të tjera, me qëllim përftimi për persona të tjerë. Ndër format e shfrytëzimit mund të përfshihen (Terre des Hommes, 2010):

- a) shfrytëzimi seksual;
- b) puna e çfarëdo forme, jo në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim si dhe puna në fushë;
- c) lypja;
- d) mbledhja e objekteve të riciklueshme dhe/ose shitja në rrugë.

Këto aktivitete janë të dëmshme për shëndetin mendor ose fizik të fëmijës, arsimimin, zhvillimin moral apo socio-emocional.

Shfrytëzimi seksual është abuzimi i një pozicioni, cënueshmëri e pushtetit ose e besimit diferencial apo aktiviteteve të tjera për qëllime seksuale; këtu përfshihet përfitimi monetar, përfitimi shoqëror apo politik nga shfrytëzimi i një personi tjetër.

Shembuj të shfrytëzimit seksual janë prostitucioni i fëmijëve dhe trafikimi i tyre për abuzim seksual dhe shfrytëzim, pornografia.

Trafikimi i fëmijëve parashikohet në nenin 128/b ku përcaktohet si rekrutimi, transporti, strehimi ose marrja e fëmijës për qëllime shfrytëzimi seksual, pune, apo shërbime të detyruara, forma skllavëruese apo të tjera të ngjashme me të, transplantimi i organeve si dhe forma të tjera të ngjashme. Fëmijët që janë trafikuar mund të jenë dhënë “vullnetarisht” nga prindërit ose një anëtar i familjes së tyre, tek një person ose i rritur i besueshëm që u ka premtuar se do të gjejë punë për fëmijën ose arsimim më të mirë, që si rrjedhim do të sillte rregullimin e të ardhurave të familjes. Fëmijët e trafikuar janë në rrezik që të bëhen subjekte të shumë formave të abuzimit, përfshirë abuzimin seksual, abuzimin fizik, punën e rëndë, abuzimin emocional, torturat, mohimin e të gjitha të drejtave të tyre, mungesën e arsimimit dhe kujdesit mjekësor dhe izolimin apo mbylljen me çelës në një godinë (Terre des Hommes, 2010).

Në format e trafikimit përfshihen:

- a) lypja e detyruar;
- b) puna shtëpiake dhe/ose puna e rëndë;
- c) skllavërimi;
- d) shfrytëzimi seksual;
- e) prostitucioni;
- f) pornografia.

Viktimë trafikimi e supozuar – fëmija që po shfrytëzohet dhe për të cilin ka dyshime të arsyetuara që tregojnë se shfrytëzimi ka ndodhur pas lëvizjes apo transferimit të fëmijës. Shfrytëzimi i referohet ndër të tjera shfrytëzimit seksual dhe atij me qëllime pune. Për fëmijët e shfrytëzuar nëpërmjet punës (duke përfshirë edhe lypjen) evidencat e shfrytëzimit janë të mjaftueshme për të konsideruar çështjen si një rast i supozuar trafikimi, pa nevojën e evidencave që tregojnë se shfrytëzimi mbështetet në punën e detyruar. (Edhe një herë miratimi i fëmijës është i parëndësishëm)

Person në risk trafikimi - persona që janë nën presionin e një trafikanti, kur presioni shkon direkt tek personi i shqetësuar ose indirekt tek ai/ajo nëpërmjet një anëtari të familjes; ose/dhe që kanë qenë të trafikuar dhe që janë përballur me vështirësi të mëdha në riintegrim, si edhe çdo person që është nën shfrytëzim serioz, edhe pse nuk ka dyshim për prezencën e elementeve të tjerë të krimit (mungesë miratimi dhe lëvizje për të rriturit, vetëm lëvizje për fëmijët).

Dhuna ndërmjet bashkmoshatarëve/Bullizmi

Bullizmi nuk është një fenomen i ri për shoqërinë tonë, i shfaqur kohët e fundit, por ka historikun e tij të zhvillimit edhe për vëndin tonë. Bullizmi është një formë e abuzimit dhe viktimizimit ndaj një personi apo një grupi. Ai shfaqet në ato situata kur një fëmijë ose grup fëmijësh duke përfituar nga forca apo pushteti që ata mund të kenë, lëndojnë, fyejnë, refuzojnë një fëmijë apo një grup tjetër fëmijësh. Disa nga format e shfaqjes së këtij fenomeni janë: thirrja/etiketimi i/e dikujt me emra fyes, tallës, shkrimi i mesazheve lëndues, lënia jashtë aktiviteteve, kërcënimi, të bërtiturit, frikësimi, vjedhja ose dëmtimi i sendeve/gjërave të tyre personale, goditja, shkelmimi, pickimi i tyre, ose detyrimi për të bërë gjëra apo për t'u përfshirë në sjellje që ata nuk do donin të përfshiheshin.

Nga një sondazh i kryer në 6 mujorin e dytë të 2013-ës në Shqipëri, rezulton se dhuna në shkollë, e cila shpesh herë shpërthen në konflikte agresive mes të rinjve me pasojë fatale për jetën, mbetet ende një nga fenomenet më shqetësuese në vend. Të dhënat e raportuara nga sondazhi i “*Save the children*” dhe *Fondacionit Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi i mosmarrëveshjeve*, tregojnë se është shtuar në mënyrë të ndjeshme shkalla e konfliktualitetit të evidentuar ndërmjet nxënësve me 6-8 % më shumë se sa në vitet e shkuara. Nga 1435 nxënës të anketuar, 28 % e tyre janë shprehur se konfliktohen në ambientet e shkollës, ndërsa 47 % e tyre nuk ndihen të sigurt në klasë, për shkak të grindjeve apo sjelljeve të tjera të dhunshme që shfaqen çdo ditë nga bashkëmoshatarët e tyre.

Situata më shqetësuese raportohet në shkollat e mesme, të cilat regjistrojnë edhe problematikën më të madhe të rasteve. Megjithatë, raste të shumta të konflikteve ndërmjet nxënësve janë shumë prezente edhe në arsimin e detyruar atë 9-vjeçar.

Pse disa fëmijë/te rinj përfshihen në akte bullizmi?

Ka shumë arsye pse fëmijët përfshihen në akte bullizmi:

- Ata mund të shohin bullizmin si një mënyrë për të qenë më të dukshëm,

për të rënë më shumë në sy, duke u bërë “të veçantë” ose duke dashur të tregohen të fortë, të egër, të pushtetshëm;

- Disa të tjerë kërkojnë vëmendje;
- Ndërsa disa fëmijë duan që të tjerët të kenë frikë prej tyre;
- Një pjesë e fëmijëve që përfshihen në të tilla akte janë xheloz për shokët e tyre, ose kanë qenë më parë viktimë të bullizmit ose janë ndërkohë;
- Këta fëmijë e kanë të vështirë të kuptojnë se sjelljet dhe veprimet e tyre janë të gabuara dhe nuk arrijnë të kuptojnë se si ndjehen viktimat e tyre.

Përkufizime teorike të abuzimit të fëmijëve. Ekzistojnë disa mënyra, sipas të cilave fëmijët mund të abuzohen ose neglizhohen. Sipas Kadushin & Martin (1998), termi ombrellë që përdoret nga shumë autorë për t'i përfshirë të gjitha këto është “*keqtrajtimi*” i fëmijëve. Keqtrajtimi i fëmijëve është i lidhur ngushtë me vlera dhe perspektiva historike. Ky koncept është përcaktuar e ripërcaktuar përgjatë historisë. Shoqëria po zhvillohet gradualisht nga konsiderimi i fëmijëve si pronë, në të paktën pranimin e faktit se ata mund të kenë të drejtat e tyre. Çdo periudhë historike, politike, si dhe çdo kulturë ka një koncept sesi duhen trajtuar fëmijët.

Keqtrajtimi përfshin abuzimin fizik; dhënien e kujdesit dhe ushqimit të pamjaftueshëm; mos ofrimin e kujdesit mjekësor të përshtatshëm; inkurajimin e pamjaftueshëm për të ndjekur shkollën në mënyrë të vazhdueshme; shfrytëzimin duke detyruar të punohet shumë ose shumë gjatë; ekspozimin ndaj situatave jo të shëndetshme apo demoralizuese; abuzimin seksual; abuzimin emocional dhe neglizhimin emocional. Me gjithë variacionet nga vendi në vend, shumica e përkufizimeve përfshijnë të tetë aspektet e mësipërme (Kirst-Ashman & Zastroë, 2003). Ndonjëherë në literaturë termi ombrellë i përdorur është edhe ‘abuzim’, dhe në këtë rast kuptimet e tyre janë sinonime.

Sipas Sedlak & Broadhurst (1996), *abuzimi fizik* përkufizohet si vijon: ‘Kategoria e abuzimit fizik është unike, pasi nuk është e ndarë në nëntipa. Aktet që përbëjnë abuzimin fizik përfshijnë goditjet me dorë, shkop, rrip, ose objekte të tjera: goditjet me grushta; goditjet me shqelma; shkundjen; hedhjen; djegien; ose mbytjen e një fëmije’.

Një përkufizim tjetër fokusohet tek sjelljet dhe qëllimi: “Abuzimi fizik karakterizohet nga shkaktimi i dëmtimeve fizike duke goditur me grushta, me shqelma, rrahur, kafshuar, djegur, apo lënduar një fëmijë në mënyra të tjera. Ndonëse dëmtimi nuk është aksident, prindi apo kujdestari mund të mos të ketë pasur qëllim ta lëndojë fëmijën. Dëmtimi mund të ketë qenë rezultat i disiplinës së tepruar apo i dënimit fizik të papërshtatshëm për moshën e fëmijës”.

Mara & Winton (2000) përmendin edhe kategoritë e mëposhtme, si forma të këtij abuzimi:

Dënimi trupor - Dënimi trupor nënkupton përdorimin e shpullave, goditjeve, ndonjëherë edhe rrahjeve me rrip, etj. si metoda disiplinore.

Abuzimi mes vëllezërve/motrave. Fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës në familje

Sindroma e foshnjës së shkundur - Kjo sindromë "përfshin shkundje të fuqishme manuale të foshnjave, nga ekstremitetet ose shpatullat, me gjakrrjedhje të brendshme të kafkës dhe të syve, por pa shenja të jashtme të traumës në kokë".

Sipas Sedlak & Broadhurst (1996), *abuzimi emocional* është përcaktuar si tri forma të veçanta keqtrajtimi:

Kufizimi i rreptë (lidhja, etj) - Kufizimi i rreptë i lëvizjeve, si për shembull, përmes lidhjes së këmbëve apo duarve të një fëmijë së bashku, ose duke lidhur një fëmijë tek karrikja, krevati, apo një objekt tjetër, ose duke e kufizuar një fëmijë në një zonë të mbyllur (si për shembull një dollap), si mjet dënimi.

Sulmi verbal ose emocional - Modelet të kthyer në zakon si përçmimi, nënvlerësimi, denigrimi përmes fyerjeve dhe sharjeve, kthimi në "kokë turku", apo forma të tjera jofizike të një trajtimi tepër agresiv ose refuzues, si dhe kërcënime për forma të tjera keqtrajtimi (si kërcënime për rrahje, sulm seksual, braktisje, etj).

Abuzime të tjera ose të panjohura - Trajtime tepër ndëshkuese, shfrytëzuese ose abuzive, përveç atyre të specifikuara më sipër, ose trajtim abuziv i paspecifikuar. Kjo formë përfshin sulmin e tentuar apo potencial fizik ose seksual, mosdhënien e qëllimshme të ushqimit, strehimit, fjetjes, apo plotësim të nevojave të tjera, si një formë dënimi, shfrytëzimin ekonomik dhe veprime të paspecifikuara abuzive.

Ndonëse janë paraqitur përkufizime të ndryshme, secili prej tyre thekson se ky lloj abuzimi sulmon zhvillimin emocional dhe sjellor të fëmijës (Mara & Winton, 2000). Çelësi në diagnostikimin e abuzimit emocional ose psikologjik, janë sjelljet e përsëritura dhe të vazhdueshme.

Sipas Sedlak dhe Broadhurst (1996), format e *abuzimit seksual* janë:

Intruzioni - evidenca e penetrimit oral, anal apo gjenital, gjenital me gishta, apo lloje të tjera penetrimi.

Molestimi me kontaktin gjenital - akte ku ka ndodhur një formë kontakti gjenital, por nuk ka tregues specifikë intruzioni.

Abuzim seksual tjetër ose i panjohur -akte të paspecifikuara, për të cilat nuk dihet nëse kanë përfshirë kontaktin gjenital dhe për akuza lidhur me supervizimin e papërshtatshëm ose të pamjaftueshëm të aktiviteteve vullnetare seksuale të një fëmije.

Një tjetër përkufizim po kaq gjithëpërfshirës, është: “Abuzimi seksual përfshin preken e gjenitaleve të fëmijës, aktin seksual, incestin, përdhunimin, ekzibicionizmin dhe shfrytëzimin seksual” (National center on child abuse and neglect, 1992). Është e rëndësishme të bëhet dallimi mes abuzimit seksual intrafamiljar (brenda familjes) dhe ektrafamiljar (jashtë familjes). Abuzimi seksual intrafamiljar, ndryshe i njohur si incest, përfshin abuzimin seksual nga anëtarët e familjes. Abuzimi seksual ektrafamiljar ndodh kur abuzuesi nuk është një anëtar i familjes.

KAPITULLI II

SHENJAT E FORMAVE TË NDRYSHMETË ABUZIMIT TEK FËMIJËT/ADOLESHENTËT DHE TEKNIKA TË IDENTIFIKIMIT TË RASTIT

Hyrje

Pas qartësimit të koncepteve mbi format e dhunës, materiali vijues fokusohet në shtjellimin e shenjave dhe simptomave të formave të ndryshme të abuzimit si dhe të teknikave të identifikimit të rastit. Pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli janë gjithashtu informacioni dhe njohuritë mbi pasojat e abuzimit tek fëmijët/adoleshentët si dhe profili i fëmijëve/adoleshentëve të abuzuar.

Dhuna në familje shkakton një seri problemesh psikologjike dhe emocionale, duke kufizuar mundësitë e fëmijëve për një jetë normale, pasojë kjo që mund të vazhdojë gjatë gjithë jetës. Fëmijët që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje, zakonisht ushtrojnë një sjellje agresive dhe jo-shoqërore, të frikësuar, të dëshpëruar, dhe traumatike në krahasim me fëmijët të cilët nuk kanë pasur të tilla përvoja. Dhuna në familje gjithashtu, ndikon mënyrën sesi këta fëmijë do të jenë në gjendje të përballojnë problemet në të ardhmen e tyre. Pasojat variojnë duke pasur parasysh se sa kohë ka zgjatur dhuna, llojin e saj, sa ka qenë një fëmijë i përfshirë në të, mënyra se si një fëmijë ka mundur ta përballojë atë, dhe ambjentin përreth, i cili mund të ketë pasur kushte më të përshtatshme për zgjidhjen e problemit. Në rastin e përjetimit të dhunës tek njëri prej prindërve, problemet e trashëguara nga dhuna në familje, varen nga mosha dhe gjinia e fëmijës, kohëzgjatja e dhunës së ushtruar dhe marrëdhënia e fëmijës me prindin e dhunuar dhe personat e tjerë përreth.

Edhe nëse nuk janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në familje, fëmijët shpesh vuajnë nga të njëjtat probleme të sjelljes dhe probleme psikologjike si fëmijët e dhunuar dhe ata të lënë pas dore. Në veçanti, fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpinë e tyre shpesh vuajnë nga probleme fizike, shoqërore dhe

zhvillimore (p.sh., probleme të të nxënit, aftësi shoqërore të kufizuara, depresioni ose ankthi i skajshëm, dhe/ose shfaqin sjellje të dhunshme, të rrezikshme ose të paligjshme). Gratë që kanë përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” u pyetën nëse dhuna në familje ndikonte tek fëmijët.³ Ndër gratë që mendonin se dhuna në familje ndikonte tek fëmijët e tyre, 86,4% e grave mendonin se fëmijët ishin dëshmitarë të dhunës në familje, 42,8% thanë se dhuna në familje kishte shkaktuar probleme të të nxënit tek fëmijët e tyre, 31,2% thanë se fëmijët e tyre jetonin me frikë, 19,2% thanë se fëmijët ishin lënduar ose dëmtuar për shkak të dhunës në familje dhe 5,5% thanë se fëmijët e tyre ishin larguar nga shtëpia për të jetuar me të afërm të tjerë, për shkak të dhunës në familje.

Nëse nuk merren masa për parandalimin e saj, dhuna kundrejt një fëmije vazhdon dhe në moshën e adoleshencës. Shumë adoleshentë të dhunuar ose që kanë jetuar në familje të dhunshme, kanë tendenca të ushtrojnë dhunë në marrëdhëniet e ardhshme me partnerin/en dhe njerëzit përreth. Jeta në një komunitet ku përdoren armët, droga, alkooli; ku ka përqindje të lartë krimi; kur aplikohet disiplinë e papërgjegjshme dhe e pajustificuar nga prindërit, izolimi ndaj jetës shoqërore dhe ndaj edukimit, i vë fëmijët dhe të rinjtë në një ambient me shumë rrezikshmëri për t'u përfshirë në veprimtari të dhunshme. Të tillë adoleshentë janë më të prirur të vetëvriten, të abuzojnë me drogë dhe alkool, të largohen nga shtëpia në një moshë të re, dhe të përfshihen në krime dhe prostitucion. Dhuna e përjetuar si një fëmijë është gjithashtu e shoqëruar me depresion, simptoma traumatike, dhe vetëvlerësim të ulët ndër gratë dhe burrat. Rezultatet e kërkimeve në Shtetet e Bashkuara kanë arritur në konkluzione se burrat, të cilët kanë qenë të abuzuar kur kanë qenë fëmijë, janë 2 herë më shumë të prirur të abuzojnë me gratë e tyre se ata që kanë pasur një fëmijëri jo të dhunshme (QAGJZH, 2005). Dhuna në familje dhe ndaj fëmijëve e vë brezin e ri në një rrezik më të madh për t'u përfshirë në sjellje kriminele dhe traumatike dhe rezulton në një ulje të mundësive për të pasur një jetë normale brenda familjes dhe në komunitet. Dhuna ndërmjet të rinjve, ashtu si dhe dhuna në familje është një sjellje e forcuar dhe manipulative, me të cilën njëri prej partnerëve kërkon të kontrollojë tjetrin. Një dukuri e tillë vihet re në forma të ndryshme si: abuzimi emocional, fizik, seksual, kufizimi i pavarësisë, izolimi nga shoqëria, kërcënimet, fajësimi etj. Por, janë incidentet e dhunës fizike ato që i bëjnë të rinjtë të kuptojnë se po dhunohen.

Sipas një studimi të kryer në Shtetet e Bashkuara në 2001, u vu re se ndër adoleshentët e moshës shkollare të mesme:

3 INSTAT; UNDP (2013), “Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën”

- *I në 5 vajza ishte viktimë e dhunës fizike apo seksuale nga partneri.*
- *Gjithashtu u konstatua se vajzat e grupmoshës 16 deri në 24 vjeç kishin përqindjen më të lartë të dhunimit në familje apo nga partneri.*
- *43% të vajzave të dhunuara raportuan se dhunimi kishte ndodhur në objektet apo territorin e shkollës.*
- *40% e vajzave adoleshente njihnin dikë që ishte abuzuar nga partneri.*
- *30% e të gjitha vrasjeve të adoleshentëve në SH.B.A. bëhen nga partneri.*

2.1.TREGUESIT E FORMAVE TË NDRYSHME TË ABUZIMIT

Është e rëndësishme që profesionistët që punojnë me fëmijët dhe adoleshentët të njohin dhe dallojnë treguesit dhe pasojat e formave të ndryshme të abuzimit. Ato i shërbejnë profesionistëve në identifikimin e llojit dhe tipologjisë së abuzimit. Progresi i punës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve/adoleshentëve kërkon njohjen dhe pranimin nga të gjithë, që dhuna, keqtrajtimi, abuzimi ndodhin në forma dhe mënyra të ndryshme dhe se ka nevojë të njihen këto forma abuzimi, shenjat, si dhe pasojat që vetë ato sjellin në zhvillimin dhe mirqënien e fëmijës adoleshentit.

Treguesit e abuzimit fizik:⁴

- kocka të thyera, fraktura;
- mavijosje;
- gërvishtje, çjerrje; shenja djegieje;
- shenja mavijosje në formën e mjetit ose të gishtave në lëkurë;
- rrjedhje gjaku ose sëmundje të pashpjegueshme;
- deformime fizike;
- humbje ndjenjash.

Tabela 4.Treguesit e abuzimit fizik

Disa nga shenjat e mundshme të sjelljes së fëmijës si rezultat i dhunës fizike janë:

- qëndrimet e dëshpëruara, të tërhequra ose nën gjendjen e depresionit;

⁴ “Protokolli i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve”, 2010. Ministria e Punës, Terre des Hommes, UNICEF.

- bërrja e një gjumi jo të qetë, me shqetësime;
- bërrja agresiv;
- shfaqja e frikës ndaj disa të rriturve ose të rriturve në përgjithësi;
- frika nga kthimi në shtëpi i prindit/kujdestarit ose kthimi në shtëpi i fëmijës sikurse edhe frika nga kontaktimi me prindin/kujdestarin ose një anëtar i familjes;
- mungesa e besimit tek të rriturit ose vlerësimi i ulët për vetveten;
- qëndrimi shumë pasiv dhe ankimet e vazhdueshme;
- përdorimi i drogës dhe i alkoolit;
- largimi ose braktisja e vazhdueshme e shtëpisë etj.

Fëmijët që kanë shpesh shenja ose mavijosje e të nxira në trup, si për shembull në vesh apo në fytyrë, të cilat nuk mund të justifikohen si goditje aksidentale nga lojërat e përditshme të fëmijës, mund të sjellin në vlerësimin se këta fëmijë janë të ekspozuar ndaj abuzimit fizik.

Treguesit e abuzimit seksual:

- dhimbje, kruarje, mavijosje ose gjakrrjedhje nga organet gjenitale, anale ose zonat përreth tyre;
- rrjedhje gjenitale ose infeksione të kanaleve urinare;
- dhimbje stomaku ose vështirësi gjatë ecjes ose qëndrimit në këmbë;
- shtatzëni;
- sëmundje (infeksione) të transmetuara seksualisht.

Tabela 5. Treguesit e abuzimit seksual

Shenjat treguese të sjelljes - Abuzimi seksual

Shenjat dhe simptomat më specifike të abuzimit seksual janë dhimbje rektale ose gjenitale, gjakrrjedhje rektale ose gjenitale, prezenca e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme në fëmijët e para pubertetit si dhe sjellje seksuale të parakohshme, veçanërisht nëse këto janë të vazhdueshme (Shehu. E., Gramo.A., 2008).

Simptomat e sjelljes që mund të paraqesë fëmija i abuzuar seksualisht janë të përmbledhura më poshtë. Është e rëndësishme të kujtohet që jo të gjitha shqetësimet e mëposhtme janë tregues të abuzimit seksual.

Disa nga shenjat e mundshme të sjelljes së fëmijës si rezultat i dhunës seksuale janë:

- Demonstrojë njëren nga dy ekstremet e aktivitetit (hiperaktiv ose tërhequr);
- Manifestoje vet-vlerësim të ulët;
- Tregojë evidencë të marrëdhënieve të cekëta me shokët;
- Shpreh ndjenja të përgjithshme faji apo turpi;
- Demonstrojë një shtrembërim të imazhit të trupit (vizatimet);
- Demonstrojë sjellje regressive;
- Duket i frikësuar gati fobik ndaj të rriturve;
- Tregojë sjellje të pseudo maturuara;
- Shfaqë një keqësim/rënie në mbarëvajtjen akademike;
- Këtë një çrregullim të të ngrënit;
- Manifestojë sjellje provokuese seksuale;
- Angazhohet në masturbim kompulsiv;
- Abuzojë seksualisht një vëlla, motër, shok/shoqe apo fëmijë më të vogël;
- Bëhet seksualisht i/e rrezikshme;
- Braktisë shtëpinë;
- Tentojë vetvrasje.

Treguesit e abuzimit psikologjik/emocional

- vonesa në zhvillimin fizik, mendor dhe emocional;
- gjendje ankthi e vazhdueshme;
- vështirësi e papritur në të folur;
- vonesa në të folur ose në të shprehur të një mendimi;
- vetëvlerësim i ulët;
- përgjigje emocionale jo në përputhje me situatën e dhimbshme;
- agresivitet ose pasivitet ekstrem;
- abuzimi me drogën dhe alkoolin;
- largimi ose braktisja e vazhdueshme e shtëpisë;
- mungesë dëshire për të kryer aktivitete të ndryshme;
- të qara pa shkak të dukshëm.

Tabela 6. Treguesit e abuzimit psikologjik/emocional

Shenja të mundshme të fëmijës së neglizhuar janë:

- veshja e fëmijës nuk është e përshtatshme me sezonin ose motin (kjo mund të ketë shkaktuar simptoma të tilla që përfshijnë të ftohtët, kollitje, pneumoni, djegie nga dielli, morth, shenja që shkaktohen nga ngrica etj);
- higjiena personale e fëmijës le për të dëshiruar (thonjtë të gjatë e të papastër, erë e keqe e trupit, flokë të pakrehur e të palarë, parazitë në kokë dhe në trup);
- mbikëqyret në mënyrë jo të mjaftueshme ose lihet në përkujdesje të një personi jo të përshtatshëm;
- ka probleme që tregojnë se nuk është trajtuar me ilaçe ose nga mjeku;
- është i/e kequshqyer (fëmija nën peshë dhe jo me zhvillimin e duhur sipas moshës, ka vështirësi në kapërcimin e ushqimit, është gjithnjë i lodhur e i këputur, trupi ka humbur tonet fëmijërore etj);
- vonesa ose mosfrekuentim të shkollës.

Shenjat që mund të tregojnë se një fëmijë është viktimë e akteve të bullizmit janë:

- fëmija mund të shfaqë dhimbje barku,
- mund të jetë ankthioz,
- mund të mos ketë dëshirë apo të hezitojë të shkojë në shkollë,
- të shfaqë mungesë besimi tek vetja dhe të tjerët.
- Ata mund të humbasin lidhjet/kontaktet me shokët dhe të ndjehen të shkëputur/të izoluar.

2.2.PASOJAT E ABUZIMIT DHE PROFILI I FËMIJËVETË ABUZUAR

Pasojat e dhunës tek fëmijët

Pasoja fizike: Pasojat e abuzimi fizik mund të fillojnë me hematoma të lehta të dukshme në lëkurë, kocka të thyera, shenja dhe vraga, kequshqyerje dhe çrregullime të të ngrënit, dëmtime të trurit, laceracione (çarje), dëmtimet e mëdha neurologjike dhe deri tek vdekja.

Abuzimi fizik i fëmijes ka treguar se dëmtimet e rënda fizike dhe psikologjike mund të shkaktojnë paaftësi fizike apo mendore të formave dhe niveleve të ndryshme, që mundet të zgjasin gjatë gjithë jetës së njeriut. Në pasojat **fizike të dhunës seksuale** mund të përmendim dëmtim të organeve gjenitale, shtatzëni të padëshiruar, sëmundje seksualisht të trasmetueshme, HIV/AIDS, sterilitet, abort.

Pasoja emocionale/psikologjike. Fëmijët e abuzuar kanë **probleme me sjelljen**, shfaqje të agresivitetit me të tjerët, armiqësi kundër figurave autoritare, sjellje të kundraligjshme, probleme të sjelljeve seksuale dhe probleme të përshtatjes në mjedise të ndryshme, shfaqje të zemërimit me ose pa provokim.

Këta fëmijë e kanë të lehtë t'i përgjigjen agresivitetit të të tjerëve me rezistencë. Fëmijët e abuzuar janë më vigjilentë dhe mësojnë të sillen në një mënyrë që t'i kënaqin të tjerët dhe kjo vjen nga dëshira për të reduktuar rrezikun e ushtrimit të dhunës. Fëmijët e abuzuar nuk krijojnë marrëdhënie besimi me njerëzit dhe lidhje të cilat duhet të zgjasin normalisht për një kohe të gjatë. Në të ardhmen këto lidhje do të reflektojnë problemet në bashkëjetesë apo në marrëdhëniet në çift.

Viktimat e abuzimit shpesh paraqesin **probleme me abuzimin e substancave** të ndryshme si alkooli, narkotikët e substanca të tjera. Gjithashtu abuzimi rrit shfaqjen e problemeve në sjelljet seksuale. Por këto sjellje mundet të kenë bazën edhe vetëm në abuzimin emocional. Për sa i përket zhvillimit njohës abuzimi i fëmijëve dhe lënia pas dore është faktor risku i lartë për inteligjencë të ulët dhe braktisje të shkollës. Aftësia për të treguar emocionet apo empatinë për të tjerët është e cunguar në fëmijët e abuzuar.

Fëmijët e neglizhuar shfaqin largësi nga bashkëmoshatarët dhe kanë më tepër vështirësi të përballojnë situata të agresivitetit të të tjerëve.

Fëmijët e keqtrajtuar janë gjithashtu më të prirur për të vuajtur nga **probleme të brendshme emocionale** si depresioni, ankthi, dhe mungesa e lidhjeve sociale e cila tregohet me vështirësi në marrëdhëniet me moshatarët. Një nga patologjitë më të shpeshta është ankthi dhe depresioni i cili mundet të jetë me pasojat të rënda për jetën. Vetëvrasjet janë shumë më të shpeshta tek fëmijët e abuzuar dhe që më pas në adoleshencë paraqesin probleme të çrregullimeve të emocioneve. Shfaqja e depresionit dhe e mendimit që ata vlejnë shumë pak, është nga shenjat më të shpeshta. Fëmijët e keqtrajtuar tregojnë vonesa të zhvillimit, probleme me gjuhën sidomos në fushat në të cilat kërkohet zhvillim njohës dhe aftësia për të njohur emocionet tek të tjerët. Ndalimi i zhvillimit të gjuhës emocionale mundet të jetë përshtatur për

fëmijët e keqtrajtuar sepse mbase shprehja e ndjenjave mundet të shërbejë si nxitës i abuzimit të vazhdueshëm. Probleme me gjuhën dhe me shprehjen janë evidente tek këta fëmijë kryesisht tek parashkollorët apo edhe tek fëmijët e moshës së shkollës.

Qëndrimi për një kohë të gjatë nën sjelljet abuzive shkakton një **vonesë apo ndalim të zhvillimit të ndjeshmërisë emocionale**. Mundet të identifikohen menjëherë fëmijët të cilët shfaqin agresivitet me moshatarët, janë të paaftë për të qetësuar dhe ndihmuar të tjerët të cilët kanë nevojë. Këta fëmijë “rezistentë” është parë që vijnë nga familje me vështirësi të mëdha. Familjet e tyre kanë investuar pak në drejtim të krijimit të lidhjeve shpirtërore dhe të shfaqjes së dashurisë për tjetrin. Këta fëmijë kanë imazh të varfër apo gjykim të shtrembëruar për veten në krahasim me të tjerët. Këto karakteristika bëhen gurët e parë të themelit për vetëvlerësimin e vetes dhe të kontrollit të mirë të veprimeve të fëmijës.

Pasojat psikologjike të fëmijës së abuzuar. Megjithëse studimet e fundit sugjerojnë se abuzimi seksual i fëmijës nuk lidhet as me simptoma dhe as me një sindromë specifike (Kendall-Tackett, Williams & Finkelhor, 1993), janë munduar të identifikojnë disa pasoja të abuzimit në një minoritet të mbjetuarish (Briere, 1992). Tashmë dihet që fëmijët që kanë përjetuar abuzim janë në rrezik të madh ndaj zhvillimit të stresit post-traumatik, deformimeve kognitive, emocionalitete të ndryshueshme (psh. ankthi ose depresioni) dhe disocimi. Janoff-Bulman (1992) sugjeron se eksperiencat abuzive mund të dëmtojnë rëndë mendimet e individeve mbi kuptimshmërinë e botës, vlerësimin për veten, mirësjelljen e të tjerëve, duke i bërë të mbijetuarit të vënë në pikëpyetje qëllimin ose dhe sigurinë e ngjarjeve në vazhdim. Kjo pikëpyetje vihet gjithashtu edhe mbi kompetencat e tyre për t’ia dalë mbanë eksperiencave të ardhshme stresuese, dhe mbi të gjitha, mbi besueshmërinë të të tjerët.

Judith Herman (1997) përshkruan me detaje pasojat psikologjike të abuzimit të fëmijëve. Sipas saj, trauma e përsëritur në jetën e një të rrituri “gërryen strukturën e personalitetit” thuhet të formuar, ndërsa trauma e përsëritur në fëmijëri “formon” dhe “deformon” personalitetin në zhvillim. Fëmijët që zhvillohen në një mjedis abuziv, njohur ndryshe si “klime të dominimit” atashohen në mënyrë patologjike me atë që abuzon; marrëdhënie të cilën, ata përpiqen të ruajnë duke sakrifikuar vehten, mirëqënien e tyre, realitetin dhe jetën e tyre. Më poshtë janë përmbledhur disa prej pasojave psikologjike të fëmijës së abuzuar, shkruar nga Herman (1997):

Frika e vdekjes – përmendet shpesh në dëshmitë e pjesës dërrmuese të të mbijetuarve. Jo rrallë herë, mënyra për t’i bërë fëmijët të heshtin është

dhuna dhe kërcënime të drejtëpërdrejta për vrasje. Kërcënimet për vdekje shpeshherë drejtohen edhe tek anëtarët e tjerë të familjes (Kulluri. E., 2008).

Ndjenja e të qënurit “ të pashpresë” – Në mjediset abuzive vihet re ushtrimi i kontrollit nga ai që abuzon. Kjo fuqi është arbitrare dhe absolute, ndërsa rregullat që e mundësojnë atë janë të paqëndrueshme. Është pikërisht kjo arsyeja që të mbijetuarit nga abuzimi ndihen të frikësuar nga paparashikueshmëria e dhunës. Mosha e fëmijës (por jo vetëm kjo) shpjegon pse ata janë të pazotë të bëjnë diçka për të dalë nga abuzimi, dhe si rezultat ata mësojnë rolin e “të dorëzuarit”.

Gjendja e vigjilencës së vazhdueshme – paraqitet si një mënyrë për tu vetëmbrojtur duke iu shmangur apo duke “e marrë me të mira” abuzuesin. Ky është një mekanizëm që aktivizohet si rezultat i ekspozimit ndaj rrezikut të vazhdueshëm e të paparashikueshëm të abuzuesit. Zhvillimi i aftësive të “vigjilencës” e ndihmon fëmijën të dallojë shenjat paralajmëruese të sulmit fizik, seksual, etj Fëmijët bëhen njohës të mirë të ndryshimeve të vogla në shprehjen e fytyrës (të abuzuesit), të zërit deri tek ndryshimet fizike të trupit që paralajmërojnë zemërim, zgjim seksual, intoksikim, etj

Izolimi, inati & zemërimi– Fëmijët e abuzuar janë të izoluar nga jeta sociale, por edhe nga anëtarët e tjerë të familjes (nëse abuzuesi është anëtar i familjes). Shpesh fëmija mendon jo vetëm se “i rrituri është më i fuqishëm në jetën e tij/saj intime, por është dhe i rrezikshëm për të”, por edhe se “të rriturit e tjerë që janë përgjegjës për kujdesin ndaj tij/saj, nuk e mbrojnë atë.”

Ja si e përshkruan inatin e saj një e mbijetuar nga inçesti ndaj familjes së saj: *“Kam kaq shumë zemërim brenda meje, jo aq për çfare ndodhte në shtëpi, por se asnjëri nuk dëgjonte. Nëna ime akoma e mohon rëndësinë e asaj që ndodhte në shtëpi. Vetëm rrallë, ndonjëherë ajo mund të thotë – ‘ Ndihej shumë fajtorë, nuk mund ta besoj që nuk bëra asgjë’. Por, gjatë asaj kohe asnjëri nuk e pranonte; ata thjesht e lejonin atë të ndodhte. Ndaj unë luajta mendsh dhe akoma jam kështu”*

Vetë-fajësimi – Kur fëmija arrin të shkëputet prej realitetit të abuzimit, ai/ajo fillon të ndërtojë një sistem “të dhënies kuptim ngjarjes” për ta justifikuar atë që po ndodh. Rezultati: fëmija beson se shkak i abuzimit është “ana e keqe e tij/saj”. Ky lloj sistemi besimi për veten i shërben fëmijës të ruajë dhe të ushqejë sensin e “kuptimit”, të “shpresës” dhe të “fuqisë”. Kështu, nëse fëmija mendon që nuk është fati që e ka braktisur (siç mund të mendojnë një pjesë e të mbijetuarve), por ai/ajo vetë e ka krijuar atë, atëherë ai/ajo mund ta ndryshojë fatin. Vetë-fajësimi është pothuajse i njëjtë te individët e traumatizuar të të gjitha moshave, të cilët kërkojnë tu japin kuptim ngjarjeve abuzive duke i kërkuar fajet tek vetja.

Raporti studimor “*Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri*” (Tamo & Karaj), nënvizon pasojat psikologjike të dhunës ndaj fëmijëve të tilla si:

- Pasoja që prekin nivelin e përgjithshëm të funksionimit emocional të fëmijës.
- Kultivohet frika deri në vetbllokim;
- Ndjenja e fajit dhe e turpit
- Pakënaqësia
- Vetmia
- Pesimizmi, depresioni, nervozizmi, etj
- Pasoja që prekin mundësitë për zhvillim të fëmijës
- Kultivimi i sjelljeve të dhunshme
- Mendimi për vetëvrasje

Fëmijët ndaj të cilëve është ushtruar dhunë kanë një vetëbesim të ulët, si rrjedhojë:

fëmijët mbi të cilët ushtrohet dhunë fizike, cilado qoftë forma e saj, manifestohet në qëndrime pasive ose në mungesën e kurajës për të vetvendosur ose për të shprehur dëshirat, njohuritë, prirjet e veta në të gjitha mjediset edhe jashtë familjes. Fëmija preferon të mbyllet në vetvete dhe të mos shprehet sepse nëse do të kërkojë ose shpreh diçka do të konfliktohet me të rriturit. Fëmija ndihet i pafuqishëm dhe nuk vendos dot kurrëgjë për veten. Fëmija ndjen se është keqtrajtuar vazhdimisht pa logjikë por reagimet fillojnë e shndërrohen në apati dhe mungesë totale të vetëveprimit. Fëmijët bien shpesh herë në depresion të thellë, ai e ndien veten fajtor për abuzimin e pësuar.

Fëmijët ndaj të cilëve është ushtruar dhunë kanë frikë. Fëmijët nuk dinë si të mbrojnë vetveten. Nëse i thotë një pjesëtar i familjes se tjetri e ka dhunuar ka rrezik që të ndëshkohet përsëri dhe më keq.

Fëmijët ndaj të cilëve është ushtruar dhunë izolohe. Fëmija nuk mban shoqëri me bashkëmoshatarët dhe këta gradualisht fillojnë e largohen kur mësojnë se në atë familje ushtrohet dhunë.

Fëmijët ndaj të cilëve është ushtruar dhunë kanë bindjen se prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes që ushtrojnë mbi ta dhunë kanë të drejtë.

Antagonizmat e dhunës në familje ndaj fëmijëve lidhur me pasojat. Dhuna në familje karakterizohet nga dy elementë antagonistë me të. Antagonistë

sepse ndodh zakonisht në mjedisin familjar, në shtëpinë tonë, përfytyrimet për të si rregull janë paqësore. Antagonistë sepse shkaktohen nga ata që duam më shumë apo që mendojmë se si rregull duhet të na duan më shumë (Mandro. A., Kalaja.E., 2009). Ne e kemi të vështirë të bëjmë dallimin midis familjes dhe shtëpisë. Familja dhe shtëpia janë përbëhet nga ai mjedis unikal e i ngrohtë i krijuar për të na akomoduar ngrohtë, butë, pastër dhe e aftë të na dhurojë dashuri me çdo detaj të vetin. Ëndrrat tona si të rritur vërtiten shpesh herë në shtëpinë ku kemi kaluar fëmijërinë tonë. Familja janë anëtarët e saj. Ata që ofrojnë pa kushte dashuri, mbrojtje, edukim, mirëqenie sa kohë jemi fëmijë dhe më tej. Familja janë prindërit dhe të afërmit tanë më të dashur. Pa dyshim që të dhunohesh në këtë mjedis dhe persona të tillë është jo vetëm e rëndë por edhe me gjurmë që zgjasin në kohë dhe efektojnë personalitetin tonë të ardhshëm.

“Manuali i praktikave të mira” - për profesionistët që punojnë me fëmijët e keqtrajtuar”, përgatitur nga CRCA (2005) bën një klasifikim të pasojave të abuzimit me fëmijët sipas efekteve të tyre në kohë. Si të tilla ka pasoja me efekt të shkurtër dhe të gjatë në kohë. Studiues të ndryshëm kanë arritur në rezultatin se pasojat e abuzimit fizik, seksual, emocional dhe të gjitha format e neglizhimit janë më të mëdha se sa mendohen. Është identifikuar një listë e pasojave negative tek fëmijët e keqtrajtuar dhe tek të rriturit të cilët kanë qenë të abuzuar më parë në fëmijëri.

Në disa fëmijë eksperiencat sociale kanë kompensuar impaktin e abuzimit, por në disa të tjerë efektet negative të cilat shfaqen pas një kohe të gjatë kanë qenë të paevitueshme. Studimet kanë treguar se të gjitha format e abuzimit japin si rezultat një listë të gjatë të “sëmundjeve psikologjike”. Për rrjedhojë, fëmijët e keqtrajtuar kanë frekuencë më të lartë të problemeve me sjelljet e jashtme të cilat janë lehtësisht të lexueshme nga të tjerët.

Pasojat përtej fëmijërisë (afatgjata) përfshijnë: risk më të lartë për të zhvilluar çrregullime psikiatrike si çrregullimet depressive, stresin post traumatik (PTSD) çrregullime të personalitetit (personalitet i papërcaktuar, personalitet antisocial, psikoza, etj). Këta fëmijë kur rriten janë më të prirur se personat e tjerë të zhvillojnë sjellje si abuzimi me alkoolin dhe lëndët narkotike, si dhe të përfshihen në sjellje vetëshkatërruese. Këta të rritur gjithashtu kanë më shumë paaftësi për të krijuar marrëdhënie të qëndrueshme intime si dhe vështirësi të përshtatjes me profesionin. Shpeshherë viktimat e abuzimit përfshihen në probleme me drejtësinë kriminale, në sjellje agresive përfshirë edhe dhunën në familje si dhe manifestojnë një inteligjencë të ulët. Viktimat e abuzimit kur bëhen prindër mundet të përsërisin të njëjtat sjellje abuzuese ndaj fëmijëve të tyre dhe në këtë mënyrë ky cikël mbetet një cikël vicioz abuzimi brezash të abuzuar.

Dhuna lë gjurmë të pashlyeshme në **kujtesën e individit**. Rendimenti i kujtesës është individualisht i ndryshëm dhe varet shumë nga mosha. Kështu fëmijët duke nisur nga 7 vjeç kanë një rendiment të lartë të kujtesës, në moshën 25 vjeçare konstatohet një rënie e saj dhe nga mosha 60 vjeçare një zvogëlim i dukshëm në radhën e ruajtjes së emrave të përveçëm, emërtimeve të objekteve, veprimeve dhe emërtimeve të gjërave abstrakte. Fëmijët kanë një kujtesë fotografike shumë të zhvilluar në krahasim me të rriturit.

Pasojat tek fëmijët viktimë të trafikimit. Fëmijët viktimë të trafikimit vuajnë pasoja dyfishe të cilat influencojnë negativisht sjelljen e tyre aktuale e të ardhshme dhe jetën në përgjithësi. Disa nga pasojat kryesore janë:⁵

Ndikimi në shëndetin fizik

- probleme të ndryshme të shëndetit;
- sëmundje të ndryshme;
- kequshqyerje;
- shtatzëni;
- sëmundje seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS.

Ndikimi në shëndetin mendor dhe psikologjik

- çrregullime të personalitetit;
- vetëvrasje, sjellje vetë shkatërruese;
- çrregullime të stresit post-traumatik;
- abuzim dhe varësi nga drogat dhe alkooli;
- frikë, ankth;
- fajësim, turpërim;
- vetëvlerësim i ulët;
- të ndjerit ndryshe dhe i përjashtuar;
- izolim;

5 "Protokolli i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve", 2010. Ministria e Punës, Terre des Hommes, UNICEF.

- mungesë sigurie;
- mungesë kontrolli;
- paaftësi për t'u besuar të tjerëve;
- cënueshmëri (vulnerabilitet);
- sjellje hiperaktive;
- agresivitet;
- sjellje antisociale.

Ndikimet sociale

- stigmatizim;
- marginalizim;
- kriminalitet;
- prishja e lidhjeve sociale;
- ndarja nga familja;
- braktisja e shkollës;
- vështirësi në rifutjen në sistemi arsimor.

Pasojat e dhunës me bazë gjinore tek adoleshentët

Dëmtime fizike	Izolim
Performancë e ulët akademike; Rezultate të ulëta në mësim; Mungesë përqëndrimi në klasë	Prishja e lidhjeve sociale
Depresion	Vetëvlerësim i ulët
Çrregullime të stresit post-traumatik;	Shtatëzani; Sëmundje seksualisht të trasmetueshme
Ankth	Kequshqyerje; Çrregullime të ushqyerjes; Anoreksi
Çrregullime të gjumit	Tentativë vetëvrasje, sjellje vetë shkatërruese
Paaftësi për t'u besuar të tjerëve;	Vdekje

Tabela 7. Pasojat e dhunësme bazë gjinore te adoleshentët

PROFILI I FËMIJËVE TË ABUZUAR

Mbështetur në rastet e fëmijëve të trajtuar në shërbimet për dhunën në familje mund të arrihet në disa konkluzione të përgjithshme lidhur me pasojat e abuzimit tek fëmijët, si dëshmitarë dhe viktime të saj. Fëmijët e dhunuar pavarësisht nga forma e dhunës së ushtruar mbi ta, kanë eksperiencë të ngjashme ose afërsisht të ngjashme (Haxhiymeri. E., Kulluri. E., Hazizaj. A., 2005).

Një nga këto eksperiencë është *dëmtimi emocional i fëmijës*. Fëmija i dhunuar fizikisht, psikologjikisht por edhe seksualisht vuan emocionalisht nga kujdesi jo i vazhdueshëm prindëror dhe nga frika e dhunimeve të tjera që mund të pasojnë. Këta fëmijë vuajnë neglizhimin emocional, mungesën e afeksionit dhe lidhjeve të fuqishme me prindërit. Në rastin e dhunës seksuale, ata il tremben faktit që mbeten në duart e dhunuesit për të plotësuar nevojat e tyre emocionale. Fëmijët e neglizhuar vuajnë mungesën e kujdesit për të plotësuar nevojat e tyre emocionale.

“G. është një fëmijë katër vjeç që vjen në Strehëz së bashku me nënën e tij. Të dy janë të dhunuar nga babai dhe bashkëshorti. Ai kishte ushtruar dhunë ndaj gruas edhe në sy të fëmijës. Djali ishte i terrorizuar. Ai shqetësohet për fatin e nënës por edhe të atij vetë. Shpesh ai shprehej për të atin ”pu, pu, ai është i tmerrshëm, ai të vret me thikë”. Sikur të mos mjaftonte kjo, ai merrte edhe kërcënime të vazhdueshme nga e ëma, e cila e kërcënonte në çdo rast për ta braktisur. Në këto kushte ai vetëm e përkëdhelte nënën, i bënte vlerësime maksimale “ti je mami më e bukur në botë”, “ti je ylli im”, “je më e bukura në botë”, e ledhatonte dhe përpiquej të mos e mërziste kurrë. Ndryshe nga bashkëmoshatarët e tij, ai kujdesej jashtëzakonisht mirë për veten, hante vetë dhe pa naze, vishej vetë, kujdesej për gjërat e tij. Shqetësimi i tij mbetej që mami të mos lodhej dhe mërzitej”.

Shembulli i mësipërm por edhe shembuj të tjerë tregojnë se këta fëmijë marrin përgjegjësi të parakohshme mbi vete. Ata bëhen përgjegjës për sjelljen e tyre, kujdesen për lumturinë dhe qetësinë e prindërve, kujdesen për vëllezërit dhe motrat, ngushëllojnë nënën e trishtuar, bëjnë të gjitha punët e shtëpisë, dhe përpiqen jashtë mundësive të tyre për ta mbajtur familjen të bashkuar.

“M. është një fëmijë trembëdhjetë vjeçar i zhvilluar mirë fizikisht dhe psikologjikisht. Ai është shumë i zgjuar dhe shkëlqente në shkollë, është i heshtur, shumë i pjekur për moshën dhe komunikon rrallë. I vetmi shqetësim i tij ishte se si

të bashkonte prindrit. Negocionte shpesh me të ëmën dhe i kërkonte takime herë pas here të atit. Çuditërisht ai nuk bënte rolin e përcjellësit të mesazheve nga njëri tek tjetri prind por iu kërkonte të dyve bashkimin sa më të shpejtë”.

Kjo kategori fëmijësh përveç sa më sipër, marrin përgjegjësinë të përcaktojnë se kur mund t'i afrohen prindit dhe kur jo. Ata gjithashtu marrin përsipër dhe përpiqen të shmazin grindjet në familje. E gjithë kjo i kushton shumë këtyre fëmijëve. Në një mënyrë apo në një tjetër atyre kështu iu është mohuar fëmijëria.

“R. është 12 vjeç, i zhvilluar mirë, por shumë i ndrojtur dhe shumë i edukuar. Edukata që ai shprehte e bënte atë të veçantë ndër fëmijët e pranishëm në Strehëz, por edhe mes shumë rasteve të trajtuara në këtë shërbim. Ai ishte shumë i lidhur me nënën dhe përpiquej të ishte perfekt në çdo gjë që bënte në mënyrë që të mos e mërziste atë. Ai ndjehej i turpëruar nga sjelljet e të atit dhe nuk preferonte të fliste për të edhe kur një gjë e tillë i kërkohej nga punonjëset. Gjithë bota e tij ishte përqëndruar tek vizatimet ku me sa duket edhe shprehte emocionet e tij. Shqetësim i tij ishte mirëqenia dhe humori i mirë i nënës së tij. Duke qënë se ai kishte qënë prezent në shumë raste kur i ati dhunonte të ëmën, por edhe atë vetë, ai përpiquej me çdo kusht ta mbante nënën në humor të mirë”.

Fëmijët e dhunuar karakterizohen nga **mungesa e besimit ndaj njerëzve që i rrethojnë** ata. Kjo shpjegohet me faktin se duke qënë të dhunuar nga individë të tillë që presupozohen të kujdesen për ata, fëmijët nuk mundet të krijojnë marrëdhënie besimi me njerëz të tjerë.

Fëmijët e dhunuar karakterizohen nga **dëshira për të mos kërkuar ndihmë**. Kjo mbase është e kushtëzuar nga eksperiencat e tyre, kur askush nuk është kujdesur për ata. Në të tilla rrethana ata janë mësuar të kujdesen për veten, për nevojat e tyre dhe normalisht ta konsiderojnë këtë një përgjegjësi të tyre. Ata janë fëmijë që nuk dine të qajnë e të ankohen. Ata përpiqen të gëzojnë gjithçka që mund t'ju afrohet, pa patur shumë pretendime.

Përgjithësisht këta fëmijë **formojnë karaktere të mbyllura**, jo të komunikueshëm, vuajnë shumë brenda vetes, ndajnë shumë pak ose aspak nga eksperiencat e tyre të dhimbshme me të tjerët. Ata ndjehen të turpëruar nga situata në familjen e tyre dhe përpiqen me çdo kusht që ta mbulojnë këtë problem. Është kjo arsyeja që ata bëhen të ftohtë, të egër dhe shpërthyes të paparashikueshëm. Në disa raste ata janë apatikë, pa dëshira, ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre, pa iniciativë dhe inatçorë.

“B është 4 vjeç. Ai është shumë i lëviszhëm, i papërqëndruar dhe të bën përshtypje se ai nuk flet, por therret. Ai therret kur ka nevojë për diçka, edhe kur i thua diçka, dhe të duket se në mënyrën e tij të komunikimit ka zënë vend vetëm thirrja. Kur e merr në krah për ta përkëdhelur duhet të jesh shumë i le kujdesshëm/e se ai mund të të qëllojë fare pa pritur edhe kur mendon se nuk ka asnjë arsye për një sjellje të tillë”.

Një karakteristikë tjetër e fëmijëve është se ata **vuajnë nga çrregullime të të ngrënies**. Disa vuajnë nga anoreksia dhe disa të tjerë nga mbingrënia. Fëmijët duket se refuzojnë të ngrënies si shenjë hakmarrjeje për dhunimin e drejtëpërdrejtë apo të tërthortë që ju bëhet.

Fëmijët krahas problemeve të tjera kanë edhe **problem me urinimin**. Pavarësisht nga mosha, një pjesë e mirë e tyre, vuajnë nga urinimi gjatë natës. Në asnjë rast ky problem nuk ka qënë i lidhur me probleme shëndetësore. Ai ka qënë problem i lidhur me çrregullimet emocionale të tyre. Në shumicën e rasteve nënat shprehen se problemi nuk ka qënë i vazhdueshëm. Problemi ka filluar të shfaqet kur ka filluar të përjetohet edhe problemi në familje. Pra, këta fëmijë, dikur në fëmijërinë e tyre, e kanë fituar aftësinë për të kontrolluar nevojat personale. Me kalimin e viteve, si rezultat i problemeve emocionale të tyre, ata kanë humbur aftësinë e kontrollit të urinimit.

“M dhe E janë dy motra përkatësisht 6 dhe 4 vjeç. Nëna e tyre tregon se vite më parë ato nuk e kanë patur këtë shqetësim. Gjithçka ka filluar kur babi i tyre është kthyer nga emigracioni i gjatë dhe ka dyshuar për sjelljen e bashkëshortes. Ai është bërë tepër agresiv, dyshues dhe kërcënues. Ai e dhunonte fizikisht të shoqen çdo dite pasi e kishte marrë në pyetje për orë të tëra për t'i treguar të dashurin e saj. Vajzat ishin prezent gjatë gjithë kohës. Ai arrinte sa ta kërcënonte të shoqen me armë zjarri dhe me thikë se do t'i merrte jetën në se ajo nuk i tregonte kush ishin të dashurit e saj. Vajzat, përveç problemeve të tjera, kishin filluar urinimin gjatë natës, duke e rënduar situatën e tyre që edhe pa këtë problem ishte mjaft e rënduar”.

Midis fëmijëve të dhunuar, takohen edhe fëmijë **që kanë tregues të prapambetjes mendore**, fillimisht të moderuar, por që po nuk u trajtuan ajo mbart rrezikun e përkeqësimit, duke kaluar në nivele më të avancuara dhe më të rënduara të prapambetjes mendore.

“D. është një vajzë në moshën 7 vjeçare. Ndonëse ka arritur moshën shkollore nëna e saj e mbytur në probleme, por edhe e ndërgjegjshme deri në një farë mase për prapambetjen e së bijës, ka vendosur të mos e dërgojë në shkollë. D ka

ardhur në jetë nga një lindje normale, por fill pas lindjes së saj kanë filluar problemet për prindërit. Babai humb punën dhe i vihet pijes. E ëma përpiqet që të punojë më shumë për të kompensuar papunësinë e të shoqit. Ajo dypunësohet dhe kujdesin për fëmijën e lë në duar të nënës së saj. D. sëmuret shpesh në foshnjërinë e saj, nuk merr mjekime, dhe kjo situatë çon në një zhvillim të vonë motor fillimisht (D. ngrihet në këmbë vetëm kur bëhet 2 vjeç). D. ka një fjalor tepër të varfër, me dialektin e gjyshes, tepër të pa zhvilluar për moshën e saj. D. ka vështirësi në shqiptim, gjë që bëhet pengesë për zhvillimin e të folurit. Në tërësi ajo ka një prapambetje të lehtë në koordinimin e proceseve mendore që janë rezultat i problemeve dhe mangësive në vitet e foshnjërisë. Sikur të mos mjaftonin të gjitha sa më sipër, babai i saj vdes nga mbidoza e alkoolit dhe nëna e vajza nxirren në rrugë nga njerëzit e babait. D. sikur e ndjen këtë humbje dhe gjatë gjithë kohës kërkon babain e saj. Tashmë kontaktet me nënën janë rralluar edhe më shumë pasi asaj i duhet të punojë për të mbijetuar”.

Fëmijët e abuzuar përjetojnë një ndërprerje të procesit normal të rritjes së tyre fizike dhe psikologjike. Kjo ndërprerje mund të shprehet në formën e kapërcimit të fazave të rritjes ose të fiksimit në një fazë të hershme të zhvillimit.

2.3. FËMIJËT/ADOLESHENTËT NË RREZIK DHE PROFILI I FAMILJEVE NË RREZIK TË LARTË ABUZIMI

Fëmijët në rrezik – përtej kategorizimeve

Klasifikimi i grupeve në rrezik sipas qeverisë shqiptare jep një kuadër të përgjithshëm për çështjet e problemet që fëmijët hasin. Veprimi ndaj këtyre problemeve rrezikohet për shkak të mos analizimit apo vlerësimit të kompleksitetit të rreziqeve me të cilat fëmijët përballen. Kategorizimet e fëmijëve në rrezik, edhe pse mirë është që bëhen, kanë mungesa në përkthimin e tyre në politika. Kjo mbart rrezikun e hartimit të politikave të cilët nuk përputhen me situatën. Është një pikë e diskutueshme se ku të vendosësh kufirin e asaj që do të quhet punë e detyruar – çfarë lloje detyrimesh për shembull, apo çfarë ndryshimesh ka ndërmjet kategorisë së fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute, duke pasur parasysh që një përkufizim i tillë i ngushtë nuk kap shumë aspekte që përbëjnë përvojën e fëmijëve të varfër ose të mbështesë shumë faktorë që e caktojnë atë (Tahiraj. E., 2008).

Strategjia e qeverisë për përfshirjen sociale thekson grupet mëposhtme si të rrezikuar:

- Fëmijët që jetojnë në varfëri të plotë;
- Fëmijët në komunitete të privuara, në fshatra të largëta dhe ata që jetojnë në zonat peri-urbane rreth rretheve kryesore;
- Fëmijë të trafikuar;
- Fëmijë të paregjistruar, të cilët janë mund të preken sidomos nga trafikimi;
- Fëmijët e rrugës e ato që bëjnë në punë të detyruar;
- Fëmijët romë dhe egjiptianë;
- Fëmijët me aftësi të kufizuar;
- Fëmijë pa kujdesje prindërore;
- Fëmijë të ekspozuar ndaj dhunës apo neglizhencës, dhe ata të prekur nga gjakmarrrja (Tahiraj. E., 2008).

Kategoritë e fëmijëve veçanërisht vulnerabël. Në prioritetet e tij globale, UNICEF ka identifikuar gjashtë situata në të cilat fëmijet kanë nevojë përparësore për mbrojtje (Tahiraj. E., 2008).

- fëmijët që kanë humbur kujdestarin kryesor
- fëmijët në konflikt me ligjin dhe fëmijet viktimë dhe deshmmitarë;
- fëmijët viktimë të trafikimit;
- fëmijët që janë subjekt i punës së fmijëve;
- dhuna në mjedise të ndryshme, përfshirë shtëpinë, shkollën dhe institucionet;
- fëmijët në konflikte të armatosura.

Treguesit e fëmijëve dhe familjeve në rrezik të lartë të abuzimit ose neglizhimit të fëmijëve. Një numër elementesh individualë, ndërpersonalë, komunitarë dhe shoqërorë kontribuojnë në keqtrajtimin, neglizhimin ose shfrytëzimin e fëmijës. Fëmijët nuk janë përgjegjës për dëmin që iu shkaktohet. Ata janë të rrezikuar si rezultat i moshës së tyre, mungesës së pushtetit, statusit të kufizuar që kanë, gjinisë, mungesës së mundësisë për t'u shprehur dhe besimit që u japin të rriturve që kujdesen për ta. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë më shumë mundësi të jenë më të ekspozuar ndaj abuzimit ose mohimit të të drejtave të tyre se sa një fëmijë pa aftësi të kufizuara.

Në vazhdim janë dhënë treguesit e mundshëm që udhëzojnë dhe ndihmojnë në vlerësimin se në këtë familje ka rrezik më të lartë që një fëmijë të dëmtohet ose neglizhohet se sa në një familje tjetër:

- izolimi shoqëror i familjes;
- mungesa e të kuptuarit të nevojave të zhvillimit të fëmijës;
- paaftësitë fizike ose mendore të fëmijës;
- mungesa e kohezionit ose marrëdhëniet jo-funksionale në familje;
- abuzimi i drogës/alkoolit nga prindi/ërit, kujdestari ose kujdestarët;
- prindërit e rinj;
- prindi/kujdestari i vetëm;
- marrëdhëniet e dobëta midis prindërve dhe fëmijës;
- pikëpamjet negative për fëmijës, fajësimi pa vend;
- nivel i lartë i stresit tek të rriturit;
- sëmundjet e shëndetit mendor te prindërit, përfshirë depresionin;
- nivelet e larta të dhunës në komunitet;
- varfëria dhe situata të tjera të pafavorshme socio-ekonomike, si papunësia.

KAPITULLI III

MENAXHIMI I RASTIT

Hyrje

Ky kapitull përqendrohet në përcaktimin e menaxhimit të rastit, identifikon aspekte të përgjithshme të modeleve dhe qasjeve për menaxhimin e rastit si dhe eksploron se si menaxhimi i rastit është i lidhur me praktikën e punës në SHPSSH, duke theksuar qasjen e punës në ekipe multidisiplinare dhe fokusin tek fëmijët/adoleshentët. Ky sesion nënvizon gjithashtu rëndësinë e menaxhimit të rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve në mjediset shkollore. Pjesë e rëndësishme është gjithashtu hartimi i planit individual të menaxhimit të rastit, bazuar në modelin e planit individual për Mbrojtjen e fëmijëve (Sipas Protokollit të NjMF-së) dhe trajtimit shumëplanësh, kombinimi i familjes, mësuesit/ses dhe bashkëmoshatarëve në trajtimin e rasteve.

3.1. MANAXHIMI I RASTIT, PROÇESI I MENAXHIMIT TË RASTIT

Menaxhimi i Rastit është një nga metodat e punës që punonjësi i SHPSSH përdor gjatë praktikës së tij profesionale. Ai është një proces që vlerëson, planifikon, zbaton, koordinon dhe vlerëson mundësitë dhe shërbimet për të plotësuar nevojat e klientit për shërbime shëndetësore dhe humane. Ai karakterizohet nga advokacia, komunikimi, menaxhimi i burimeve dhe promovon njëkohësisht ndërhyrje e rezultate kosto efektive dhe cilësore. Ky proces realizohet nëpërmjet bashkëpunimit në vazhdimësi midis punonjësit dhe klientin në mënyrë që të vlerësohet sa më saktë për çfarë shërbimesh klienti ka nevojë.

Menaxhimi i rastit është një metodologji e cila siguron hap pas hapi ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për individët në nevojë (fëmijë, i rritur apo familje) dhe që synon të promovojë dhe nxitë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqënien e personit.

Menaxhimi i rastit në punën për mbrojtjen e fëmijëve mbështetet dhe

drejtohet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, dhe mbështetet në nevojat e fëmijës, ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës si dhe në bashkëpunimin e ngushtë mes aktorëve të ndryshëm që kanë një ndikim në jetën e fëmijës përfshirë prindërit, mësuesit, personelin shëndetësor, anëtarë të tjerë të familjes, etj.

Ky proces nis me atë që quhet vlerësim i rastit, dhe vazhdon më tej me analizën e informacionit, vlerësimin e nivelit të rrezikut. Duke vazhduar me planifikimin e shërbimeve për rastin, koordinimin e ofrimit të shërbimeve, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit dhe efektivitetit të shërbimit. Ky proces zakonisht drejtohet nga një punonjës social i trajnuar (ndryshe njihet dhe me emrin menaxher rasti), dhe shpesh herë në bashkëpunim me mësues, mjek, polic si dhe specialistë të trajnuar dhe kualifikuar në çështjet e fëmijëve. Duhet theksuar se menaxheri i rastit merret në mënyrë specifike me zbatimin e metodologjisë për menaxhimin e rastit, pra është një punonjës social i trajnuar në mënyrë specifike për këtë qëllim. Ndërkohë që një punonjës social mund ta ketë fokusin e punës dhe më gjerë, përveçse në menaxhimin e rastit.

Çështjet e mbrojtjes së fëmijëve janë çështje komplekse, që kërkojnë një vëmendje të veçantë si tek fëmija, familja dhe tek mjedisi i gjerë, prandaj dhe praktika botërore më e mirë, sugjerojnë se një nga metodat e cila ka rezultuar si efektive është ajo e menaxhimit të rastit. Menaxhimi i rastit zakonisht adreson nevojat komplekse materiale, psiko-sociale, mendore dhe shëndetësore të personit/ fëmijës dhe familjes si dhe statusin e tij/të saj në sistemin social dhe komunitar.

Në procesin e menaxhimit të rastit është e rëndësishme të kuptohen disa aspekte kryesore të përgjithshme, të tilla si: objektivat e metodologjisë, filozofia që shërben si bazë për zbatimin në praktikë, funksionet e menaxherit të rastit, si dhe procedura që ndiqet.

Punonjësi i SHPSSH në këtë proces është përgjegjës për koordinimin e shërbimeve ndaj fëmijës dhe familjes me qëllim mirëqënien e fëmijës krahas ofrimit të drejtpërdrejtë të shërbimeve të ndihmës, duke pasur parasysh se në procesin e menaxhimit të rastit dhe ofrimit të shërbimeve përfshihen aktorë të ndryshëm në varësi të nevojave të fëmijëve si psh, shërbimet shëndetësore, ligjore, psikologjike, etj. Megjithatë duhet pasur parasysh që menaxhimi i rastit është vetëm një metodologji e cila synon të lehtësojë koordinimin dhe dokumentojë ofrimin e ndihmës ndaj rastit sipas nevojave, përmes krijimit të një marrëdhënie me fëmijën dhe/ose familjen. Zbatimi në praktikë i menaxhimit të rastit në mënyrë që të ndikojë sa më mirë në jetën e fëmijës, ndikohet dhe nga faktorë të tjerë si psh: aksesin në shërbime, koordinimi mes ofruesve të shërbimeve, qëndrimet ndaj fëmijës dhe familjes, dëshira e fëmijës dhe familjes

për të ndryshuar, mjaftueshmëria, përshtatshmëria dhe cilësia e shërbimeve, etj.

Roli i menaxherit të rastit është ai i vlerësimit të nevojave, identifikimit të shërbimeve që ofrohen për klientin, koordinimin e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës, dokumentimit, si dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve (Hood, 1997).

Gjithashtu duhet theksuar se punonjësi i SHPSSH e mbështet rastin drejtpërdrejt gjatë kohës që shpenzon kohë me fëmijën dhe familjen për të diskutuar situatën, alternativat e zgjidhjes, si mund të përfitojnë shërbime, duke dëgjuar shqetësimet e tyre dhe duke ofruar mbështetje përmes të qenit prezent, afër dhe duke i kushtuar vëmendje nevojave të fëmijës dhe familjes. Po ashtu, kjo punë e drejtpërdrejtë, përfshin në disa raste, lehtësimin e takimeve mes anëtarëve të familjes, disa herë negocimin për çështje të caktuara, monitorimin e situatës së fëmijës, etj.

Menaxhimi i rastit ndërron procedurat dhe përgjegjësitë e niveleve të ndryshme të ofruesve të shërbimeve. Ky proces nënkupton ofrimin e ndihmës/shërbimeve së drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.

Shërbim i drejtpërdrejtë nënkupton që punonjësi është personi i/cila i përmbush drejtpërdrejtë nevojat e fëmijës dhe/ose të familjes përmes takimeve, vizitave të rregullta në familje, dialogut, inkurajimit, informimit, etj.

Shërbim jo i drejtpërdrejtë nënkupton që punonjësi e referon “rastin” tek një ofrues tjetër shërbimesh (si psh, mjek, avokat, psikolog etj) për të përfituar shërbime. Në këtë rast punonjësi SHPSSH nuk ofron një shërbim drejtpërdrejt por, përmes procesit të referimit mundëson ofrimin e një shërbimi të drejtpërdrejtë tek rasti që ka në menaxhim. Ky referim kryhet pasi punonjësi ka vlerësuar me kujdes nevojat e fëmijës mbështetur në të gjitha parimet e procesit të vlerësimit dhe duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Kur përdoret Menaxhimi i Rastit?

Prindërit e fëmijëve kanë përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e tyre. Këto përgjegjësitë përfshijnë mbështetjen ekonomike, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen, edukimin, socializimin, si dhe ruajtjen e marrëdhënieve familjare të shëndetshme, të cilat në momente apo situata të caktuara nuk përmbushen dot nga prindërit. Në situata të tilla, është detyrë e Shtetit me institucionet e tij, të mbështesë prindërit në përmbushjen e detyrave të tyre. Ndërhyrja në familje përmes metodologjisë së manaxhimit të rastit mund të jetë e nevojshme kur fëmija është veçanërisht vulnerabël dhe kur familja nuk është në gjendje të mbrojë fëmijët pa ndihmën e Shtetit ose organizatave jo fitimprurëse.

Të rriturit kanë si detyrë të mbrojnë veten e tyre dhe familja ka si

detyrë të mbrojnë anëtarët e vet, veçanërisht fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, fëmijët të cilët janë pa kujdes prindëror apo që jetojnë në institucione duhet të mbështeten përmes përdorimit të kësaj metodologjie e cila drejtohet nga parime të cilat janë specifike për këto grupe.

Menaxhimi i rastit përdoret për grupe të ndryshme në nevojë si dhe mund të përdoret si nga strukturat e shërbimeve shtetërore ashtu dhe nga ato jo fitimprurëse, pra organizatat. Kjo metodologji është adoptuar si koncept nga sistemi shëndetësor (zakonisht sëmundjet menaxhohen përmes një sistemi kompleks të menaxhimit të rastit).

3.1.1. Proçesi i Menaxhimi i Rastit

Menaxhimit i rastit është një proçes dinamik dhe kompleks, dhe si i tillë fillon me vlerësimin fillestar të rastit dhe vazhdon me një sërë hapash deri në daljen e fëmijës nga rreziku, të cilët së bashku me familjen mund të vazhdohet të ndihmohen e mbështeten edhe pas daljes nga rreziku përmes programeve të ndihmës.

Në *sistemin e marrdhënieve* përfshihen një grup njerëzish të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek jeta e fëmijës dhe familjes ose ndikim jo të drejtpërdrejtë. Marrëdhëniet, dinamika e tyre, ndryshimet e mundshme në dinamika të marrëdhënies janë të rëndësishme dhe duhen trajtuar me kujdes për t'i shërbyer sa më mirë fëmijës.

Proçesi i menaxhimit të rastit ndjek *qasjet me qendër fëmijën ose të pikave të forta*, të marrjes parasysh të vlerave të familjes, etj. dhe këto aspekte ndikojnë tek qasjet përgjatë proçesit. Punonjësi social duhet të jetë shumë i ndjeshëm dhe i vetëdijshëm për qasjen që po ndërmerr).

Proçesi menaxhimit të rastit karakterizohet nga rezultate, të tilla si hartimi i raportit të vlerësimit fillestar dhe të plotë, hartimi i planit të ndërhyrjes për rastin, etj. dhe si të tilla këto produkte duhet të përmbajnë parimet që karakterizojnë proçesin dhe t'i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës).

Nga pikëpamja sistemike ky proçes apo metodologji synon të ofrojë një mënyrë për të adresuar dhe siguruar që mbështetja dhe ndihma e ofruar për fëmijën dhe familjen është dhënë dhe ka ndikuar në mënyrë pozitive në ndryshimin e synuar në mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu, kjo metodologji është e integruar në të gjithë sistemin e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës dhe synon që të mundësojë funksionimin e plotë të një *sistemi shërbimesh* për të adresuar nevojat e atyre që janë më vulnerabël.

Modeli i trajtimit të rastit përmes metodës së menaxhimit të rastit njihet në shumë shërbime sociale për fëmijë dhe për të rritur:


- në shërbimet e përkujdesit rezidencial,

- në shërbimet për dhunën në familje,
- në shërbimet e shëndetit mendor,
- në shërbimet që ofrohen për trajtimin e viktimave të trafikimit,
- në shërbimet e kujdestarisë së përkohshme,
- në shërbimet për shërbimin e provës,
- në shërbimet që ofrohen për të rinjtë në konflikt me ligjin, etj.

Artikulli 3 (I) i Konventës për të Drejtat e Fëmijës shprehet se në të gjitha veprimet që ndikojnë fëmijën, nëse ndërmerren si nga institucionet publike dhe ato private, gjykatat, autoritetet administrative ose nga struktura legjislative, ato duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës. Ka një dallim të qartë në konceptin e fëmijës si grup demografik dhe të fëmijës si individ, dhe ku në të dyja rastet secili grup ka burimet, nevojat, rrjetin e vet mbështetës dhe vulnerabilitetin individual - ndërkohë që veprimet që duhet të ndërmerren duhet të jenë të tilla që të ndikojnë pozitivisht tek secili prej grupeve pavarësisht përcaktimit, dhe ku konsiderata e parë duhet të ketë në vëmendje fëmijën si individ me nevoja specifike.

Një qasje e mirë dhe funksionale për menaxhimin e rastit duhet të sigurojë që objektivat dhe qëllimet e vendosura për planin për mbrojtjen e fëmijës janë arritur me profesionalitet dhe në mënyrë sistematike si dhe që kjo përjasje ka patur në qendër fëmijën. Fëmija është aktivizuar përgjatë procesit për të mbrojtur veten dhe ky aspekt ka rëndësi njëkohësisht për të ndërtuar më tej reziliencën (rezistencën) dhe rikuperimin e fëmijës nga trauma e abuzimit.

Skema e Manaxhimit të Rastit⁶



6 Protokollin i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve”, 2010. Ministria e Punës, Terre des Hommes, UNICEF.

Modeli i Menaxhimit të Rastit është i rëndësishëm sepse:

- Siguron që çdo fëmijë t'i ofrohet një nivel shërbimi dhe mbrojtje me standarte dhe në interesin më të lartë të tij/saj, adreson kompleksitetin e çështjeve të mbrojtjes dhe mirëqënies së fëmijës.
- Siguron përfshirjen e të gjithë aktorëve përgjegjës për mirëqenien e fëmijës/adoleshentit.
- Mund të lehtësojë ndërlikimet që sjell rasti dhe problematikën e caktuar duke promovuar bashkëpunimin.
- E vendos fëmijën/adoleshentin në qendër, duke fokusur nevojat dhe të drejtat e tij.
- Siguron vazhdimësi të procesit të ndihmës dhe pas daljes nga rreziku.

Nëpërmjet ndjekjes me korrektësi të hapave mundësohet që çdo fëmijë/adoleshent i abuzuar t'i ofrohet i njëjti nivel dhe cilësi shërbimesh mbrojtjeje dhe përkujdesi duke marrë në konsideratë parimin e interesit më të lartë të tij. Aplikimi i të gjitha hapave në menaxhimin e rastit ndihmon punonjës të SHPSSH sepse i jep një kornizë të qartë me veprimet që duhet të ndërmerren si vlerësimi, hartimi i planit individual, koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të planit. Në procesin e menaxhimit të rastit për punonjës, në qendër të procesit është fëmija/adoleshenti.

Proçesi përfshin edhe familjen, por gjithmonë nuk duhet harruar se çdo hap në procesin zinxhir duhet të sigurojë që fëmija/adoleshenti është në qendër të çdo veprimi si dhe faktin që nevojat, vulnerabiliteti dhe kapacitetet e fëmijës/adoleshentit (rastit) janë unik dhe duhen marrë në konsideratë “rast pas rastit”.

Qëllimi i menaxhimit të rastit përsëri është që të ofrojë një sistem transparent koordinimi, monitorimi dhe kontrolli i cili lehtëson një proces që nxit ndërmarrjen e veprimeve për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve. Ky sistem mbështetet shumë fort në përqasjen e punës në skuadër të cilët punojnë së bashku për të marrë dhe menaxhuar vendime me qendër fëmijën/adoleshentin.

Shembull :Tabela e Kontribuesve / Profesionistëve në procesin e Menaxhimit të Rastit ⁷

Profesionistët / Shërbimet	Nevojat Zhvillimore të Fëmijës	Kapacitetet Prindërore	Familja dhe Mjedisi	Nevoja dhe Ofrimi i Shërbimit
Infermier/Mami	Kronologjia e historisë së fëmijës, - që nga foshnjëria, moshë parashkollore, vitet e shkollës, zhvillimi i sjelljes, aspekteve konjitive; parametrat e rritjes, ushqyerja, vaksinimi, higjiena, tregues specifik të abuzimit ose neglizhimit	Historia obsetrike e nënës, vëzhgimet e marrëdhënieve dhe bashkëveprimit prind-fëmijë; vlerësimi i kapacitetit të prindërve për t'iu përgjigjur nevojave bazë të fëmijës si dhe stadeve të ndryshme të zhvillimit shoqëruar me aspekte specifike që mund të shoqërojnë fëmijën	Informacion për anëtarët e tjerë të familjes, rritja dhe zhvillimi i fëmijëve të tjerë në familje, strukturat e tjera mbështetëse të familjes së gjerë, komunitetit në tërësi, kushtet e banimit etj	
Mjek të Përgjithshëm	Kronologjia e historisë mjekësore të fëmijës; probleme shëndetësore të fëmijës, trajtimet e kaluara dhe aktuale shëndetësore; nevojat shëndetësore; tregues specifik të abuzimit dhe neglizhimit të vërejtura, probleme specifike shëndetësore të kaluara dhe aktuale, kequshqyerje etj.	Historiku shëndetësor i prindërve të fëmijës, ndonjë çështje shëndetësore mjekësore ose të shëndetit mendor të evidentuara, historia obsetrike e nënës, observimet e bashkëveprimit prind-fëmijë (pozitiv ose negative)	Informacion për anëtarët e tjerë të familjes, shëndeti i fëmijëve të tjerë.	

⁷ TDH, Moduli i manaxhimit të rastit për mbrojtjen e fëmijëve.

Shërbime të Shëndetit Mendor							
Shërbime pediatrie							
Policia dhe Shërbimi i Provës							
Personeli në arsim (mësues; psikolog etj)							
Shërbimet e asistencës ekonomike							
Shërbimet e asistencës për aftësinë e kufizuar							
Shërbime nga OJF							
Shërbime të kujdesit të përkohshëm							
Shërbime për strehimin							
Vullnetarë...							

Tabela 8. Tabela e Kontribuesve / Profesionistëve në procesin e Menaxhimit të Rastit

3.2. PARIMET BAZËTË MENAXHIMIT TË RASTIT DHE MODELET TEORIKE MBI MENAXHIMIN E RASTIT⁸

Sipas Bowles (2009) 4 janë parimet kryesore që duhen patur parasysh gjatë menaxhimit të rastit:

1. **Respekti për personin** – detyrimi për të respektuar mendimet, dëshirat, shqetësimet dhe opinionet e personit.
2. **Të ofrosh shërbime që përmirësojnë mirëqenien dhe minimizojnë rrezikun.**
3. **Drejtësia dhe Barazia** - detyrimi për të qënë i drejtë në shpërndarjen e përfitimeve dhe vlerësimin e rrezikut.
4. **Shmangia ose minimizimi e dëmtimit** - detyrimi për të mënjanuar lëndimin e të tjerëve të përfshirë në proces.

3.2.1. Aspekte të përbashkëta dhe ndryshimet midis menaxhimit të rastit dhe punës individuale me rastin

Menaxhimi i rastit ka lidhje me punën për trajtimin e rastit, por njëkohësisht ndryshon nga puna individuale me rastin në disa aspekte si fokusi i punës tek persona të cilët përjetojnë të gjitha këto kufizime:

- Kufizime në funksionimin personal
- Kufizime në funksionimin social
- Nivel të lartë varësie, të përkohshme ose gjatë gjithë jetës (të fëmijës dhe familjes).
- Nevoja të shumëfishta të cilat kërkojnë të plotësohen nga shërbime formale dhe jo formale (si dhe fokusin tek fëmija dhe familja).
- Nevoja për të pasur akses në një sistem shërbimesh edhe pasi fëmija del nga niveli i rrezikut.

Në rastin e nevojave të shumëfishta, klientët e menaxherit të rastit kanë dhe nevojën për të pasur akses në shërbime, ndikojnë që ai/ajo të ketë rolin e një lehtësuesi për t'i ofruar rastit shërbimet e duhura për plotësimin e nevojave. Gjithashtu menaxheri i rastit krijon një marrëdhënie me rastin e cila ka rolin e saj në përmirësimin e situatës së rastit, por edhe ekspertiza e menaxherit me shërbimet që mund të ofrohen për nevojat e rastit është një komponent i rëndësishëm.

8 TDH, Moduli i menaxhimit të rastit për mbrojtjen e fëmijëve.

Ndërsa përsa i përket punës individuale me rastin, dallimi qëndron në ofrimin e shërbimit të drejtpërdrejtë nga profesionisti që mund të jetë një punonjës social ose psikolog tek klienti. Ndërsa në rastin e punonjësit si menaxher i rastit, ai vlerëson nevojat e fëmijës dhe mundëson aksesin tek shërbimet, dhe jo ofrimin e drejtpërdrejtë të tyre. Megjithatë, duhet nënvizuar, se menaxheri i rastit duke qenë në kontakt me fëmijën dhe familjen, që në momentin e parë që përfshihet në këtë marrëdhënie ka mundësinë për të “injektuar” ndryshim në mjedisin familjar ose të fëmijës, prandaj ndonëse nuk ofron një shërbim të drejtpërdrejtë dhe specifik, ofron mbështetjen dhe motivimin ku mund të nxiten proceset e ndryshimit pozitiv tek rasti që menaxhohet.

Rosmann dhe Sager (1998) kanë listuar 3 funksione të cilat e dallojnë menaxhimin e rastit nga trajtimi individual i rastit si:

1) *angazhimi me komunitetin* duke u bazuar në modelin ekologjik të zhvillimit për të analizuar ndikimin që ka mjedisi në zhvillimin e individit, dhe një aspekt i rëndësishëm është hartëzimi i shërbimeve që ofrohen në komunitet në mënyrë që të plotësohen nevojat e rastit. Një funksion i cili nuk realizohet në rastin e punës individuale me rastin ku fokusi është tek individ, ndjenjat, mendimet, sjelljet e tij dhe jo në ndikimin e mjedisit tek ai.

2) *diversiteti dhe kultura* janë shumë të rëndësishme për menaxherin e rastit, ku sjelljet jo diskriminuese dhe njohja e kontekstit kulturor të rastit e lehtësojnë punën me njerëz të cilët vulnerabiliteti i tyre i bën që të krijojnë varësi dhe të jenë lehtësisht të shfrytëzueshëm.

3) *advokimi* për nevojat e rastit dhe të komunitetit ku jeton në mënyrë që të stimulohet gjithëpërfshirja dhe jo përjashtimi nga shërbimet i grupeve më vulnerabël, ku fokusi mund të jetë promovimi i interesit të një individ ose i një numri individësh.

Përveç dallimeve midis menaxhimit të rastit dhe trajtimit të rastit ekzistojnë edhe elementë të përbashkët: PSHPS gjatë menaxhimit të rastit duhet të marrë gjithmonë në konsideratë mendimet dhe ndjenjat e fëmijës dhe ta bëjë atë dhe familjen, pjesë të procesit duke u konsultuar vazhdimisht.

3.2.2. Modelet teorike mbi menaxhimin e rastit

Ekzistojnë një sërë qasjesh të cilat janë cilësuar si më kryesoret në procesin e menaxhimit të rastit. Të gjitha këto përjasje e pajisin punonjësën me perspektiva të rëndësishme të cilat duhet të konsiderohen me kujdes gjatë punës me fëmijën dhe familjen. Një problem i përbashkët sidomos gjatë procesit të planifikimit është se shpesh herë profesionistët nuk janë specifikë

në identifikimin e ndërhyrjeve të veçanta specifike dhe sesi këto ndërhyrje mund të ndikojnë dhe përmbushin nevojat e fëmijës dhe familjes. Pra plani i ndërhyrjes mbetet i përgjithshëm.

Po ashtu, mund të ndodhë që të merret në konsideratë një faktor ose aspekt që është më i dukshëm sesa një aspekt më pak i dukshëm (psh abuzimi fizik krahasuar me atë emocional), ose faktorët e familjes dhe jo faktorët e lidhur me shëndetin apo komunitetin ku jeton një fëmijë dhe sesi ato mund të vazhdojnë të ndikojnë tek fëmija dhe pas adresimit të dhunës brenda familjes. Një tjetër aspekt mjaft kritik në procesin e menaxhimit të rastit dhe në veçanti në hartimin e planit të ndërhyrjes është dhe njohja mirë e roleve dhe përgjegjësi të aktorëve të ndryshëm të cilët mund të ndihmojnë dhe ofrojnë shërbime për fëmijën dhe familjen.

Teoria ekologjike

Qasja ekologjike ose modeli ekosistemit është një ndër më të përdorurat në literaturën e mirëqenies sociale dhe në praktikën e punës sociale. Kontributi i modelit ekologjik në menaxhimin e rastit (Zastroë, 2000) është në:

- Personi në mjedis (zhvillimi individual, përballimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre, marrëdhëniet që personi krijon me mjedisin gjatë ndërveprimit me të, sistemet shoqërore përshtatja me to ose mospërshtatja).
- Problemet kalimtare dhe nevojat (cikli i jetës së individëve, familjeve dhe grupeve shoqërore).
- Sjelljet e keqpërshtatura ndërpersonale (proçesi i komunikimit, marrëdhëniet, etj.)

Kjo qasje ndihmon për të vendosur në praktikë parimin se klienti (në rastin tonë fëmija) duhet parë në mënyrë tërësore/holistike. Në kundërshtim me modelet e hershme mjekësore të punës sociale që fokusohen në mangësitë individuale dhe trajtimin e tyre, modeli ekologjik e shikon personin në mjedisin e tij social dhe në kontekstin e ndërveprimeve me mjedisin rrethues. Individu dhe mjedisi janë parë si plotësues të njëri-tjetrit, pjesë të ndërvarura të së tërës. Sipas këtij modeli problemet ndodhin ose krijohen kur nuk ka një përputhje të “mirë” midis nevojave të personit dhe aftësive dhe kërkesave apo burimeve të mjedisit, ku problemet nuk krijohen si rrjedhojë e dobësisë së personit por e ndërveprimit të tij me mjedisin. Duke u bazuar tek ky model është e rëndësishme që gjatë vlerësimit të rastit apo planifikimit të ndërhyrjeve, të përfshihet personi, mjedisi dhe ndërveprimet midis tyre (Pincus & Minhan 1976).

Llojet e sistemeve të cilat influencojnë personat janë:

- Sistemet informale ose sistemet natyrore (familja, miqtë)
- Sistemet formale (grupet komunitare, qendrat tregtare, etj.)
- Sistemet shoqërore (spitalet, shkollat, etj.)

Personat mund të hasin vështirësi në përdorimin e këtyre sistemeve sepse:

- Sistemet mund të mos ekzistojnë në jetën e tyre (ato mund të mos kenë burimet për të pasur akses në këto sisteme ose sistemet mund të mos jenë të përshtatshme për nevojat e tyre).
- Personat mund të mos jenë në dijeni të ekzistencës së tyre.
- Politikat e sistemeve mund të krijojnë probleme për përdoruesit.
- Sistemet mund të kenë konflikte me njëri tjetrin.

Sistemet dhe njerëzit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, secili ndryshim reflektohet tek tjetri, dhe problemet ndodhen kur sistemet sillen negativisht ndaj personit. Kështu në këtë këndvështrim supozohet që problemet ndodhin nga ndërveprimi i personit me sistemet informale, formale dhe shoqërore. Kur klientët nuk janë të aftë të negociojnë me sistemin ato kanë nevojë për një guidë që ti ndihmoj ato të rinegociojnë apo rintegrohen në sistem.

Në kornizën e modelit ekologjik menaxheri i rastit duhet që të identifikojë dhe kuptojë kapacitetin e personit për tu përballur me sfidat e mjedisit përreth në çdo kohë. Në mënyrë të barabartë, menaxheri i rastit duhet të vlerësoj mjedisin në mënyrë që të siguroj që burimet dhe mbështetja e përshtatshme janë të pranishme (Libassi, 1992). Psh këtu mund të sillen rastet kur procedurat për rregjistrimin e lindjes së fëmijës janë shumë komplekse dhe kërkojnë pagesa të pa përballueshme për familjen, ose kur ofrohet një shërbim shëndetësor duhet që fëmija të jetë i rregjistruar më parë, ose kur familja nuk përfiton dot ndihmë ekonomike sepse është e pa informuar me procedurat etj.

Disa nga instrumentet që përdoren rëndom nga punonjësit në procesin e vlerësimit janë genogramat apo ekohartat, të bazuara në konceptet e modelit ekologjik të individit në mjedisin rrethues.

Teoria e fokusuar tek detyrat dhe zgjidhja e problemeve

Qasja tjetër teorike mjaft e përdorur në punën sociale është ajo e orientuar drejt detyrave dhe zgjidhjes së problemeve. Kjo teori fokusohet në atë se si klienti mund të kontrollojë në mënyrë racionale përgjigjen e tyre emocionale ndaj ngjarjeve të jashtme edhe stresin që shkaktohet. Shkurtimisht, kjo perspektivë teorike kontribuon në menaxhimin e rastit në dy mënyra:

- Fokusi tek problemi, paaftësia për të plotësuar nevojat dhe dëshirat, koncepti i vetes në një shoqëri influencon besimet mbi problemin, opinionet dhe veprimet, menaxheri lehtëson dhe mëson teknikat e zgjidhjes së problemeve.
- Plani i veprimit i drejtuar drejt qëllimit, me hapa konkret, praktikim të vazhdueshëm dhe ciklik (planifiko, vepro, rishiko, planifiko, vepro, rishiko, etj.)

Kontributi thelbësor në këtë teori është dhënë nga puna e Ëilliam Reid (1978), i cili argumenton se qeniet njerëzore janë të vetëvendosura, duke pasur mendime të ndryshme dhe motivime të ndryshme të cilat ndikohen nga kushte të jashtme dhe të brendshme. Sipas tij problemet lindin kur personi dëshiron të ketë diçka që nuk mund ta ketë.

Duke qenë se në përgjithësi problemi është psikosocial, planet e tij dhe veprimet përfshijnë edhe të tjerët individët, grupet, dhe organizatat që ndërtojnë sistemet. Kështu që është e rëndësishme të përqendrohemi në faktorët që shkaktojnë problemet dhe si mund të ndryshohen. Pasi të identifikohen nevojat menaxheri i rastit duhet të hartojë planin se si ti plotësoj këto nevoja në nivel praktik.

Kjo kornizë teorike nuk tenton që të identifikojë apo adresojë shkaqet e fshehura psikologjike në nivelin personal apo social të funksionimit të klientit. Ajo supozon që emocionet e personit derivojnë nga ndërveprimet midis besimeve dhe dëshirave. Kur një dëshirë ose nevojë nuk realizohet apo plotësohet ankthi dhe frika shfaqet. Veprimi është mënyra më e mirë për të lehtësuar ankthin dhe frikën, dhe duhet të ndërmerret menjëherë dhe nuk duhet të anashkalohet. Kur të ndërmarrë një veprim personi duhet të jetë i vetëdijshëm se çfarë dëshiron të arrijë, dhe duhet të planifikohet më parë veprimi duke vlerësuar alternativat e ndryshme. Klientët mund të mos kenë aftësitë për të vepruar në disa rrethana të veçanta dhe ato duhen mësuar nëpërmjet planifikimit të hapave specifik në planin e veprimit.

Duke qenë se në të shumtën e rasteve dëshirat dhe nevojat mund të plotësohen vetëm nga ndërveprimi me mjedisin dhe sistemin për të ofruar shërbimet në varësi të nevojave. Gjatë punës me klientin qëllimi është që të ndihmohen për të zgjidhur problemet që i shqetësojnë dhe të ofruarit e një modeli se si mund të zgjidhen problemet. Reid zhvilloi një model të mësuarit social që ka të bëjë me identifikimin e qëllimeve dhe arritjen e tyre, duke përdorur teorinë e komunikimit mbi pasojat e komunikimit në sjellje, në këtë këndvështrim qëllimi nuk është të identifikohen përgjigjet emocionale të klientit por hapat, pengesat në veprim dhe shqetësimet e pandryshueshme.

Modeli i zgjidhjes së problemeve - Nga problemi tek pikat e forta dhe zgjidhjet e tij. Compton & al.(2005) ilustroi se si teoria e detyrave është përshtatur në teorinë dhe praktikën e punës sociale. Në këtë mënyrë nëpërmjet identifikimit të pikave të forta të problemit sigurohet një zbatim më i mirë në praktik se sa fokusi tek pikat e dobëta.

Menaxheri i rastit mund të punojë me persona të cilët mund ta ndihmojnë rastin në arritjen e objektivave. Gjithashtu menaxheri i rastit mund të ndajë disa detyra me klientin në rastin kur ai nuk ka aftësitë e mjaftueshme ose burimet për të përballuar një situatë i vetëm.

Teoria humaniste

Vetë termi humaniste jep një kuptim thelbësor të teorisë e cila ka dalë nga këshillimi në psikologji dhe në punën sociale. Kjo teori e ndihmon praktikën duke identifikuar elementët e efektivitetit të marrëdhënieve ndihmuese dhe dallimin e aftësive komunikuese përsa i përket impaktit në përpjekjet e klientit për ndryshim.

Teoritë humaniste dhe konstruksioniste tentojnë që të nënvizojnë rëndësinë e marrëdhënies që krijohet ndërmjet menaxherit të rastit dhe klientit. Termi “personi në qendër” ose “klienti në qendër”, ku këshillimi është bazuar në teorinë që qeniet njerëzore mundohen që të nxjerrin një kuptim të botës që ata po përjetojnë. Të gjitha qeniet njerëzore kanë kapacitetin për të përmirësuar jetën e tyre. Ky përmirësim ndodh kur individ i është i aftë që të marrë përsipër pushtetin personal që ka dhe kjo arrihet nëpërmjet vetaktualizimit.

Kontributi i kësaj teorie tek menaxhimi i rastit qëndron në disa elementë :

Së pari duke ofruar udhëzime mbi qëndrimin dhe përjasjen që duhet të kenë menaxherët e rastit për të vendosur marrëdhënie ndihmuese me klientin,

Së dyti korniza e tyre na drejton tek disa strategji komunikimi që ndihmojnë menaxherët e rastit për të lehtësuar klientët për të marrë përsipër kontrollin mbi situatën dhe jetën e tyre.

Vendosja e marrëdhënieve efektive ndihmuese: Geldard & Geldard (2005) diskutuan kontributin e Karl Rogers me teorinë e personit në qendër me cilësitë e nevojshme për të vendosur një marrëdhënie efektive ndihmuese. Kështu që cilësitë kyç janë emërtuar me etiketa të ndryshme por ka një mirëkuptim të gjithanshëm. Vërtetësia, harmonia, empatia, qëndrimi i pakushtëzuar pozitiv, respekti, ngrohtësia, dhe qëndrimi jo-gjykses janë thelbësore në një marrëdhënie ndihmuese e cila synon vetëaktualizimin .

Përcaktimi i prioriteteve – nivelet e ndërhyrjes ⁹




3.3. NDËRTIMI I NJË PLANI NDËRHYRJE PËR MENAXHIMIN E RASTIT, TRAJTIMI SHUMËPLANËSH

Rastet e identifikuara të fëmijëve/adoleshentëve të abuzuar duhet të trajtohen dhe merren në mbrojtje nga ofruesit e shërbimeve nëpërmjet ndërmarrjes së një sërë veprimesh si dhe bashkëpunimit të menjëhershëm me aktorë të tjerë apo struktura përgjegjëse që operojnë në territor, të tilla si Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë NjQV, shërbimet shëndetësore, OJF të specializuara, etj. Këto ndërhyrje duhet të realizohen bazuar në një plan të individualizuar në raport me nevojat specifike të fëmijës/adoleshentit dhe mjedisit të tij familjar e social. Diagrama e mëposhtme mund të jetë një model efektiv për ndërtimin e një plani veprimesh të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës:

⁹ Protokollin e punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve”, 2010. Ministria e Punës, Terre des Hommes, UNICEF.

Diagrama e veprimeve që duhet të ndërmerren në rastet e mbrojtjes së Fëmijëve¹⁰



10 "Protokolli i punës për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve", fq 40-44

Parimet e zhvillimit të planit individual të menaxhimit të rastit

Detajet e një plani individual janë etapa ndaj të cilave matet progresi i një familje dhe angazhimi i punonjësve, prandaj është e rëndësishme që ato të jenë realiste dhe jo përshkrime të vagëta të qëllimeve të mira. (Departamenti i Shëndetit et al. 2000, fq 60)

Plani duhet respektojë parimet e mëposhtme:

1. të ketë në qendër fëmijën dhe interesin më të lartë të tij;
2. të bazohet tek faza e zhvillimit të fëmijës;
3. të bazohet në nevojat e vlerësuara dhe format e mbrojtjes për të cilën ka nevojë;
4. të përfshijë punën në partneritet me fëmijën dhe familjen;
4. të adresojë çëshjet në një periudhë afatshkurtër, afatgjatë, afatmesëm;
5. të jetë gjithëpërfshirës;
6. të jetë i vazhdueshëm;
7. të jetë cilësor;
8. të konsultohet me partnerët në takimet multidisiplinar;
9. të respektojë vlerat tradicionale/kulturore të familjes por jo nëse këto e vendosin fëmijën në rrezik.

Dimensionet që duhet të merren me kujdes në konsideratë gjatë hartimit të Planit Individual të menaxhimit janë:

- Nevojat zhvillimore të fëmijës
- Kapacitetin prindëror
- Faktorët e mjedisit dhe familjes

Këto dimensionet përputhen me dimensionet që merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit të rastit. Është e rëndësishme që punonjësi i SHPSSH të sigurojë lidhjen mes nevojave të vlerësuara të fëmijës si dhe adresimit të këtyre nevojave përgjatë procesit të hartimit të planit të individual të menaxhimit të rastit.

Model i planit individual për Mbrojtjen e fëmijëve (Sipas Protokollit të NjMF-së)

Plani Individual për Mbrojtjen e Fëmijëve			Periudha nga :	Deri në:
Rreziku	Veprimi	Afati i fundit	Ofruesi i shërbimit	

Tabela 9. Model Plani Individual

Shpjegimi i Planit të mbrojtjes për fëmijët

Disa mënyra janë:

- Biseda individuale me fëmijën.
- Nëpërmjet tregimit të një historie të ngjashme të një fëmije tjetër (në varësi të moshës).
- Nëpërmjet vizatimit, lojës, etj.

Elementët që duhen pasur parasysh gjatë shpjegimit janë:

- Mosha e fëmijës
- Niveli i rrezikut që fëmija ndodhet
- Impakti që do të ketë në jetën e fëmijës plani i menduar (ndryshimet që do të sjelli zbatimi i planit në jetën e fëmijës)
- Pasojat e traumës në zhvillimin e fëmijës
- Agresorin e fëmijës
- Dëshirat, të drejtat, dhe nevojat e fëmijës
- Potencialet që fëmija ka (resiliencën e tij)
- Prirjet apo talentet e fëmijës.

Të gjitha këto aspekte kërkojnë një analizë të mirë të mbështetur në procesin e vlerësimit, diskutimit me fëmijën, familjen dhe aktorët e grupit multidisiplinar. Pasja e një plani individual nuk garanton domosdoshmërisht që situata e fëmijës dhe mirëqenia e fëmijës do të përmirësohet, megjithatë ky plan shërben si një pikënisje për procesin e ndihmës ndaj fëmijës.

Koordinimi mes të gjithë aktorëve, ofrimi i shërbimeve me cilësi, në kohë, me qendër fëmijën, bashkëpunimi i vazhdueshëm me fëmijën, familjen apo me institucionin që do të kujdeset fëmija janë disa prej faktorëve që sigurojnë që ky plan do të sjellë një ndryshim pozitiv në jetën e fëmijës dhe se do sigurojë mbrojtjen dhe promovojë mirëqenien e fëmijës.

Metodat kryesore të koordinimit janë:

- Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve
- Kontakti me ofruesin e shërbimeve me telefon ose vizita të rregullta
- Rishikimi i progresit të rastit duke kontaktuar atë ose kujdestarin e tij
- Pjesëmarrja në mënyrë të rregullt në takimet multidisiplinare rishqyrtuese për rastin

Monitorimi

Objektivat e monitorimit janë të sigurohet që rasti po përfiton shërbimin e pritshëm sipas planit të miratuar dhe menaxheri i rastit mban kontakt të vazhdueshëm me rastin dhe ofruesin e shërbimeve (Leëin &Feming, 1984, fq 149-150). Po ashtu, është e rëndësishme të evidentohet sesi po përfiton ose çfarë ndryshimi pozitiv po ndodh në jetën e fëmijës dhe /apo familjes si rezultat i marrjes së shërbimeve të ofruara në bazë të planit. Ka shumë raste kur pavarësisht se fëmija mund të marrë shërbime të caktuara, situata e tij/ e saj nuk ndryshon. Dhe kjo për arsye të ndryshme, si psh, cilësia e shërbimeve është e ulët, prindërit mund të vazhdojnë të manipulojnë me ofruesit e shërbimeve, ose nuk e çojnë fëmijën për të marrë shërbime, ose mungon koordinimi dhe bashkëveprimi mes profesionistëve për të diskutuar për rastin etj. Në mënyrë që menaxheri të monitorojë zbatimin e planit ai është i përfshirë dhe ndjek pjesëmarrjen e rastit në shërbimet e ofruara. Nëse marrëdhënia është solide, kjo nuk nënkuptohet si thyerje e privatësisë nga rasti.

Monitorimi dhe koordinimi janë dy procese të cilat kanë shumë vështirësi për t'u implementuar:

- Së pari është e vështirë për menaxherin e rastit të monitoroj punën e stafit të një qendre apo specialisti ku rasti është referuar, sepse ai mund të perceptohet negativisht.
- Së dyti ofruesit e shërbimeve mund të kenë perceptim tjetër në lidhje me atë që është zgjidhja më e mirë e mundshme për rastin.

Metodat kryesore të koordinimit janë:

- Hartimi i një memorandum/marrëveshjeje bashkëpunimi midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve;
- Kontakti me ofruesin e shërbimeve me telefon ose vizita të rregullta;
- Rishikimi i progresit të rastit duke kontaktuar atë ose kujdestarin e tij;
- Pjesëmarrja në mënyrë të rregullt në takimet multidisiplinare rishqyrtuese për rastin.

Metodat kryesore të monitorimit janë:

- Kontakti me telefon;
- Vëzhgimi i fëmijës/familjes si një metodë;
- Vizita në familje;
- Takime /diskutime të rregullta me rastin, kujdestarin, ofruesit e shërbimeve;
- Organizimi i takimeve të rregullta rishqyrtuese të rastit mes profesionistëve.

Arsyet e mbylljes së rastit:

- Kur fëmija ose familja e tij ndërron vendbanim dhe largohet në një zonë tjetër jashtë juridiksionit të NJMF;
- Kur fëmija nuk konsiderohet më në rrezik apo në nevojë;

Vendimi për mbylljen e rastit duhet të merret në takimin multidisiplinar. Mbyllja e rastit duhet të shoqërohet me një raport përmbyllës të rastit.

Punonjësi social në përgjithësi në shërbimet për mirëqenien e fëmijës duhet të ndjekë me kujdes planin e ndërhyrjes dhe puna për mbylljen e rastit fillon që në fillimin e procesit kur fëmijës dhe familjes i shpjegohet thjeshtë dhe qartë i gjithë procesi, nga momenti i fillimit, vazhdimësia dhe momenti i mbylljes kur janë përbushur të gjitha qëllimet dhe fëmija është i mbrojtur dhe nuk

ka më nevojë për ndonjë alternativë ndërhyrjeje. Një element i rëndësishëm në fund të procesit të ndihmës është një ri analizim i burimeve, pikave të forta dhe mundësive që ka familja/adoleshenti për të vazhduar përbalimin e realitetit në mënyrë të tillë që të mos vendosë përsëri në rrezik fëmijën.

Kjo analizë bëhet së bashku me familjen, dhe synohet të evidentohen dhe një herë gjithë burimet dhe pikat e forta ku mund të mbështetet familja si brenda rrethit familjar ashtu dhe në atë komunitar. Punonjësi social punon ngushtësisht për të referuar dhe lidhur familjen me këto burime si dhe në disa raste advokon në mënyrë që familja/adoleshenti të vazhdojë të përfitojë nga shërbime të caktuara komunitare apo ditore.

Ky proces është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për të siguruar që fëmija/adoleshenti vazhdon të jetë i mbrojtur dhe i sigurt por gjithashtu dhe për të aftësuar familjen të jetë e pavarur dhe që të vazhdojë të gjejë mundësi për të mirë funksionuar.

KAPITULLI IV

SISTEMI I MBROJTJES SË FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Hyrje

Ky sesion fokusohet në qartësimin e kornizës ligjore që siguron mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Kapitulli ka si qëllim të japë njohuri të mjaftueshme ofruesve të shërbimit psiko-social në shkolla mbi kuadrin ligjor që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe që është i zbatueshëm në vend si dhe të prezantojë ata me Mekanizmin Kombëtar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe me institucionet lagjencitë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

4.1 LEGJISLACIONI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është e sanksionuar në ligje, si në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i Shqipërisë, Kodet si dhe në ligje specifike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Përkufizimi i “fëmijës” në Shqipëri:

Sipas **Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve**, të cilën e ka ratifikuar shteti Shqiptar, në 27 shkurt 1992, Fëmijë është: **“çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet”**.

Sipas legjislacionit shqiptar **“fëmijë konsiderohet personi që kur lind, deri në moshën 18 vjeç, moment kur ai fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar”**.

Mbrojtja e fëmijës sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë :

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Nenin 54, ka parashikuar se çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi e përdorimi për punë, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën ose zhvillimin e tij/saj normal.

Nga kjo dispozitë kushtetuese del qartë konsiderimi i fëmijës si subjekt i mbrojtjes së posaçme në të cilën me një status të cilësuar, vjen mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi, kurse shfrytëzimi është i lidhur kryesisht me qëllimin për punë.

Mbrojtja e Fëmijës sipas Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti i Shqipërisë:

Sipas Kushtetutës të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ratifikuara nga shteti shqiptar, bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar për sa kohë normat e tyre janë të vetëzbatueshme, që do të thotë se nëse ato nuk vendosin detyrime për shtetin për të ndërmarë nisma ligjore të tjera apo të pajtohen me të.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.
3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj.

Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës 1989, e ratifikuar nga Shqipëria në 27.02.1992.

Neni 3

Interesi më i lartë i fëmijës

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, gjykatat,

autoritetet administrative apo organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet palë anashohen që ti sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose personave të tjerë ligjorisht përgjegjës për të dhe për këtë qëllim ata marrin të gjitha masat legjislativë dhe administrative përkatëse.
3. Shtetet palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Fëmija është subjekt që shteti duhet t'i garantojë mbrojtjen e posaçme për shkak të moshës së mitur, interesi më i lartë i fëmijës është mekanizmi me të cilin shoqëria jonë e të rriturve do të balancojë veprimtarinë vendimmarrëse shtetërore, publike dhe private në favor të fëmijëve. Ky koncept gjithashtu do të ndihmojë vendimmarrjen në rastet kur paraqiten interesa konkurruese si: midis vetë fëmijëve, midis fëmijëve dhe familjeve të tyre, midis fëmijëve dhe shtetit.

Neni 19

E drejta për t'u mbrojtur nga çdo lloj dhune

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat legjislativë, administrative, shoqërore, edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, neglizhimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.
2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë kur është e përshtatshme procedura për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera si parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë nëse duhet procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.

Në bazë të këtij Neni Shtetet Palë duhet të mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit nga ana e prindërve të tyre ose personave të tjerë të cilëve ju janë besuar, përfshirë mësuesit, stafin e qendrave të kujdesit për fëmijë, etj.

Ky nen në mënyrë të dukshme shkon përtej mbrojtjes kundër dhunës

duke përfshirë trajtime që në vetvete mund të mos arrijnë në nivelin e dhunës ose trajtimit abuziv por të cilat mund të përfshijnë keqtrajtim ose neglizhim. Ky nen përfshin edhe dhunën psikologjike, fyerjen ose kërcënimin.

Protokolli opsional i Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e fëmijëve”, “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë” synon që shtetet palë në të, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me qëllim garantimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve nga fenomene të tilla si shitja, prostitucioni dhe pornografia me ta.

Konventa nr. 138 “Për moshën minimale për t’u pranuar në punë” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila synon që shtetet palë në të, të marrin masa të menjëhershme dhe efektive për të eliminuar punën e fëmijëve dhe ngritjen e moshës minimale për pranimin në punë.

Konventa nr. 182 “Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999” e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila synon që shtetet palë në të, të marrin masa të menjëhershme dhe efektive për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve sipas legjislacionit Kombëtar

Kodi i Familjes. Në Nenin 215 të Kodit të Familjes theksohet përgjegjësia prindërore për sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës. Po ashtu në Kodin e Familjes parashikohen masa ekstreme lidhur me keqpërdorimin e përgjegjësisë prindërore. Ligji parashikon një masë ekstreme: heqjen e përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore, kur tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose në rastet kur prindi me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijës.

Në Nenin 228 parashikohet “heqja e përgjegjësisë prindërore” në rastet e shpërdorimit të ushtrimit të saj. Ky përbën një bazë të rëndësishme për zbatimin e një sërë masash në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe neglizhimi i tyre në familje.

Në Nenin 281 parashikohen marrja e “masave urgjente” në mbrojtje të fëmijës. Në këtë kontekst gjykata mund të vendosë fëmijën në një kujdestari të përkohshme.

Këto nene përbëjnë një bazë të mirë të marrjes së masave të ndryshme nga ato penale për prindërit, ose kujdestarët e fëmijëve, në mbrojtje të fëmijëve në rastet e dhunës, abuzimit keqtrajtimit apo neglizhimit.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon një numër veprash

penale me karakter ndëshkimit e veprimtarisë kriminale me subjekt të mitur. Në vitin 2012, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë pësoi disa ndryshime, ndërmjet të tjerave, edhe në lidhje me rastet e abuzimit në familje. Me këto ndryshimeve, dhuna në marrëdhënie familjare, si dhe përndjekja nga persona që kanë pasur apo kanë lidhje shpirtërore me viktimën e dhunës përbëjnë vepra të posaçme penale.

Në ndryshimet më të fundit që i janë bërë këtij Kodi në prill të vitit 2013, janë parashikuar rrethana rënduese në rastet e dhunës në familje kur një vepër penale kryhet ndaj fëmijëve ose në praninë e tyre. Masa rënduese janë parashikuar në këtë Kod edhe përsa i përket abuzimit seksual me të mitur, marrëdhënie seksuale me të mitura nën moshën 14 vjeç, etj.

“.....Kur kjo vepër kryhet ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.”

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Nr. 9355, datë, 10.03.2005. Ligji për Shërbimet Sociale nuk i përmend në mënyre eksplicite shërbimet për të trajtuar fëmijët viktime të dhunës. Megjithatë në nenin 31, pika (f), ai vendos detyrimin për administratorët shoqërorë në bashki edhe komuna të vlerësojnë nevojat e individëve dhe familjeve që kërkojnë shërbime shoqërore, e kushtëzuar kjo nga mundësitë financiare dhe përparësitë kombëtare.

Me akte nënligjore të këtij ligji janë përcaktuar edhe përgjegjësitë që ka qarku në ngritjen e shërbimeve të reja në nivel qarku. Sistemi i referimit sipas këtij ligji është administratori shoqëror këshilli i bashkisë/komunës, institucioni rezidencial i përkujdesit shoqëror apo shërbimi shoqëror ditor, etj. Ligji 9669 “Përmasat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” plotëson e përcakton mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje.

Ligji nr 9669, dt 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktime të dhunës në familje, **duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve**, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Ky ligj jep për herë të parë në legjislacionin shqiptar definicionin e

termi “dhunë” që parashikohet në nenin 3, sipas të cilit dhunë është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, ndërsa si dhunë në familje përcaktohet çdo akt dhune midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat e saj. Ligji përcakton për herë të parë masa mbrojtjeje për viktimën nëpërmjet dy instrumentave kryesore: “Urdhërit të Mbrojtjes” dhe “Urdhërit të menjëhershëm të Mbrojtjes”, i cili lëshohet nga gjykata. Sipas këtij ligji, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtjeje për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përbalueshme dhe të thjeshtë.

Një urdhër mbrojtjeje: është një vendim gjykate dhe përcakton një sërë masash mbrojtëse për viktimën/viktimat e dhunës në familje. Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes nëse gjen prova të mjaftueshme për të besuar se dhunuesi mund të kryejë një veprim dhune në familje ose kur lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e viktimës ose anëtarëve të familjes.

Një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje: është një urdhër i përkohshëm gjykate i vlefshëm deri në lëshimin e një urdhri të rregullt mbrojtjeje. Mund të lëshohet nëse abuzuesi paraqet një “rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së viktimës ose anëtarëve të familjes së saj/tij”. Atëherë kur personi i dëmtuar nga dhuna është i mitur, gjykata ka vetëm 24 orë për të marrë një vendim nga paraqitja e kërkesës. Në rastet kur ky person nuk është i mitur, gjykata duhet të vendosë brenda 48 orëve. Gjykata do të caktojë gjithashtu një datë për vazhdimin ose ndërprerjen e urdhrit brenda 20 ditëve nga lëshimi i tij.

Të dy urdhrat hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit nga gjykata dhe janë të vlefshëm pavarësisht faktit nëse abuzuesi/ja është njoftuar ose jo.

Megjithëse lloji i mbrojtjes mund të luhatet në varësi të rrethanave individuale, një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje mund të përfshijë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- urdhëron dhunuesin që të ndalojë së kryeri ose së kërcënuari se do të kryejë një akt të dhunës në familje kundër paditësit (viktimës) ose anëtarëve të tjerë të familjes të viktimës;
- detyron dhunuesin që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose të tërthorazi me viktimën apo pjesëtar të familjes së viktimës;

- largon dhunuesin nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër gjykatë dhe e pengon të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;
- pengon dhunuesin që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës;
- ndalon dhunuesin që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose banesës së ardhshme të çiftit ose banesës së personave të tjerë, dhe për më tepër shkollës së fëmijëve apo çdo vendi tjetër të frekuentuar shpesh nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
- vendos viktimat dhe të miturit në qendra strehimi të përkohshme;
- kufizon ose ndalon dhunuesin që të takojë fëmijën e viktimës;
- ndalon dhunuesin që të hyjë ose qëndrojë në banesën e përkohshme ose të përhershme të viktimës, ose në çdo pjesë të banesës, pavarësisht nga të drejtat e zotërimit apo pronësisë që dhunuesi mund të ketë mbi këto objekte;
- urdhëron një person të autorizuar nga gjykata (polic ose përmbarues) që të shoqërojë viktimën ose dhunuesin në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;
- urdhëron punonjësit e policisë që të sekuestrojnë çdo armë në zotërim të dhunuesit dhe të gjetur gjatë kontrollove të policisë, ose urdhëron dhunuesin që të dorëzojë çdo armë në zotërim të tij ose të saj;

Përveç sa më sipër, një urdhër i rregullt mbrojtjeje gjithashtu mund të:

- urdhërojë dhunuesin që të lejojë viktimën të zotërojë banesën në përdorim të përbashkët ose pjesë të saja;
- urdhërojë dhunuesin që të paguajë qiranë për banesën e përhershme ose të përkohshme të viktimës si dhe të paguajë detyrime financiare për viktimën, fëmijën, ose pjesëtarë të tjerë të familjes në ngarkim të viktimës;
- kalojë kujdesin e përkohshëm të fëmijëve të viktimës dhe përkohësisht t'i heqë dhunuesit të drejtat prindërore;
- vendosë dhe urdhërojë ndërhyrjen e shërbimeve sociale publike ose private të vendbanimit ose të organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;
- urdhërojë dhunuesin që të kryejë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues të cilët, si pasojë e masës së mësipërme mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar kryerjen e pagesës, gjykata

mund të urdhërojë punëdhënësin e dhunuesit që ta transferojë pagesën drejtpërdrejt te përfituesi;

- dërgojë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitime;
- urdhërojë dhunuesin që të marrë pjesë në programe rehabilitimi.

Urdhri i mbrojtjes dhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes lëshohen pasi një kërkesë-padi (kërkesë me shkrim) paraqitet në gjykatë.

Kërkesa për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet nga:

- vetë viktimia;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- policia/prokurori.

Nëse viktimia është i mitur, kërkesën për urdhër mbrojtjeje në emrin e tij mund ta paraqesin:

- prindi ose kujdestari i tij;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i tij;
- të afërmit e tij;
- përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimia, kur ata kanë dijeni mbi dhunën e shkaktuar;
- qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje të njohura/licencuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- policia apo prokuroria
- personat ligjërisht përgjegjës për të miturin.

Kërkesa për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund të paraqitet nga:

- vetë viktimia;
- përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- policia/prokurori;
- një pjesëtar i familjes së viktimës;
- përfaqësues të zyrës të shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku viktimia ka banim të përhershëm apo të përkohshëm, të cilët kanë dijeni mbi incidentet e dhunës në familje që kanë ndodhur;

- qendra dhe shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të përmendura më lart.

Sa kohë duhet për të marrë një urdhër mbrojtjeje?

Një kërkesë për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në gjykatë në çdo kohë. Pasi paraqitet një kërkesë, gjykata ka 15 ditë kohë për të caktuar një seancë dëgjimore për të vendosur nëse do të lëshohet urdhri i mbrojtjes.

Kur paraqitet një kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje për një të mitur, gjykata vendos **brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës**. Atëherë kur kërkesa ka të bëjë me një person që nuk është i mitur, gjykata vendos brenda 48 orëve. Nëse urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes lëshohet, gjykata duhet të caktojë një seancë dëgjimore brenda 20 ditësh nga lëshimi dhe të vendosë nëse do ta zëvendësojë me një urdhër mbrojtjeje të rregullt ose jo.

Të paditurit do t'i kërkohet të jetë i pranishëm në seancë, por nëse ai ose ajo nuk paraqitet, seanca do të vazhdojë normalisht për sa kohë i padituri është njoftuar. Mosfunksionimi i sistemit postar nuk përbën arsye për të shtyrë seancën dëgjimore. Risi në aspektin e ekzekutimit të këtij vendimi është fakti i përfshirjes në këtë proces përveç punonjësve të përmbarrimit, të efektivave të policisë, dhe të punonjësve socialë të njësive të qeverisjes vendore.

Ligji nr 9669, dt 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përcakton edhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij që janë : MPCSSHB si autoriteti kryesor dhe Ministria e Drejtësisë, e Shëndetësisë, Arsimit, e Brendshme si dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore. Ky ligj synon të ngrejë një sistem raportimi, referimi dhe trajtimi të viktimave të dhunës familjare.

Në mbështetje për zbatimin e këtij ligji janë marrë edhe disa vendime mjaft të rëndësishme si “Ngritja e mekanizmit të bashkëpunimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, si dhe “Ngritja e Qendrës kombëtare të rehabilitimit të viktimave të dhunës në familje”.

Ligji, Nr.10 347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën. *Ligji ka për qëllim:*

- Mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

- Marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- Marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- Sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

Dispozitat ligjore lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre gjejnë rregullim në ligje të veçanta në fushën e drejtësisë për të miturit, në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, mbrojtjes sociale etj.

Ligji kuadër merr përsipër përcaktimin e të drejtës së mbrojtur, ndërkohë që ligji specifik në fushat e sipërpërmendura rregullon në mënyrë konkrete procedurën e përfitimit të të drejtës, si dhe institucionin përgjegjës që do të garantojë këtë të drejtë. Ligji kuadër merr përsipër ngritjen e këtyre mekanizmave institucionale si dhe koordinimin e tyre për t'iu përgjigjur më mirë interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe garantimit të të drejtave të tyre. Gjithashtu, parashikohet si detyrim ligjor bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet këtyre mekanizmave, duke e rregulluar këtë marrëdhënie nëpërmjet rregullave që do të përcaktojnë Këshilli i Ministrave.

Në ligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për mbrojtjen e të drejtës së fëmijës, organ këshillimor që do të ketë në përbërje të tij 9 anëtarë, të cilët do të jenë përfaqësues të ekzekutivit, të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, parashikohet se pranë Këshillit do të ngrihen komitete teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht, në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmarrë ky organ. Në ligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i një institucioni qendror, i cili është Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ky institucion do të funksionojë nën varësinë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe do të kryejë detyrat e parashikuara në ligj.

Ky Ligj nuk synon vetëm përcaktimin e të drejtave, por edhe garantimin e zbatimit të tyre, duke parashikuar në dispozita konkrete mekanizmat institucionale në nivel qendror e vendor që do të përcaktojnë dhe konsultojnë politikat, legjislacionin dhe masat për të drejtat e fëmijëve; do të garantojnë e koordinojnë me autoritetet shtetërore përgjegjëse mbrojtjen konkrete të një fëmije në rrezik (të dhunuar, fëmijët e rrugës etj); do të ndëshkojnë shkelësit e ligjit.

Ligji përcakton se fëmijë në rrezik konsiderohet fëmija të cilit i mohohen ose i cënohen të drejtat, ku përfshihen edhe fëmijët ndaj të cilëve ushtrohet dhunë në familje, institucione arsimore, institucione ku trajtohet

apo mbahet i ndaluar, si dhe ata që shfrytëzohen për lypje nga prindërit / përfaqësuesit e tyre ligjor (fëmijët e rrugës).

Nëse konstatohet që ndaj një fëmije janë ushtruar forma të dhunës apo keqtrajtimit të sipërcituar, kushdo ka të drejtë që të referojë rastin konkret në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili do të funksionojë pranë njësive të qeverisjes vendore.

Njësia e referon rastin në grupin multidisciplinar, që do të ngrihet pranë saj, për të vlerësuar e analizuar rastin konkret, nevojat urgjente për mbështetje, duke njoftuar njëkohësisht organet kompetente të policisë e sistemit të drejtësisë. Përfaqësuesit e organeve të policisë dhe drejtësisë (në atë njësi vendore) do të jenë pjesë e mekanizmit, i cili do të bashkërendojë punën ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik në nivel vendor.

Nëse konstatohet që ndaj një fëmije është ushtruar dhunë në familje apo është shfrytëzuar nga familja për të kryer punë, për të lypur etj., atëherë personi ligjërisht përgjegjës për fëmijën (që mund të jetë mësuesi në shkollë, edukatori etj.) si dhe organet e policisë/prokurorisë, bazuar edhe në Ligjin për Dhunën në Marrëdhëniet Familjare, kanë të drejtën që të kërkojnë drejtpërdrejt në gjykatë nxjerrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtje për fëmijën. Gjykata brenda 24 orëve jep vendim, duke u shprehur edhe lidhur me sistemin e fëmijës në përkujdesje alternative - pranë një familjeje kujdestare apo institucioni të përkujdesit shoqëror.

Gjithashtu, organet e policisë e prokurorisë mund të fillojnë ndjekjen penale ndaj prindërve/përfaqësuesit ligjor të fëmijës, bazuar në nenin 124 të Kodit Penal “Keqtrajtimi fizik dhe shfrytëzimi i fëmijës” dhe në Kodin e Familjes, duke kërkuar deri edhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, ndaj prindit dhunues apo shfrytëzues. Pra, këta elementë bëjnë që ligji të mos jetë thjesht përcaktues apo deklarues i të drejtave të fëmijëve, por edhe garantues i zbatimit të tyre.

Nga ana tjetër, ligji ka trajtuar në mënyrë më të hollësishme të drejtat për të cilat legjislacioni i fushës përkatëse nuk ka rregullime të detajuara për masat konkrete që duhet të ndërmerren për garantimin e tyre, ndërkohe që të drejtat për të cilat legjislacioni në fuqi i ka trajtuar hollësisht, ligji ka përcaktuar thjesht të drejtën, duke ia lënë rregullimin ligjit të veçantë.

P.sh. e drejta për **kujdes shëndetësor (neni 19 i ligjit)** ka gjetur rregullim të veçantë lidhur me masat që duhet të ndërmerren për garantimin e kësaj të drejte.

4.2 MEKANIZMAT NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Në Ligjin “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” janë parashikuar mekanizmat institucionalë përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe garante për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë mekanizmat në nivel qendror dhe në nivel vendor. Gjithashtu, parashikohet si detyrim ligjor bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet këtyre mekanizmave, duke e rregulluar këtë marrëdhënie nëpërmjet rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Ligji parashikon ngritjen dhe funksionimin e **Këshillit Kombëtar** për mbrojtjen e të drejtës së fëmijës, organ këshillimor që ka në përbërje të tij 9 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të ekzekutivit, të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, parashikohet se pranë Këshillit do të ngrihen komitete teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht, në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmarrë ky organ.

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është institucioni qendror më i rëndësishëm për mbrojtjen e fëmijëve. Ky institucion funksionon nën varësinë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe lidhet direkt me strukturat lokale dhe rajonale të mbrojtjes së fëmijëve.

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka:

- funksione ekzekutuese në drejtim të monitorimit të zbatimit të ligjit;
- propozuese për udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
- mbështetëse teknike, për strukturat e organeve të qeverisjes qendrore, vendore dhe për organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- koordinuese me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacioneve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- si dhe ndëshkuese ndaj subjekteve të cilat shkelin dispozitat e ligjit.

Funksionet dhe detyrat që i janë ngarkuar Agjencise janë të reja dhe nuk mbivendosen me detyra apo funksione të institucioneve të tjera shtetërore.

Për të kompletuar kuadrin institucional që ligji synon të krijojë me qëllim zbatimin efektiv të tij, parashikohen ngritja e njësisë për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku dhe bashkie apo komuna. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së

të drejtave të fëmijëve, duke filluar që në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, ligji parashikon funksionimin e këtyre njësive brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në këtë ligj.

Njësia për të drejtat e fëmijëve në Këshillin e Qarkut. Kjo njësi kryen veprimtarinë e saj brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut dhe ka për detyrë të adresojë çështjet sociale brenda territorit të qarkut. Funksionet kryesore të kësaj njësie janë monitorimi i zbatimit të ligjit dhe politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe raportimi i situatës pranë Këshillit të Qarkut dhe Agjencisë Shtetërore për fëmijët, koordinimi i procesit të referimit të rasteve të mosrespektimit të të drejtave të fëmijës apo abuzimit duke siguruar funksionimin e grupit multidisiplinar dhe duke bashkërenduar me strukturat përgjegjëse të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe ofr-të në nivel qarku.

Krijimi i grupit multidisiplinar në nivel qarku është një masë e përkohshme deri në krijimin e Njesisë së Mbrojtjes së në çdo njësi të pushtetit vendor.

Njësia për Mbrojtjen e të Fëmijëve. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve është pjesë e strukturës së Drejtorisë së Shërbimit Social dhe ndihmës Ekonomike në Bashki/Komuna dhe ofron shërbime sociale mbrojtëse për fëmijët dhe familjet me banim brenda territorit të bashkisë/komunës dhe synon të promovojë të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve. Qëllimi i punës së saj është mbrojtja e fëmijëve ndaj çdo lloj forme abuzimi, neglizhimi, përjashtimi social, shfrytëzimi, trafikimi dhe fenomeneve të tjera që çenojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Fëmijët dhe familjet që kanë nevojë për ndihmë mund të drejtohen pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për të marrë informacion apo për tu referuar tek shërbime të tjera mbështetëse sipas nevojave që ata kanë. Në mbështetje të Ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” është edhe vendimi për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij.

Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, përbëhet nga:

1. Komiteti Drejtues “Për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik”;
2. Grup Teknik Multidisiplinar;

3. Njësia për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku;
4. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel bashkie/komune.

Komiteti Drejtues, “Për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik“, funksionon pranë çdo Këshilli të Qarkut dhe kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe në përbërje të tij anëtarë janë:

1. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë
2. Drejtuesi i Tryezës Teknike të Komiteteve Rajonale Anti-Trafik
3. Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale
4. Drejtor i Drejtorisë së Rrethit të Shëndetit Publik
5. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
6. Kryetarë të bashkive/komunave të qarkut
7. Drejtor i strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë/komunës
8. Drejtor i Njesisë për të drejtat e fëmijës në qark
9. Punonjësi për të drejtat e fëmijës në qark
10. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë
11. Drejtor i Zyrës Rajonale të Punësimit
12. Përfaqësues të shërbimit të provës
13. Përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë tyre merren me çështje
14. të të drejtave të fëmijëve
15. Ofrues publikë e privatë të shërbimeve sociale.

Grupi Teknik Multidisiplinar është një grup ad hoc i cili funksionon pranë bashkisë/komunës, thirret në bazë të vlerësimit fillestar, drejtohet nga Drejtori/Përgjegjësi i shërbimeve sociale në bashki/komunë, dhe ka këtë përbërje:

1. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë;
2. Përfaqësues i strukturës së Policisë;
3. Përfaqësues i Shërbimit Social Rajonal;
4. Përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale;
5. Administratori i ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore i bashkisë/komunës ku jeton fëmija;
6. Prindërit/ kujdestarët ligjorë/përfaqësuesit ligjorë të fëmijës ose anëtarët

e familjes;

7. Edukatorja e kopshtit ose mësuesi/ja e shkollës të fëmijës;
8. Koordinator i punonjësve të SHPS në DAR, punonjësi social/psikologu i shkollës;
9. Specialistët e shëndetit, mjeku i familjes apo një specialist që ka vizituar apo vlerësuar fëmijën;
10. Koordinator i për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare në bashki/ administratori shoqëror i ngarkuar për çështjet e dhunës në komunë;
11. Çdo specialist që njeh fëmijën ose që mund të flasë për një problem që është shqetësues për fëmijën (avokat, psikolog, punonjës social, specialistë që ofrojnë shërbime të specializuara lidhur me zhvillimin e fëmijës etj.);
12. OJF-të që ofrojnë shërbime për fëmijën, ofrues publikë, privatë të shërbimeve sociale;
13. Fëmija, bazuar në moshën dhe shkallën e pjekurisë dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

Në takimet e Grupit Teknik Multidisiplinar ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut ku bën pjesë edhe bashkia/komuna si dhe persona ose institucione, pjesmarrja e të cilëve gjykohet si e domosdoshme për menaxhimin e rastit.

Menaxhimi i rastit përfshin masat dhe koordinimin e ndërhyrjeve të ndërmara nga Punonjësi Social me detyrën për menaxhimin e rastit duke u udhëhequr nga interesi më i lartë i fëmijës dhe përfshin specialistët e strukturave dhe shërbimeve publike dhe jopublike si dhe individë që kanë ndikim në jetën e fëmijës, në procesin e identifikimit, vlerësimit të rrezikut dhe nevojave të fëmijës dhe familjes, planifikimin e ndërhyrjeve, zbatimin dhe ofrimin e shërbimit dhe ndihmës, monitorimit si dhe rishqyrtimin e situatës deri në momentin që fëmija nuk është më në rrezik.

Menaxhimi i rasteve është dhe duhet të jetë funksioni parësor i çdo Njësie të Mbrojtjes së Fëmijës dhe si i tillë ai duhet konsideruar dhe mbështetur fuqimisht nga të gjithë aktorët përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve të të gjitha niveleve.

Përfaqësuesi i Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve ka një rol kryesor në referimin e rasteve të dhunës në familje pranë Mekanizmit kombëtar të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje që ngrihet pranë çdo bashkie.

Mekanizmi kombëtar i referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje

Mekanizmi kombëtar i referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, është një mekanizëm i posaçëm në nivel bashkie. Ngritja e tyre përmbush edhe një nga qëllimet e ligjit të dhunës i cili është garantimi i mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje në të gjithë vendin.

Ngritja e tyre është një detyrim i strukturave shtetërore përgjegjëse për të mbështetur strukturat e posaçme përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje, të cilat do ti përgjigjen rasteve të dhunës në familje në mënyrë të koordinuar dhe në veçanti detyrimin që ka MPÇSSHB si autoriteti kryesor përgjegjës për mbikqyrjen e këtij procesi.

Mekanizmi kombëtar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga:

- 1) Komitetet Drejtuese;
- 2) Ekipet teknike ndërdisiplinore;
- 3) Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

1) Komitetet Drejtuese, “Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje”, të cilat drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe në përbërje kanë si anëtarë: përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel lokal (të zyrave rajonale të arsimit, shëndetësisë, punësimit, shërbimeve sociale, prefekturës, kryetarët e komunave); përfaqësues të policisë së Shtetit, Gjyqësorit dhe Prokurorisë, Zyrës së Përmbartimit; përfaqësues të Shoqatave dhe Strehëzave që ofrojnë mbrojtje dhe shërbime për viktimat e dhunës në familje; përfaqësues të komuniteteve fetare.

Përfaqësuesit në Komitetet Drejtuese janë në nivel drejtues, nëse pranë bashkive ku këto Komitete ngrihen, funksionojnë institucione të sistemit të drejtësisë, të strukturave arsimore, shëndetësore dhe të punësimit. Nëse pranë bashkive nuk funksionojnë institucionet e sipërpërmendura, institucionet që funksionojnë në qendrën e Prefekturës dërgojnë përfaqësues të tyre në komitetet e këtyre bashkive. Pra siç shihet përbërja e Komiteteve Drejtuese është gjithëpërfshirëse duke synuar koordinimin sa më të mirë të mundshëm të të gjithë aktorëve, në mënyrë që me vendimarrjen e tyre ti përgjigjen rasteve të dhunës në familje në kohë e me cilësi si për mbrojtjen

ashtu dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje.

Komiteti Drejtues është një Komitet koordinues ad-hoc, i cili do të kryejë funksione si identifikuese të problemeve specifike në lidhje me dhunën në familje dhe zbatimin e Ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; vlerësuese për punën e ekipit teknik ndërdisiplinor; rekomandues për përmirësimin e veprimtarisë së këtij ekipi, koordinuese për strukturat në nivel vendor; dhe ndërgjegjësuere nëpërmjet organizimit të trajnimeve të personelit dhe njohjes së qytetarëve me çështje të funksionimit të strukturave të krijuara për këtë qëllim.

Komitetet Drejtuese në çdo Bashki janë të detyruara të raportojnë për ecurinë e punës çdo tre muaj pranë Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duke paraqitur edhe propozime konkrete në rastin kur kërkohet mbështetje nga institucionet qendrore. Përfaqësuesit e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor, gjithashtu raportojnë çdo tre muaj, në institucionet e tyre qendrore, për aktivitetin e tyre në Komitet Drejtues “Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje”. Proçedurat e funksionimit të Komiteteve Drejtuese përcaktohen në Rregulloret e miratuara nga Këshillat Bashkiakë.

2)-Ekipet teknike ndërdisiplinore. Me Vendime të Komiteteve Drejtuese, përcaktohen ekipet teknike ndërdisiplinorë të cilat përbëhen nga përfaqësues të të gjitha institucioneve të përfaqësuara në këto Komitete Drejtuese, përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, si dhe profesionistë të lirë (avokatë, psikologë etj).

Detyrat e Ekipave Teknike Ndërdisiplinore përcaktohen në pikën 9 të Projektvendimit dhe janë pikërisht këto ekupe të cilat merren me ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve konkrete të paraqitura pranë tyre duke siguruar lidhjen e viktimave me shërbimet e përshtatshme. Gjithashtu ky ekip merret me koordinimin e rasteve, përcjelljen e tyre në Komitetet Drejtuese.

Rregullat dhe proçedurat e funksionimit miratohen nga Komitetet Drejtuese. Ekipi Teknik drejtohet nga Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon Komitetin Drejtues “Për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje”.

3) Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Detyrat e koordinorit, të cilat kanë të bëjnë me

koordinimin e punës me aktorët e përfshirë në proces; ndërmjetësimin pranë OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore që ofrojnë shërbimet, policisë, gjykatave; asistimin e viktimave për ndjekjen e procedurave për marrjen e Urdhrave të Mbrojtjes dhe Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes, mbikqyr mirëmbajtjen dhe përditësimin e dosjeve të referuara, organizon dhe monitoron takime për menaxhimin e rasteve; mban lidhje me strukturën përgjegjëse në MPÇSSHB nëpërmjet koordinimit të organizimit të trajnimeve që ndërmerr kjo strukturë për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin; mbajtjen e një data baze për rastet e referuara, harton raporte tre mujore të cilat i paraqet në Komitetin Drejtues.etj.

Strukturat dhe mënyrat e ndërhyrjes në ndihmë të viktimave të dhunës në familje

Viktima e dhunës në familje, ose çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund të drejtohet tek:

çdo strukturë vendore e autoriteteve përgjegjëse shtetërore, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin ku shtrin juridiksionin e saj bashkia;

- prokuroria;
- gjykata;
- një avokat;
- një OJF e specializuar në këtë drejtim;
- koordinatori i dhunës në familje pranë njësisë së qeverisjes vendore;
- specialisti i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë bashkisë;
- psikologu i shkollës.

Për rastet që kërkojnë ndërhyrje emergjente, pavarësisht se në cilin prej institucioneve të përcaktuara më lart, drejtohet viktima e dhunës, secili prej tyre ka detyrimin të njoftojë koordinatorin vendor të dhunës, i cili/e cila, sipas vlerësimit të tij/saj, njofton përfaqësues të tjerë të ekipit teknik ndërdisiplinor, me qëllim mbërritjen së bashku në vendngjarje dhe trajtimin e menjëhershëm të rastit, sipas detyrave që përcakton ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar), për secilin autoritet përgjegjës.

Koordinatori vendor i dhunës për rastet e ndërhyrjes emergjente, së bashku me përfaqësuesin e policisë, bëjnë analizën paraprake të ngjarjes që përfshin: një intervistë kokë më kokë me viktimën, me abuzuesin si dhe

me anëtarë të tjerë të familjes, vlerësim të nivelit të dhunës, dokumentim të fakteve, plotësimin e formularit standart, shoqërimin në institucionet e shëndetit parësor (nëse është e nevojshme), transportimin e viktimës së dhunës në një vend të sigurtë. Gjithashtu këta dy përfaqësues të ekipit ndërinstitutional do të përcaktojnë se cilët anëtarë shtesë dhe cilat burime nevojiten për ndërhyrjen e parë dhe/ose të menjëhershme.

Pas dhënies së ndihmes së parë viktimës, koordinatori i dhunës shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor. Për rastet që nuk kërkojnë ndërhyrje emergjente, institucionet/organizatat, duke respektuar vullnetin e viktimës së dhunës (së rritur), njoftojnë koordinatorin vendor të dhunës, i cili shtron rastin për shqyrtim në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor. Më tej në mbledhjet e thirrura, anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor, hartojnë një plan të përbashkët ndërhyrjeje për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar. Të gjitha rastet e evidentuara të dhunës në familje duhet të referohen pranë Koordinatorit vendor të dhunës i cili është përgjegjës për mbajtjen e përditësimit të dhënave në sistemin online të raportimit të rasteve të dhunës në familje.

KAPITULLI V

TEKNIKA TË KËSHILLIMIT TË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Hyrje

Në këtë kapitull trajtohen njohuritë dhe shprehjet kryesore të intervistimit dhe këshillimit, duke u fokusuar fillimisht në dallimin midis përdorimit të këtyre dy metodave të punës me individë dhe grupe. Pjesë e çështjeve të trajtuara janë gjithashtu intervista me 5 faza dhe cikli i vendimmarrjes. Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të përforcojë dhe thellojë njohuritë dhe aftësitë e ofruesve/këshilluesve shkollorë në lidhje me teknikat e intervistimit dhe këshillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve të abuzuar.

5.1 TEKNIKA TË INTERVISTIMIT DHE KËSHILLIMIT

Qëllimi i këshillimit dhe intervistimit është zhvillimi. Njerëzimi duket se ka një aftësi të pafundme për rritje. Akoma ju do të gjeni të ulur para jush klientë të cilët janë bllokuar, paralizuar, dhe të paaftë për të përballuar sfida zhvillimi. Më poshtë do të përpiqemi të shpjegojmë si-në e intervistimit dhe këshillimit: si ju në rolin e këshilluesit mund të lehtësoni rritjen zhvilluese të një personi tjetër?

Këshillimi kundrejt intervistimi. Termat këshillim dhe intervistim shpesh përdoren në mënyrë të ndërkëmbyer. Kështu dhe mbivendosja është e konsiderueshme, intervistimi mund të konsiderohet si procesi themelor i përdorur për mbledhjen e informacionit, zgjidhjen e problemeve, dhe dhënien e këshillave apo informacionit. Intervistuesit mund të jenë udhëheqës të një grupi, personel mjekësor, biznesmenë, profesionistë të tjerë që kanë role ndihmuese. Këshillimi është një proces më tepër personal dhe intensiv. Ky shpesh ka të bëjë me ndihmesën që i jepet personave normalë në zgjidhjen e problemeve. Megjithatë shumë njerëz që intervistohen edhe mund të këshillohen; këshillimi është shpesh i shoqëruar me fusha profesionale të

punës sociale, psikologjisë, këshillimit pastoral, dhe më i kufizuar në psikiatri.

Në mund ta qartësojmë ndryshimin midis këshillimit dhe intervistimit me disa shembuj. Një menaxher personeli mund të intervistojë një kandidat për një punë, por pas disa çastesh këshillon një nëpunës, i cili është duke vendosur në qofte se do të shkojë në një post të ri në një qytet tjetër. Një këshillues shkolle mund të intervistojë çdo anëtar të një klase për 10 minuta për të bërë një përzgjedhje; por mund të këshillojë disa prej tyre kur ata kanë probleme për të zgjidhur. Një psikolog mund të intervistojë një person për të marrë të dhënat kërkimore, por pas pak ai mund të këshillojë një klient i cili ka një problem lidhur me dhunën në familje. Në një kontakt të vetëm, një punonjës social mund të intervistojë një klient për të marrë të dhëna financiare dhe pastaj ta këshillojë atë rreth marrdhënieve personale.

Shumë njerëz që intervistohen shpesh e gjejnë veten e tyre edhe të këshilluar. Shumica e këshilluesve në të njëjtën kohë e gjejnë veten të intervistuar. Si intervistimi dhe këshillimi mund të dallohen mjaft qartë nga psikoterapia, i cili është një proces akoma më tepër intensiv, që fokusohet në vështirësitë e sjelljes, apo në problemet e personalitetit. Por shumë terapistë ndonjëherë e gjejnë veten të funksionojnë edhe si intervistues edhe si këshillues. Shprehitë dhe konceptet e intervistimit të qëllimshëm janë njëlloj të rëndësishme për kryerjen e psikoterapisë.

Qëllimshmëria në intervistim dhe këshillim. Mënyra se si një person tjetër e koncepton botën është një mjet mjaft i vlefshëm. Në të njëjtën kohë nëse ju krahasoni se çfarë ju shkruajtët me të tjerët, ju do të gjeni ndoshta përgjigje të ndryshme. Një pyetje çelës është “kush e bëri përgjigjen korrekte në këtë rast”? Një përgjigje që mund t’i jepet është vazhdimi i pyetjes, pra t’i kërkojmë klientit “A mund të më tregoni më tepër”? Në një rast tjetër mund të jetë më e dobishme për të reflektuar ndjenjat psh.: “Duket se ju jeni tmerrësisht e mërzhitur rreth situatës me Benin”. Dhe përsëri, ndonjëherë është nevoja që të flisni hapur dhe të jepni një këshillë direkte (“Eksperiencia ime me Benin është... dhe unë sugjeroj që ju të përpiqeni...”).

Intervistuesit që sapo kanë filluar eksperiencën, shpesh janë të etur të gjejnë përgjigjen “e drejtë” për klientin. Në fakt ata janë aq të etur saqë shpesh ata japin një këshillë të shpejtë, që është e papërshtatshme. Psh. është e mundur që faktorë të tillë kulturorë si etnia, rraca, përkatësia gjinore, mënyra e jetesës, orientimi fetar mund të kenë përcaktuar përgjigjen dhe planin e intervistimit për ndjekjen e klientit. Sa ideale do të ishte të gjendej përgjigja perfekte që do të hapte derën e botës së klientit, dhe do ti jepte mundësinë individit për një jetesë më kreative! Gjithsesi, tendencat për të kërkuar për një përgjigje të drejtë dhe për të lëvizur shpejt janë të dëmshme.

Qëllimshmëria në intervistim është e lidhur jo me përgjigjen e vetme që mund të jetë korrekte por me shumë përgjigje potenciale që mund të jenë të dobishme. Qëllimshmëria është qëllimi kryesor i një intervistimi efektiv. Ne mund ta përcaktojmë atë si më poshtë:

Qëllimshmëria është të vepruarit me një sens aftësie dhe vendosja midis disa veprimeve alternative. Individit i qëllimshëm ka për të zgjedhur më shumë se një veprim, mendim ose sjellje në përgjigje të ndryshimit të situatave të jetës. Individit mund të gjenerojë alternativa në një situatë të dhënë dhe të përballojë problemin nga këndvështrime të ndryshme, duke përdorur shprehje dhe veti personale të ndryshme, duke përshtatur stile që mund tu përputhen individëve dhe kulturave të ndryshme.

Intervistuesit me këndvështrim kulturor zbatojnë një rregull bazë të ndihmës, në qoftë se diçka që ju provoni nuk ka sukses, mos tento në të njëjtën – tento diçka tjetër.

Qëllimshmëria kulturore dhe zhvillimi. Një nga pikat kritike është fakti që disa shprehje të njëjta mund të kenë efekte të ndryshme në njerëz me karakteristika individuale dhe prejardhje kulturore të ndryshme. Në intervistimin e qëllimshëm kërkohet që çdo grup të ketë modele të ndryshme komunikimi. P.sh. kontakti me sy ndryshon. Në kulturën tonë, modelet e klasës së mesme praktikojnë kontaktin direkt me sy, por në disa grupe të tjera kulturore kontakti me sy konsiderohet si i papërshtatshëm. Është e rëndësishme të kujtojmë që fjala kulturë mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme. Besimi, klasa, prejardhja etnike, gjinia, ndryshimet e stilit të jetës ashtu si dhe niveli i zhvillimit të personit apo paaftësia fizike gjithashtu paraqesin ndryshime kulturore.

Çdo grup që ndryshon nga “rrjedhja kryesore” e shoqërisë mund të konsiderohet subkulturë. Të gjithë në kohë të ndryshme jemi kështu pjesë e kulturave që kërkojnë një vetëdije unike të një eksperience grupi. Në fakt, gjithnjë në rritje shumë njerëz sugjerojnë që diversiteti është ai çka përbën dhe rrjedhën kryesore. Kjo mund të çojë në konkluzionin që respektimi dhe nderimi i ndryshimeve tona është ajo çka na bashkon të gjithë si një popull.

Kështu nuk është korrekte të pranojmë që modelet e komunikimit funksionojnë me këdo, pavarësisht nga prejardhja kulturore. Ndihmuesit efektivë do të jenë fleksibël të ndërrojnë përjasjet kur shohin se gjërat nuk shkojnë mirë. N.q.s. për shembull ju gjeni se pyetjet janë jo efektive, mos përdorni më pyetje. Ndoshta ju duhet të ngadalsoheni pak dhe të provoni një shprehje tjetër, siç është përpjekja për tu hapur apo dëgjuar më me kujdes.

Për më tepër, individët ndryshojnë aq shumë sa ndryshojnë kulturat. Ju

do të doni t'i harmonizoni përgjigjet tuaja me atë të personit unik që qëndron para jush. Mungesa e qëllimshmërisë në një intervistë tregohet kur ndihmësi ngulmon në përdorimin e vetëm një shprehje, në përcaktimin e një problemit, edhe të një teorie intervistimi, edhe kur ajo teori nuk funksionon.

Zhvillimi ka qenë përshkruar si qëllimi i intervistimit dhe këshillimit. Klientët vijnë tek ne për të zgjidhur problemet, për të gjetur përgjigjet, për të zbuluar arsye për modelet e sjelljes, por gjithmonë për të zhvilluar potencialin e tyre unik. Zhvillimi dhe vlerësimi i nivelit të zhvillimit është koncept qëndror në këshillim, i cili do ta shqyrtohet më vonë. Atje do të nxiteni të kërkonti dhe ekzaminoni mospërputhjet dhe mospërshtatjet e klientit dhe më pas të përdorni konfrontimin dhe shprehi të tjera, për të lehtësuar zhvillimin e tyre. Intervistimi dhe këshillimi i suksesshëm dhe i vlefshëm do të evidentohet nga fakti se si klienti zhvillohet dhe ndryshon nëpërmjet intervistës.

Mikroshprehjetë janë njësi shprehish komunikuese të intervistimit që do t'iu ndihmojnë të zhvilloni aftësitë për të ndërvepruar në mënyrë më të qëllimshme me një klient. Ato do t'ju japin alternativa specifike për ti përdorur me tipe të ndryshëm klientësh. Mikroshprehjetë përbëjnë themelin e intervistimit të qëllimshëm.

Struktura e intervistës motivacionale është në formën e një cikli – kompletimi i një interviste duke përdorur vetëm sekuencën bazë të dëgjimit dhe vlerësimin që interviston për kuptim empatik: raport / strukturim, përcaktimi i problemit, përcaktimi i qëllimit, eksplorimi i alternativave dhe konfrontimi i mospërputhjeve, përgjithësimi në jetën e përditshme.

Pyetjet e hapura dhe të mbyllura, shprehjetë e vëzhgimit të klientit, inkurajimi, parafrazimi, përmbledhja **janë disa shprehi të tjera bazë që përdoren gjatë intervistës motivacionale**. Gjatë kësaj interviste përdoren dhe shprehi të tjera të avancuara si shprehjetë e reflektimit të kuptimit, fokusimi, konfrontimi, reflektimi i ndjenjave, shprehjetë ndikuese dhe strategjitë, shprehjetë zhvilluese – direktivat, pasojat logjike, interpretimet, hapja, këshilla / informacion / shpjegim / udhëzim, feedback, përmbledhje ndikuese, etj.

Ndjekja e sjelljes. Shprehia bazë e **ndjekjes së sjelljes**, konsiston në 4 dimensione. Në mënyrë që të komunikoni se me të vërtetë jeni duke dëgjuar ose ndjekur dikë tjetër, ju nevojitet:

1. *Kontakti me sy.* Në qoftë se do të shkoni t'i flisni dikujt, shikojeni në sy.
2. *Gjuha trupore e vëmendshme.* Klienti do të kuptojë nëse ju jeni i interesuar, në qoftë se ju i drejtoheni në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht përpara, keni një fytyrë ekspresive, dhe përdorni xheste lehtësuese dhe inkurajuese.

3. *Cilësitë vokale.* Toni juaj vokal dhe shpejtësia e të folurit tregojnë qartë se si ju ndiheni për një person tjetër. Mendoni se në sa mënyra ju mund të thoni “Unë jam vërtet e interesuar në çfarë ju do të thoni” vetëm duke ndryshuar tonin vokal dhe shpejtësinë e të folurit.
4. *Gjurmimi verbal.* Klienti ka ardhur tek ju me një interes të caktuar, mos ndryshoni subjektin. Qëndroni në problemin e treguar nga klienti.

Të katër dimensionet e ndjekjes kanë një qëllim të përbashkët: të reduktojnë kohën e të folurit të intervistuesit dhe ti sigurojë klientit mundësinë për të folur dhe të analizojë problemet konkretisht dhe më në detaje. Ju nuk mund të mësoni për klientin në qoftë se jeni ju që flisni! Megjithatë mënyrat e shprehjes se ndjekjes se sjelljes mund të ndryshojnë gjerësisht nga grupi në grup dhe nga individ në individ. Kjo do të thotë, që këto shprehje duhen përdorur, por dhe modifikuar kur nevojitet me secilin klient.

SHPREHITË E VËZHGIMIT

Tre janë parimet për të kuptuar sjelljen e klientit, sjellja joverbale, sjellja verbale, dhe papajtueshmëritë ose mospërputhjet. Me kalimin e kohës, ju do të fitoni shprehje të konsiderueshme në nxjerrjen dhe punën me këndvështrimin e klientit për botën.

Sjellja joverbale. Modelet e ndjekjes së sjelljes janë të rëndësishme për tu vëzhguar tek klienti. Klientët mund të shkëpusin kontaktin e syve, të shfaqin lëvizje të trupit, të ndryshojnë cilësinë e zërit kur ata janë duke folur rreth çështjeve të niveleve të ndryshme të konfortit (rehatisë) për ta. Ju mund të vëzhgoni klientët që të kryqëzojnë duart ose këmbët kur duam të mbylлим një çështje, alternim të shpejtë të syve gjatë periudhave të konfuzionit, ose shtim të belbëzimeve, apo hezitim në të folur kur flasin për çështje të vështira. Ketu përfshihen forma të vëzhgimit të sjelljeve joverbale të cilat ju mund ti përdorni për të rritur vetëdijen tuaj për to dhe sjellje të tjera.

Shprehjet e fytyrës janë veçanërisht të rëndësishme për të vëzhguar. Rrudhja e vetullave, mbledhja e buzëve, skuqja e fytyrës, buzëqeshja në një moment të papërshtatshëm mund të jenë disa ndryshime të fytyrës për t'u vëzhguar. Akoma më të kujdesshëm duhet të tregoheni në vëzhgimin e ndryshimeve të ngjyrës së fytyrës, sidomos kur ato lidhen me ndryshimet e presionit të gjakut sipas reagimeve emocionale. Edhe frymëmarrja mund të ndryshojë ose të ndërpritet përkohësisht. Këto përgjigje të vogla janë çelësa të rëndësishëm rreth eksperiencave që klienti po kalon; për t'i dalluar ato, nevojitet kohë dhe praktikë.

Të rëndësishme janë mospërputhjet në sjelljen joverbale. Kur një klient po flet rastësisht për një shok, psh. një dorë e mbledhur fort grusht, ndërsa tjetra e relaksuar dhe e hapur, duke treguar ndoshta ndjenja mikse, të përziera për shokun, ose diçka lidhur me të.

Midis njerëzve ekzistojnë modele dramatike dhe interesante të lëvizjeve. Është e dobishme të vëzhgohet shkalla e harmonisë së lëvizjeve me të tjerët. Shpesh njerëzit që janë duke komunikuar mirë do të “pasqyrojnë” gjuhën trupore me njëri tjetrin. Ata mund të ulen në pozicione identike në mënyrë të pandërgjegjshme dhe të bëjnë lëvizje komplekse të duarve sëbashku si në një balet. Kjo quhet *sinkronizim i lëvizjeve*. Lëvizje të tjera të çiftëzuara mund të mos jenë identike, por megjithatë harmonike si në lëvizjet *plotësuese*. Psh. një person flet dhe tjetri aprovon me kokë. Ju mund të vëzhgoni një lëvizje dore, në fund të qëndrimit të një personi që është përgjigjur me një lëvizje dore të lidhur, ndërkohë që tjetri merr rradhën e bashkëbisedimit dhe fillon të flasë.

Nuk është nevoja të themi, se mund të vëzhgohen dhe modele të lëvizjeve jo të sinkronizuara. Mungesa e harmonisë në lëvizje është e zakonshme midis njerëzve, të cilët nuk janë dakort me njëri tjetrin ose midis atyre të cilët kanë një konflikt për të cilin mund të mos jenë të vetëdijshëm.

Ju si intervistues do të doni të vëzhgoni shkallën tuaj të harmonisë trupore me klientin. Si lidhen lëvizjet tuaja me ato të tyre. Marrja e pozicionit dhe disa lëvizjeve në mënyrë diskrete dhe të lirshme mund t’iu ndihmojnë të jeni në kontakt më afër me eksperiencat e tyre. Shumë ekspertë dhe këshillues praktikojnë “pasqyrimin” e klientëve të tyre. Eksperienca u ka treguar atyre që përzjerja e gjuhës trupore, shkallës së frymëmarrjes, dhe fjalë çelës të klientit mund të ngrenë të kuptuarit e tyre në mënyrën se si tjetri percepton dhe përjeton botën.

Sjellja verbale. Shumë klientë mund të shfaqin probleme të gjurmimit verbal dhe vëmendjes përzgjedhëse. Ata mund të qëndrojnë edhe vetëm në një problem të vetëm dhe të përjashtojnë problemet e tjera të rëndësishme ose të ndërrojnë temë, kur ata duan të shmangin bisedën për ndonjë problem të vështirë. Ndoshta detyra më e vështirë e një intervistuesi të ri është të ndihmojë klientin të qëndrojë në temë pa mbikontrolluar. Vëzhgimi i ndryshimeve të temave të klientit është veçanërisht i rëndësishëm. Nganjëherë mund të jetë ndihmues komenti: psh. “Pak minuta më parë ne po flisnim për X”. Një tjetër mundësi është të ndjekim atë vëzhgim duke pyetur si klienti mund të shpjegojë daljen, shmangien nga tema.

Qëndrimet “unë”. Klientët shpesh ju japin gjurmë duke përsëritur qëndrime që janë të rëndësishme për ta. Këto fjali mund të vendosen qartë dhe marrin formën e qëndrimeve “Unë” (p.sh. “Unë jam i depresuar” ose “Unë po mendoj të bëj një abort”, ose “Unë nuk mund të vazhdoj kështu me Benin”). Qëndrimet “Unë” mund të jenë të nënkuptuara implicite ose dhe konfuze (“Nuk e di çfarë nuk shkon tek unë” ose “Unë ndihem i humbur; nuk e di çfarë të them”). Detyra e intervistuesit në të dy rastet është të dallojë këto fjali çelës dhe të ndihmojnë klientët të eksplorojnë faktet dhe veçoritë konkrete të situatës, mënyra se si ndihen për ta, dhe çfarë do të thotë për ta. Për shembull:

Klienti: Jam duke kaluar kohë të tmerrshme në linjën e prodhimit. Nuk mund ta realizoj normën, dhe supervizori im po më shtyn. Kam frikë se do më pushojnë.

Këshilluesi: (duke kërkuar më tepër fakte dhe duke nënvizuar fjali çelës). A mund të më tregoni më në veçanti çfarë iu tha mbikqyrësi juaj?

Këshilluesi: (duke dëgjuar për ndjenjat rreth situatës) Si ndihesh në lidhje me supervizorin?

Këshilluesi: (duke përcaktuar kuptim tek klienti) Çfarë do të thotë gjithë kjo për ty personalisht?

Fjalë çelës. Nëqoftëse do dëgjoni me kujdes klientët, do të gjeni që disa fjalë shfaqen përsëri në përshkrimin e situatës. Duke dalluar fjalët e tyre çelës dhe duke ndihmuar ata të eksplorojnë faktet, ndjenjat dhe kuptimet, si dhe nënvizimi i atyre fjalëve mund të jetë i dobishëm. Fjalët përshkruese çelës janë shpesh struktura nga e cila një klient organizon botën; Këto fjalë mund të sjellin kuptime nënvizuese. *Nënvizimi verbal* nëpërmjet theksimeve vokale është një tjetër gjurmë ndihmuese në përcaktimin se çfarë është më e rëndësishme për një klient. Nëpërmjet intonacionit të zërit dhe volumit, klienti tenton të theksojë fjalë apo fraza të veçanta që janë më të rëndësishme për ta.

Ju do të gjeni që duke iu bashkuar klientit në përdorimin e fjalëve çelës lehtësohet kuptueshmëria juaj dhe komunikimi me ta. Nëse fjalët e tyre janë negative dhe vetë-poshtëruese, reflektoni ato perceptime herët në intervistë, por më vonë ndihmohini ato të përdorin më tepër përshkrime pozitive për të njëjtat situata ose ngjarje. Shpesh ju do të synoni të ndihmoni klientin të ndryshojë nga “Unë nuk mundem” në “Unë mundem”.

Mënyra verbale individuale e perceptimit të botës. Klientët kanë mënyra individuale të marrjes së informacionit nga bota, e cila reflektohet

në zgjedhjen e tyre të gjuhës. Disa nga ne marrin të dhënat tona fillimisht nëpërmjet mjeteve vizuale: ne kemi nevojë të “shikojmë situatën”. Të tjerë mund të jenë të orientuar nga ana auditive “dëgjo se çfarë po ndodh”. Të tjerë akoma janë “kinestetikisht” të prirur dhe kanë nevojë për përfaqësime fizike para se të fitohet kuptimi i plotë: ata mund të kenë nevojë “të ndjejnë situatën”. Ju do ta shihni të dobishme të dalloni fjalët e përdorura nga klientët tuaj dhe të bashkoni, përzieni gjuhën tuaj për të lehtësuar shprehjen e tyre.

Koncepti i stilit verbal individual i ka rrënjët në një teori të edukimit që ngre idenë se fëmijët kanë stile të ndryshme të mësuarit. Disa mësojnë më mirë duke i parë fjalët, disa duke i thënë dhe disa të tjerë duke prekur gërmat apo fjalët (mjete mësimore). Mesa duket këto stile të të mësuarit vazhdojnë edhe në moshën e rritur dhe janë ilustruar nga përdorimi i gjuhës individuale. Disa individë përdorin stile mikse, megjithatë, dhe koncepte të tilla nuk mund të mbështeten plotësisht. Nëpërmjet eksperimentimeve, provave do të gjeni se ndërthurja, përziera e sistemeve gjuhësore me klientin ndikon në zhvillimin e një raporti apo në mirëkuptim.

Mbivendosja (Lankton, 1980) është një term që thekson dobinë e sistemeve perceptuese të shumëfishta në ndihmën që i japim klientit të përshkruajë një ngjarje. Mund të takoni një klient që flet për një problem me bashkëshortin, psh. me terma abstrakte. Pyetni klientin për një shembull konkret të problemit; më pas vazhdoni me pyetje se si bashkëshorti dhe situata përshkruhen nga ana vizuale, çfarë tingujsh ka dëgjuar dhe më në fund çfarë ndjenjash janë gjeneruar tek klientja. Nëqoftëse ju jeni empatik dhe përdorni konceptin e mbivendosjes në mënyrë të ndjeshme, ju mund të siguronit një kuptim shumë më të thellë të asaj çfarë po thotë klienti. Do të shikoni se keni rikrijuar shumë nga problemi, dhe keni nxitur reaksionin e klientit për problemin, nëpërmjet asaj që në intervistim dhe këshillim quhet ndryshe “tani dhe këtu”.

Kështu, nëpërmjet vëzhgimit efektiv dhe shprehive të dëgjimit, ju mund të ndihmoni klientin të rikrijojë probleme apo situata që ata kanë provuar. Disa, ndoshta shumica, e klientëve do të flasin më tepër rreth problemeve të tyre sesa të ribëjnë eksperiencat direkte. Përdorimi i këtyre teknikave mund të ndihmojë klientë të tillë që të sjellin problemin të gjallë. Së pari, iu kërkohet atyre të relaksohen, ndoshta duke mbyllur sytë. Më pas iu kërkohet të shohin problemin, ta përfytyrojnë me mendje. Pas kësaj iu kërkohet të dëgjojnë personin duke iu folur atyre dhe të kujtojnë çfarë ju kanë thënë. Vëzhgimi juaj ju tregon se kur klienti është “brenda” në eksperiencë. Më në fund, pyetini çfarë ndjejnë ata. Nëpërmjet këtij përdorimi të mbivendosjes, ju do ti rikrijoni pamjet, tingujt dhe ndjenjat e situatave të kaluara. Kjo mund të përdoret për një kuptueshmëri më të thellë nga ana juaj dhe nga ana klientit po ashtu.

MOSPËRPUTHJET

Llojshmëria e mospërputhjeve bën që klienti mund të ilustruhet më mirë në pohimet e mëposhtme:

“Djali im është perfekt, por vetëm se nuk më respekton”.

“Unë vërtet e dua vëllain tim (thënë me një ton të qetë duke shmangur vështrimin)

“Unë e meritoja të kaloja klasën” (një student i cili nuk kish bërë detyrën e kursit dhe mbeti në provimin final)

“Ajo pyetje nuk më shqetëson.” (e thënë me fytyrë të skuqur dhe grushte të mbledhura)

Në momentin që klienti fillon të ndihet relativisht rehat dhe janë bërë disa hapa fillestare drejt raportimit dhe kuptimit të drejtë, detyra kryesore e këshillimit është të identifikojë mospërputhjet bazë, mesazhet mikse, konfliktet ose papajtueshmëritë në sjelljen dhe jetën e klientit.

Mospërputhjet mund të jenë të llojeve të ndryshme:

- *Mospërputhjet midis sjelljeve joverbale.* Një klient mund të flasë butë, qetësisht për një çështje, por vëzhgimet e kujdesshme mund të nxjerrin që buzëqeshja e tij/saj shoqërohet me grushte të mbledhura fort. Kur pjesë të trupit nuk janë të koordinuara shpesh nënkuptohen mesazhe mikse.
- *Mospërputhje midis dy pohimeve.* Në një fjali të vetme një klient mund të shprehë ide plotësisht kontradiktore (“Djali im është perfekt vetëm se ai nuk më respekton”) ose “Kjo është një zyrë mjaft e lezetshme; por shumë keq që ndodhet në një zonë kaq të keqe”). Shumë prej nesh kanë ndjenja mikse kundrejt njerëzve tanë të afërt, punës tonë, problemeve tona, situatave. Të ndihmosh të tjerët të kuptosh dyshimet dhe dilemat e tyre është mjaft e dobishme.
- *Mospërputhjet midis atyre çka thuhet dhe atyre çka bëhen.* Një prind mund të flasë për dashuri për fëmijën e tij, por të jetë fajtor njëkohësisht për abuzim ndaj fëmijës. Një student mund të pretendojë një notë më të lartë, pavarësisht se koha që ai ka shpenzuar për të studiuar ka qënë e pakët.
- *Mospërputhjet midis pohimeve dhe sjelljes joverbale.* “Ajo pyetje nuk më shqetëson” (thënë me fytyrë të skuqur).
- *Mospërputhjet midis njerëzve.* Konflikti mund të përshkruhet si mospërputhje midis njerëzve. Dallimi i konfliktit ndërpersonal është një nga detyrat kryesore të këshilluesit.

- *Mospërputhjet midis klientit dhe një situatë.* “Unë dua të pranojmë në fakultetin e mjekësisë, por nuk ia dola”. Në situatë të tilla bota ideale e klientit shpesh nuk përputhet me atë që është realisht. Detyra e këshilluesit është të punojë midis këtyre çështjeve në termat e sjelljeve ose qëndrimeve.

Shumica e klientëve janë të ndërgjegjshëm, në njëfarë mase, lidhur me konfliktet dhe mospërputhjet në jetën e tyre; megjithatë ata nuk janë plotësisht të pajtuar në të gjithë dimensionet e këtyre mospërputhjeve. Kur jemi duke vëzhguar konfliktet e sapo cituara, është e rëndësishme të dallojmë ndjenjat dhe emocionet mikse dhe ambivalente. Një këshillues i sprovuar nuk sulmon domosdoshmërisht dhe menjëherë mospërputhjet emocionale ose konjitive të klientit, por mund ta shtyjë për më vonë dhe vëzhgon me kujdes sjelljen verbale dhe joverbale, në mënyrë që të mund të dallojë mospërputhje të tjera akoma më të rëndësishme.

Megjithatë, në disa intervistime me kohë të kufizuar dhe në disa teori këshillimi (siç është Gestalt), konfrontimi i menjëhershëm, direkt i mospërputhjeve të tilla mund të jetë i rëndësishëm.

Megjithëse ndjekja përbën themelet e hierarkisë së mikrosprehive, janë shprehite e pyetjeve që sigurojnë një konstrukt sistematik për drejtimin e intervistës. Pyetjet ndihmojnë një intervistim të fillojë dhe zhvendoset natyrshëm. Ato hapin hapësira të reja për diskutim, ndihmojnë në fokusimin dhe qartësimin e problemeve, dhe ndihmojnë në vetë-eksplorimin e klientit. Megjithatë, disa teoricienë nuk i pëlqejnë pyetjet dhe sugjerojnë që intervistuesi të mos pyes kurrë. Detyra juaj kryesore në këtë kapitull është të hetoni këtë shprehje dhe të vendosni ku të qëndroni mbi çështjen e përdorimit të pyetjeve në një intervistë.

PYETJET

Pyetjet mbeten një fakt i jetës në kulturën tonë. Ne i përdorim ato gjithkund. Mjeku dhe infermjerja, nëpunësi shtetëror, shitësi, etj., i konsiderojnë të pyeturit e klientit si pjesë të themelore të profesionit të tyre. Shumë teori këshillimi përkrahin idenë e përdorimit të pyetjeve gjerësisht. Çështja më tej është si të pyesim në mënyrë të zgjuar dhe të qëllimshme.

Qëllimi i kësaj teme është të eksplorojmë disa aspekte të të pyeturit, dhe, eventualisht, të përcaktojmë vendin e tyre në repertorin e shprehive

tuaja të komunikimit. Fokusi i këtij diskutimi është përqëndruar më tepër tek pyetjet e hapura dhe të mbyllura.

Pyetjet e hapura janë ato të cilave nuk mund ti përgjigjesh me pak fjalë. Ato i inkurajojnë të tjerët të flasin dhe ju sigurojnë maksimumin e informacionit. Pyetjet e hapura fillojnë me *çfarë, si, pse, ose mund*, psh. “Mund të më tregoni se çfarë ju solli sot këtu?”

Pyetjet e mbyllura mund të marrin përgjigje me pak fjalë ose fjali. Ato kanë një avantazh që fokusojnë intervistimin dhe sigurojnë informacion, por përgjegjësia e udhëheqjes i mbetet intervistuesit. Pyetjet e mbyllura fillojnë zakonisht me *A jeni?, A është?, ose A bëni?*. Psh. “A po jetoni me familjen tuaj?”

Nganjëherë pyetjet janë esenciale. Klientët jo gjithmonë ju sigurojnë informacion të rëndësishëm në mënyrë të mjaftueshme dhe nganjëherë e vetmja mënyrë për të marrë të dhënat e duhura është të bërit e pyetjeve. Psh. një klient mund t’iu tregojë se është i depresuar dhe i paaftë të veprojë. Si një ndihmues, ju mund të dëgjoni historinë dhe t’iu humbasin probleme të rëndësishme të lidhura me depresionin. Pyetja e hapur “Çfarë gjëra të rëndësishme po ndodhin tani në jetën ose familjen tënde?” mund të sjellë në pah faktin se një ndarje apo divorc është duke ndodhur, që një punë është duke humbur, ose që ekziston një tjetër dimension i rëndësishëm që po shkakton shqetësime. Çfarë ju në fillim interpretuat si depresion klinik klasik fillon modifikohet nga konsiderime realiste, dhe trajtimi merr një drejtim të ri.

Një incident i ngjashëm më poshtë ilustron rëndësinë e pyetjeve. “Babai im u verbua pas një operacioni në zemër. A ishte një rezultat i operacionit? Jo, në fakt ishte sepse mjekët harruan të bënin pyetjet e hapura shumë të rëndësishme, “A po ndodh ndonjë gjë tjetër me karakter fizik apo emocional në jetën tuaj kohët e fundit?” Nëse ajo pyetje do të ish bërë, mjekët do të kishin zbuluar që babai im kishte pasur dhimbje koke të pazakonta një javë para se operacioni të planifikohej, dhe mund të kishin diagnostikuar një infeksion të syve, i cili mund të ishte trajtuar lehtësisht me mjekime.

Pyetje të tjera të dobishme që sigurojnë të dhëna më të plota mund të jenë:

- Duke pasur parasysh se çfarë kemi folur deri tani, çfarë tjetër mund të shtohet?
- Duke pasur parasysh këtë sesion, imagjinoni diçka që ka ndodhur, që ju duket veçanërisht e palidhur ose e parëndësishme lidhur me këtë problem. Ju edhe mund ta keni menduar dhe të mos e keni thënë. Mund të më tregoni se çfarë ju vjen ndër mend? (Kjo pyetje shpesh na siguron çuditërisht informacion të ri dhe të dobishëm).
- Çfarë do ti shtonte një shok ose një familjar asaj çfarë ju treguat? Nga

një këndvështrim _____ (fut etninë, racën, preferencën seksuale, besimin fetar, ose dimensione të tjera), si mund të shihet situata juaj? (Kjo pyetje ndryshon fokusin dhe ndihmon klientin të shohë problemet e tij më gjerë, në një kontekst bazuar në rrjetin e miqve, familjes, kulturës).

- Mos kemi humbur ndonjë gjë?

Klientët vijnë në intervistim duke kërkuar që të thonë diçka rreth interesave dhe shqetësimeve të tyre. Nëqoftëse është një intervistë punësimi, ata duan të flasin për anët e tyre pozitive dhe të bëjnë përshtypje të mirë. Në rastet e menaxhimit ose situata mjeksore, klientët të ndryshëm duan të shprehin qartë idetë dhe në mënyrë konçize, në mënyrë që të marrin ndihmën e duhur për nevojat ose problemet e tyre. Klientët në këshillim dhe terapi duan të shprehin veten gjithashtu, por nganjëhere e gjejnë të vështirë.

Në të gjitha këto situata të ndryshme shprehia e pyetjeve të hapura ose të mbyllura mund të lehtësojë hapjen e klientit dhe i bën të mundur intervistës të arrijë objektivat në mënyrë të kompletuar. Në të njëjtën kohë pyetje ndaluese apo josensitive mund të vendosin klientin në vështirësi dhe të pengojnë komunikimin e hapur.

Pyetjet ndihmojnë të fillojë intervista. Me klientin që flasin, pyetjet e hapura lehtësojnë diskutimin e lirë dhe japin hapësirë të bollshme për të biseduar. Ja disa shembuj:

“Çfarë do t’iu pëlqente të flasin sot?”

- “Mund të më tregoni për çfarë keni ardhur të më takoni?”
- “Si kanë shkuar punët që herën e fundit që jemi takuar?”
- “Herën e fundit që u takuam ne folëm për tensionin që ndjen kur shikon ndeshje futbolli. Po kësaj jave si shkoi?”

Tre pyetjet e para të hapura sigurojnë hapësirë të konsiderueshme, në të cilin klienti mund të flasë për çdo gjë. Pyetja e fundit është e hapur por siguron një farë fokusimi për tensionin, e ndërtuar në materialin e marrë gjatë javës së shkuar.

Pyetje të tilla të hapura mund të mos jenë shumë të suksesshme me një klient që nuk flet shumë. Në raste të tilla, një sasi pyetjesh të mbyllura si “A shkuat në ndeshje javën e fundit?” ose “Kush fitoi?”, “Ku u tensionove përsëri?” mund të sigurojnë strukturën e intervistimit. Këto mund të ndiqen nga pyetje të tjera të hapura kur klienti fillon të hapet dhe të flasë më lirisht.

Pyetjet e hapura ndihmojnë përpunimin dhe pasurimin e intervistës. Një intervistues i ri shpesh bën një ose dy pyetje, dhe më pas mendon se çfarë do të bëjë. Edhe ata më me eksperiencë nganjëherë ndjejnë një lloj presioni, vështirësie për të ditur se ç'do të thonë më pas. Një pyetje e hapur mbi disa çështje që klienti prezantoi më parë ndihmojnë rifillimin e sesionit dhe vazhdimin:

- “Mund të më tregoni më tepër për atë...?”
- “Si e ndjetë kur ndodhi?”
- “Nisur nga çfarë thatë, cila do të ishte për ju zgjidhja ideale e problemit?”

Pyetjet ndihmojnë për të nxjerrë specifika konkrete për botën e klientit. Nëse ka një pyetje të hapur që duket më e dobishme në mjaft situata praktike, është ajo që synon gjërat specifike dhe konkrete të situatës së klientit. Përsëri, pyetja model “A mund të më jepni ndonjë shembull specifik?” është më e vlefshme për çdo intervistues. Shumë klientë tentojnë të flasin në përgjithësi, prandaj shembuj konkretë dhe specifikë e pasurojnë intervistimin, dhe sigurojnë të dhëna për veprimet. Ja disa shembuj të pyetjeve konkrete dhe specifike:

Klienti: *Andi më çmend!*

Këshilluesi: *Mund të më jepni disa shembuj se çfarë bën Andi? ose
Çfarë bën Andi konkretisht që ju bën të zemëroheni? ose
Çfarë do të thoni me “më bën të çmendem” ose
Mund të më tregoni në mënyrë më specifike se çfarë bëni para dhe
pasi Andi ju bën të çmendeni?*

Pyetjet e mbyllura, sigurisht, mund të sjellin veçori, por ato i japin intervistuesit më tepër përgjegjësi. Megjithatë, nëqoftëse intervistuesi e di në mënyrë specifike drejtimin e dëshiruar të intervistimit, pyetjet e mbyllura si “A e shpreh Andi zemërimin e tij duke ju qëlluar? ose “A ju tall shpesh Andi?” dhe “A mos drogohet Andi? mund të jenë të vlefshme. Por edhe kur pyetjet e mbyllura mund të jenë të drejtuara mjaft mire, mund të rrezikojnë ti presin iniciativën klientit.

Pyetjet janë kritike në diagnostikimin dhe vlerësimin e problemit. Mjekët duhet të diagnostikojnë simptomat fizike të klientëve të tyre. Menaxherët mund të kenë për të diagnostikuar një problem në linjën e prodhimit. Këshilluesve të karrierës profesionale u nevojitet të diagnostikojnë

histori profesionale të klientëve. Pyetjet janë të domosdoshme për të realizuar një diagnostikim efektiv.

George Kelly, teoricien i personalitetit, ka sugjeruar pyetjet e mëposhtme për diagnostikimin e problemeve të përgjithshme, të cilat ndjekin *kush, çfarë, kur, ku, si, pse* të reporterëve të gazetave:

- *Kush* është klienti? Cila është prejardhja personale e klientit? Kush tjetër mund të jetë i përfshirë?
- *Çfarë* është problemi i klientit? Çfarë po ndodh? Cilat janë detajet specifike të situatës?
- *Kur* ka ndodhur problemi? Kur filloi? Çfarë i paraprin ndodhjes së problemit?
- *Ku* ndodhi problemi? Në çfarë ambjentesh dhe situatash?
- *Si* reagon klienti ndaj problemit? Si ndihet klienti për këtë?
- *Pse* ndodhi problemi?

Është e nevojshme të themi se, seria e këtyre pyetjeve gjithashtu e siguron intervistuesin me një sistem të gatshëm për të ndihmuar klientin që të përpunojë ose të jetë më specifik rreth një çështje në çdo kohë gjatë një sesiioni.

Fjala e parë e pyetjeve të hapura përcakton pjesërisht verbalizimin e klientit. Shpesh, por jo gjithnjë, përdorimi i fjalëve çelës jep rezultate të parashikueshme.

- Pyetjet me “*çfarë*” udhëhiqen në faktet “Çfarë ndodhi?” “Çfarë do të bëni?”
- Pyetjet “*Si*” udhëheqin në diskutim për procesin ose sekuenca të tij, ose në ndjenjat. Psh. “Si mund të shpjegohet?”, “Si ndjeheni për atë?”
- Pyetjet “*Pse*” shpesh udhëheqin në një diskutim mbi arsyet. “Pse e lejuat të ndodhte?”, “Pse mendoni që është kështu?”
- Pyetjet “*Mund*” konsiderohen si maksimalisht të hapura dhe përmbajnë disa nga avantazhet e pyetjeve të mbyllura në të cilat klienti është i lirë të thotë: “Jo, nuk dua të flas për këtë”. Pyetjet me “*a mund*” reflektojnë më pak kontroll dhe komandim se të tjerat. “*A mund të më tregoni më tepër për situatën tuaj?*” “*A mund të më jepni ndonjë shembull specifik?*”, “*A mund të më thuash çfarë do të doje të flisnim sot?*”

Pyetjet kanë probleme të caktuara potenciale. Ndërsa pyetjet kanë vlerë të madhe, nuk duhet të harrojmë problemet e tyre potenciale. Midis tyre përmendim:

Bombardimi/mbytja me pyetje. Shumë pyetje mund të tentojnë të vendosin shumë klientë në pozicion mbrojtje. Ato gjithashtu mund t'i japin intervistuesit shumë kontroll.

Pyetjet shumëfishe. Intervistuesi mund ta bëjë klientin konfuz duke bërë shumë pyetje në të njëjtën kohë. Kjo është një tjetër formë e bombardimit, megjithatë nganjëherë mund të jetë ndihmëse për disa klientë.

Pyetje si pohime. Disa intervistues mund të përdorin pyetjet si një mënyrë për të “shitur” këndvështrimet e tyre. “A nuk mendon se do të ishte e dobishme nëqoftëse do të mësoje më shumë?” “Si mendon sikur të përpiqeni të bëni ushtrime relaksuese në vend të kësaj që po bëni tani?” Kjo formë pyetje, ashtu si pyetjet shumëfishe, mund të jetë e dobishme nganjëherë. Vetëdija mbi një pyetje të kësaj natyre, megjithatë, mund t’iu lejojë të merrni parasysh rrugë alternative dhe më direkte për të arritur klientin. Një rregull i dobishëm është që nëse ju jeni duke bërë një pohim, është mirë të mos e drejtoni si një pyetje.

Pyetjet dhe ndryshimet kulturore. Stili i pyetjeve të rrufeshme në disa kultura mund të jetë i pafavorshëm. Nëse jeni duke punuar me një grup kulturor të ndryshëm nga i juaji, kini kujdes që përdorimi i madh i pyetjeve nganjëherë mund të rezultojë si mosbesim nga këshilluesi. Studimet tregojnë që burrat tentojnë të pyesin më shumë se gratë. Disa e interpretojnë këtë fakt si tregues që burrat i përdorin pyetjet për të kontrolluar bashkëbisedimin.

Pyetjet “Pse”. Shumë prej nesh kanë provuar në fëmijëri pyetjen: “Pse e bëre këtë?” Shpesh pyetjet “Pse” e vendosin të intervistuarin në pozicion mbrojtës dhe të paretatshëm. Kjo lloj paretatie mund të prodhohet nga çdo pyetje që evokon sensin e të qenit i sulmuar.

Pyetjet dhe kontrolli. Personi që pyet zakonisht është në kontroll të intervistës. Ai ose ajo po përcakton kush flet për çfarë, kur do të ndodhë biseda, dhe në çfarë kushtesh do të ndodhë. Nganjëherë, pyetjet mund të ndihmojnë në nxjerrjen nga kontrolli i intervistave të vëna nën kontroll dhe drejtim. Nganjëherë, pyetjet mund të bëhen në mënyrë të pasjellshme dhe brutale, për të fituar pikë intervistuesi dhe jo në përfitim të klientit.

Pyetjet mund të përdoren për të monitoruar qetësinë dhe vazhdimin e intervistës. Pyetjet, të përdorura efektivisht, mund të ndihmojnë këshilluesin dhe intervistuesin të vazhdojë sesionin. Nëqoftëse klienti e gjen veten duke u hapur shumë, dhe këshilluesi ndjen këtë lloj diskonforti, një seri pyetjesh të mbyllura mund të ndihmojnë klientin të ngadalësohet dhe të fitojë

përsëri qetësinë. Në mënyrë të ngjashme, pyetjet e hapura mund të sigurojnë hapësirë për klientin në mënyrë që ti shohë gjërat më në thellësi. Përdorimi i qëllimshëm dhe i sprovuar i pyetjeve mund të prodhojë një intervistim që afrohet me nevojat dhe dëshirat e klientit.

Përdorimi i pyetjeve të hapura dhe të mbyllura me klientë që flasin pa. Zakonisht, pyetjet e hapura janë më të preferuara se ato të mbyllura në një intervistim. Megjithatë, duhet të njohim faktin që pyetjet e hapura kërkojnë një klient verbal, dikë që ka ndërmend të ndajë informacion, mendime dhe ndjenjat me ju. Disa sugjerime mund të lehtësojnë klientin të flasë më lirisht me ju:

Ndërto besim në hapësirën e klientit. Me një klient hezitues një çështje qendrore është besimi. Nëqoftëse klientit i është kërkuar të takohet me ju ose është i ndryshëm nga ana kulturore, ai ose ajo do të ketë më pak dëshirë, predispozicion për të folur. Në këtë moment, shprehite tuaja të hapjes natyrale dhe ato sociale janë veçanërisht të rëndësishme. Ndërtimi i besimit dhe raportimi i nevojave duhet të vijnë të parat. Me disa klientë, ndërtimi i besimit mund të marrë një sesion të plotë ose më tepër. Gjithashtu, pyetje të zgjeruara të bëra shumë shpejt, mund të ngadalësojnë procesin e ndërtimit të besimit me disa klientë.

Prano disa rastësi. Klientët që flasin pak nuk japin një histori të qartë dhe të lidhur. Nëqoftëse ai ose ajo nuk ka shumë besim ose është shumë i përfshirë emocionalisht në ngjarje apo shqetësim, mund të kërkojë pak kohë për ju, që të kuptoni mirë. Mund t'iu duhet të përdorni një balancë të kujdesshme midis pyetjeve të hapura dhe të mbyllura për të ndërtuar historinë, dhe “pjese dhe copa” para se të vendoset (përmbledhet) bashkë historia konkrete. Pavarësisht çfarë bëni, ruani një gjuhë sa më të thjeshtë, dhe konkrete që të jetë e mundur.

Kërko specifika konkrete. Këshilluesit dhe terapistët flasin për *abstraksion*. Nëqoftëse ju ose klienti do të lëvizni shumë lart në abstraksion, gjërat nuk do të kenë sens për këdo. Kjo ndodh më tepër me klientë që flasin pak ose emocionalisht të ngarkuar. Kërkoni gjithmonë të gjeni shembuj konkretë dhe histori. Shmangni kërkimin e tabuve dhe modeleve të përgjithshme. Pyetjet e hapura “A mund të më jepni ndonjë shembull konkret, të veçantë?” janë çdo efektive në këto raste. Abstraksionet dhe modelet përsëritëse të sjelljes, duhet të presin derisa të zbulohen faktet kryesore ndjenjat dhe mendimet.

Kërko përgjigje të shkurtra dhe konkrete. Pasi të jetë vendosur besimi, ju duhet të vëzhgoni: “Mësuesja tha se ju dhe ajo keni pasur një zënkë” Më pas përpiku të bësh pyetje të hapur “Çfarë thotë mësuesja (ose bën)?”

Nëqoftëse fokusoheni në ngjarje konkrete, dhe shmangni vlerësimin apo opinionin në një mënyrë jogjyquese, shanset tuaja për të ndihmuar klientin të flasë do të zgjerohen. Ju do të doni të dini çfarë ka ndodhur çdo, çfarë tha dhe bëri secili person, dhe mundësisht dhe emocionet që i shoqërojnë ata. Pyetje konkrete të fokusuara specifikisht përfshijnë:

- *Çfarë ndodhi në fillim? Çfarë ndodhi më pas? Cili ishte rezultati?* (Kjo ju ndihmon ju të vizatoni një sekuencë lineare të historisë).
- *Çfarë tha personi tjetër? Çfarë bën ai? Çfarë thoni ju?* (Këto fokusojnë mbi veprime konkrete të vëzhguara).
- *Çfarë ndodhi më pas? Çfarë bëtë ju më pas? Çfarë bëri ai/ajo më pas?* (Nganjëhere klientët janë aq të përqëndruar në ngjarje, sa që nuk kuptojnë që ka mbaruar. Kjo i ndihmon ata të shohin rezultatet e ngjarjes).
- *Çfarë ndjenit/mendonit para se të ndodhte? Gjatë? Pas? Çfarë mendoni si ndjehet personi tjetër?* (Kjo ndihmon në fokusimin e emocioneve).
- Vini re që secila nga pyetjet e mësipërme kërkojnë përgjigje relativisht të shkurtra. Janë disa pyetje të hapura që janë më të fokusuara në orientim dhe mund të balancohen me disa pyetje të mbyllura. Mos prisni që klientët që flasin pak të japin përgjigje të plota për këto pyetje. Ju mund të keni nevojë të bëni pyetje të mbyllura për të marrë detaje dhe informacion specifik. (“A tha ai ndonjë gjë?”, “Ku ishte ajo?”, “A është familja jote e zemëruar?”, “A thonë ata po ose jo?”)

Një pyetje e mbyllur *udhëheqëse* është e rrezikshme. Në shembujt e mësipërm mund të shikoni se një seri e gjatë pyetjesh të mbyllura mund të zbulojnë historinë, por mund edhe të sigurojë vetëm përgjigje të kufizuara të pyetjeve tuaja, pavarësisht nga çfarë klienti në të vërtetë mendon ose ndjen.

Inkurajimi, perifraximi dhe përmbledhja komunikojnë tek klienti faktin që ata vërtetë janë dëgjuar. Në këto shprehje dëgjimi të kujdesshëm ju nuk duhet të ngatëroni idetë tuaja me çfarë klienti ju ka thënë. Ju mund të jepni feedback për idetë e klientit me fjalët tuaja, të cilët përmbledhin ndoshta shkurtime dhe sqarojnë çfarë klienti ka thënë. Megjithatë, është e përshtatshme të përdoren në këto raste fjalë çelës të klientit dhe ide për çështje veçanërisht delikate.

Inkurajuesit janë disa mjete verbale dhe joverbale që këshilluesi ose intervistuesi mund ti përdorë për të nxitur klientët të vazhdojnë të flasin. Ata përfshijnë lëvizjet e kokës, xhestet me duar të hapura, fraza si “Uh-huh,” dhe thjesht përsëritje të fjalëve çelës të klienti ka përdorur.

Perifraximet i jepen në përgjigje klientit lidhur me esencën e gjërave që ata sapo kanë thënë duke shkurtuar dhe qartësuar komentet e klientit.

Perifrazimi nuk është përsëritja fjalë për fjalë si papagall; është përdorimi i disa fjalëve tuaja plus fjalët më të rëndësishme të klientit.

Përmbledhjet janë të ngjashme me perifrazimet por mbulojnë një kohë më të gjatë dhe më tepër informacion. Përmbledhjet mund të përdoren për të filluar ose mbaruar një intervistë, si një tranzicion në një temë të re, ose për të qartësuar çështjet e gjata dhe komplekse të klientit. Më e rëndësishmja, përmbledhja ndihmon klientët të organizojnë të menduarit e tyre.

STRUKTURA E INTERVISTËS

Struktura e intervistës me 5 faza është e bazuar në një model i cili pasqyron një proces vendimmarrje ose zgjidhje problemi i cili fokusohet në përcaktimin e problemit, përcaktimin e qëllimeve dhe të kuptuarit e qartë se cili është problemi dhe qëllimet e vendosura për ta adresuar atë. Një pjesë e madhe e intervistimit, këshillimit, terapisë kanë në fokusin e tyre zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen. Teori alternative ofrojnë këndvështrime të ndryshme mbi marrjen e vendimeve. Kështu, modeli i prezantuar nuk është i vetmi përsa i përket strukturës së intervistës, por ofron një bazë të mjaftueshme e cila mundëson arritjen e rezultateve të pritshme. Intervista mund të realizohet në pesë faza kryesore. (Figura 1)

1. Vendosija e raportit dhe strukturimi	• "Përshëndetje _____" • Ndjekja me vëmendje e sjelljes, identifikimi i pikave të forta, strukturimi
2. Mbledhja e informacionit, përcaktimi i problemit dhe identifikimi i pikave të forta	• "Cili është shqetësimi juaj?" • Sekuenca e të dëgjuarit bazë, shprehitë ndikuese, identifikimi i pikave të forta.
3. Përcaktimi i rezultateve. Çfarë dëshiron klienti të arrijë	• "Çfarë dëshironi të ndodhë" • Ndjekja me vëmendje, sekuenca bazë të dëgjuarit
4. Eksplorimi i rezultateve. Çfarë dëshiron klienti të arrijë	• "Çfarë do të bëjmë rreth një çështjeje të tillë?" • "A do të ndërmarrësh një hap të tillë?"
5. Përgjithësimi dhe transferimi i të mësuarit	• Shprehitë ndikuese si dhënia e direktivave sugjerimeve, ofrimi i informacionit dhe shpjegimeve.

Faza 1: Vendosija e raportit dhe strukturimi

"Përshëndetje, _____." Rregulli i parë për vendosjen e raportit me klientin është përdorimi i emrit të klientit. Disa intervistues i kushtojnë vëmendje të veçantë fazës së vendosjes së raportit, ndërsa të tjerë e supozojmë si të mirëqenë një raport të tillë dhe fillojnë menjëherë intervistën. Prezantimi

i intervistës dhe vendosja e raportit janë veçanërisht të rëndësishme në intervistën e parë me një klient. Në disa raste, vendosja e raportit mund të jetë një proces i cili zgjat në kohë dhe mund të transformohet në një proces trajtimi; një shembull mund të jetë ai i terapisë ku fillohet të luhet ping-pong me një të mitur vagabond, në mënyrë që në fillim i mituri dhe profesionisti të njohin njëri-tjetrin. Megjithatë, në pjesën më të madhe të këshillimeve dhe intervistave, një fazë e tillë zgjat pak relativisht. Pas një përshëndetje të shkurtër, fillon diskutimi mbi çështje për të cilat klienti dëshiron të flasë.

Mikroshprehitë më të rëndësishme në vendosjen e raportit janë ndjekja me vëmendje e sjelljes së klientit dhe observimi i tij. Ndjekja me vëmendje përdoret për t'i dhënë të kuptuar klientit se ju e kuptoni atë dhe jeni i interesuar mbi atë që thuhet. Observimi i klientit është i rëndësishëm, në këtë fazë të intervistës. A ndjehet klienti komfort dhe i relaksuar? A është prezantimi i klientit më tepër i orientuar drejt aspektit vizual, auditiv apo dinamik? Të gjitha observimet janë të rëndësishme gjatë procesit të zhvillimit të raportit. Vetë-hapja nga ana juaj mund të jetë një shprehje tjetër e dobishme gjatë punës me disa klientë. Në sesionet e tjera në vazhdim, përmbledhja e sesioneve të mëparshme është e rëndësishme pasi siguron integrimin e pjesëve të veçanta me sesionin aktual dhe ndihmon në ruajtjen e raportit tashmë të vendosur.

Identifikimi i pikave të forta mund të jetë një moment i rëndësishëm në vendosjen e raportit. Me një klient nervoz apo të pasigurt, identifikimi i pikave të forta i ofron klientit një bazë e cila e ndihmon atë të konfrontojë problemet e ndryshme të vështira. Ajo që është më e rëndësishme për intervistuesin është që ky i fundit duhet të jetë i hapur, i vërtetë me klientin dhe të përpiqet të përmbushë nevojat e tij duke qëndruar fleksibël.

Megjithatë, duhet mbajtur parasysh fakti se disa intervista fillojnë me pyetje të tilla si “A mund të më thoni si mund t’ju ndihmoj?” Në disa intervista raporti mund të supozohet si i mirëqenë, por kur është i nevojshëm, ai mund të jetë elementi kryesor i një interviste. Përsëri, shprehitë vëzhguese ndihmojnë të kuptohet se kur është e nevojshme të kapërcehet kjo fazë dhe të kalohet në fazën 2. Një ndër mënyrat më të mira për të siguruar një fillim të mbarë është të fillohet atëherë kur klienti flet në mënyrë spontane mbi shqetësimet e tij dhe ju vëzhgoni se gjuha a tij trupore është e ngjashme me tuajën. Simetria e lëvizjes apo komplimentariteti i saj, janë mënyrat më të mira për të përcaktuar nivelin e empatisë që ekziston ndërmjet klientit dhe profesionistit.

Strukturimi është pjesa e dytë e fazës së parë. Zakonisht, konsiston në informimin e klientit mbi atë që pritet të arrihet në intervistë. Kur ju drejtoni

një intervistë duke përdorur vetëm shprehitë e ndjekjes me vëmendje dhe të dëgjuarit, do të ishte e rekomandueshme që klienti të informohej se ai do të dëgjohej me vëmendje nga ju. Në vijim, klientit mund t'i ofrohet më tepër informacion mbi qëllimet e intervistës, metodat e përgjithshme të përdorura dhe çështje të tjera në lidhje me strukturën të cilat janë të rëndësishme për marrëdhënien e krijuar. Disa klientë kanë nevojë për shpjegimin e intervistës. Kjo mund të jetë intervista e parë për ta dhe ata mund të mos jenë të qartë mbi mënyrën sesi duhet të sillen. Ofrimi i informacionit të nevojshëm është mjaft i rëndësishëm për këtë kategori klientësh. Në raste të tilla, intervistuesi shpjegon qëllimin e intervistës dhe gjërat që ai mund të realizojë si dhe të tjera që nuk mund t'i realizojë. Për shembull, intervistuesit të cilët punojnë në shërbimet e mirëqenies sociale, e kanë më të lehtë të ndihmojnë klientët të kuptojnë që në sesionin e parë se cilat janë kapacitetet e tyre. Nëse klienti ka një nevojë tjetër, referimi i menjëhershëm i këtij rasti është i mundur duke evituar kështu irritimin e mundshëm ndërmjet klientit dhe intervistuesit.

Faza 2: Mbledhja e informacionit, përcaktimi i problemit dhe identifikimi i pikave të forta

“Cili është shqetësimi juaj?” Detyra e parë e intervistuesit është të zbulojë përse klienti ka ardhur për të kërkuar ndihmë dhe cili është problemi që e shqetëson. Gjithashtu, intervistuesi duhet të mbledhë informacion mbi klientin dhe problemin. Klientët zakonisht i bëjnë konfuze intervistuesit duke i prezantuar atyre lista të gjata çështjesh dhe shqetësimesh. Një rregull i thjeshtë është ai sipas të cilit, çështja e fundit e prezantuar nga klienti në listën e gjatë të problemeve, është zakonisht shqetësimi kryesor; përpikuni ta zbuloni atë, por në të njëjtën kohë jini i përgatitur të ri-përkufizoni problemin, ndërsa vazhdoni të dëgjoni klientin më tej.

Gjithashtu, mos harroni se e tërë lista është mjaft e rëndësishme. Sekuenca e të dëgjuarit bazë është një shprehi e rëndësishme në përcaktimin e problemit dhe mbledhjen e informacionit. Pyetjet e hapura dhe të mbyllura ndihmojnë të kuptohet këndvështrimi i klientit mbi çështjen. Inkurajuesit dhe perifrazimet ofrojnë mundësinë për të qartësuar dhe kontrolluar nëse informacioni i dëgjuar është kuptuar drejt nga marrësi. Pranimi i ndjenjave nëpërmjet reflektimit ndaj ndjenjave ofron gjithashtu një mundësi të mirë për të kuptuar aspekte të ndryshme të emocioneve të klientit. Dhe së fundi, përmbledhja ofron një mënyrë të mirë për të renditur në një formë të qartë, ide dhe komente të ndryshme të ofruara nga klienti.

Elementi kryesor në këtë fazë është përcaktimi i problemit sipas emocioneve të përjetuara nga klienti. Një përcaktim i tillë mund të plotësohet

dhe nga mbledhja e informacionit dhe të dhënave mbi klientin dhe perceptimet e tij. Seritë e pyetjeve si kush, çfarë, kur, ku, dhe pse ofrojnë një bazë të konsiderueshme informacioni, i cili mundëson përcaktimin e problemit.

Gjatë përpjekjeve tuaja për të identifikuar shqetësimet kryesore të klientit, pyesni veten se cila është bota e brendshme e klientit? Cili është problemi që prezantohet për zgjidhje dhe mundësia për t'u aktualizuar? Pamundësia për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, rezulton në një intervistë të paplotë e cila nuk karakterizohet nga një sens i qartë drejtimi. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje e veçantë pikave të forta të klientit. Identifikimi i pikave të forta duhet të jetë pjesë e kësaj faze të intervistës dhe në të kundërt, duhet të realizohet në vijim të sesionit. Gjithmonë mbani mend një pohim të rëndësishëm: ***klientët rriten duke u mbështetur në pikat e tyre të forta.***

Faza 3: Përcaktimi i rezultateve

Faza e tretë fokusohet në qëllimet e klientit. Çfarë dëshiron të arrijë klienti? Zakonisht, mjaft këshillues dhe intervistues bëjnë një përmbledhje të problemit të klientit dhe më pas, drejtojnë pyetjen: “Cila mendoni se do të ishte zgjidhja?” “Çfarë do të bësh tani?” “A mund të marrësh pak kohë të imagjinosh se çfarë do të pëlqejë të ndodhte?” ose pyetje të tjera të ngjashme me këto. Pasi klienti propozon disa zgjidhje, ju mund të përdorni sekuencën e të dëgjuarit bazë duke rrenditur kështu aspekte të ndryshme të mendimeve dhe ndjenjave të klientit mbi situatën ideale. Shpesh klientët mund të arrijnë zgjidhjen e problemit të tyre në këtë fazë të intervistës.

Disa klientë preferojnë të përballen me një fazë të tillë në fillim të intervistës, madje para përcaktimit të problemit. Për shembull, klientë më pak verbalë ose individë të kulturave të ndryshme, mund të preferojnë përcaktimin e problemit kur ai lidhet me çështje të disiplinës në shkollë dhe një preferencë e tillë përshpejton procesin e zhvillimit të marrëdhënies. Disa klientë nuk preferojnë sesione të zgjatura të analizës së problemit, por kërkojnë një zgjidhje në moment. Nëse ju adaptoni stilin tuaj të intervistës sipas një nevojë të tillë, të thjeshtë por tepër evidente, ju do të arrini sukses në këshillimin e klientit, sukses i cili nuk mund të arrihet nëpërmjet aplikimit të metodave tradicionale të fokusuar tek problemi.

Një kategori klientësh e cila mund të përfitojë nga eksplorimi i kësaj faze, mund të përfaqësohet nga individë të cilët po përballen me vështirësi në marrjen e vendimit mbi profesionin, karrierën tyre. Shqetësimi është shpesh ambivalent, i paqartë dhe i vakët. Përcaktimi i një qëllimi të qartë mund të kontribuojë drejt përcaktimit të problemit dhe identifikimit të pikave të forta.

Rregulli për intervistat konfuze, pavarësisht nëse janë raste që lidhen me shqetësime në karrierë apo jetën bashkëshortore, është përcaktimi i një qëllimi në mënyrë eksplicite, identifikimi i pikave të forta të cilat lehtësojnë procesin e realizimit të qëllimit dhe vetëm më pas mund të merremi me eksplorimin e natyrës së problemit. Në disa raste, përcaktimi i qartë i qëllimit dhe identifikimi i pikave të forta, e bëjnë të panevojshëm identifikimin e problemit.

Koncepti përcaktimi i rezultateve është i nevojshëm duke e bërë intervistën të jetë specifike. Edhe në rastet kur bëni terapi afat-gjatë me një klient apo jeni në një takim të shkurtër me klientin në një agjensi punësimi, të pyeturit mbi atë që dëshiron klienti është tepër i rëndësishëm për marrëdhënien e vendosur me të dhe arritjen e rezultateve të pritshme. Shpesh, klienti dhe këshilluesi supozojnë se janë të fokusuar në arritjen e të njëjtit rezultat, ndërsa në të vërtetë, secili prej tyre është i fokusuar në drejtime të ndryshme. Një klient mund të jetë i kënaqur me faktin se tani flen më mirë gjatë natës, ndërsa këshilluesi dëshiron të arrijë një rikonstruksion të plotë të personalitetit. Klienti mund të preferojë një këshillë të shkurtër mbi kërkimin e një vendi pune, ndërsa këshilluesi, synon ta pajisë atë me më tepër informacion mbi testimin e aftësive profesionale dhe sugjeron një karrierë të re për klientin. Shpesh, klientët presin dhe dëshirojnë të marrin më shumë se çfarë mund të ofrojnë këshilluesit. Qartësimi i kësaj çështje në fillim të sesionit nëpërmjet drejtimit të pyetjeve mund të sigurojë avantazhe në kursimin e kohës dhe energjive.

Çështja e përcaktimit të rezultateve është me një interes të veçantë për perspektivën teorike dhe praktike. Rogers (1957, 1961) flet për mjaft klientë që karakterizohen nga inkongruenca ndërmjet vetes reale dhe ideale. Psikologët bihevjoriste e ndalin vëmendjen tek sjellja prezente e krahasuar me qëllimet dhe sjelljen e dëshiruar. Terapistë të fokusuar në aspektin e realitetit flasin për përmbushjen e nevojave të paplotësuara, ndërsa këshilluesit e orientuar ndaj aspektit tipar-faktor, flasin për mbështetjen e klientit që ndjehet i lehtësuar për të folur.

Mjaft drejtime teorike pyesin “Ku pozicionohet klienti dhe ku dëshiron të shkojë?” “Cila është diferenca ndërmjet botës reale dhe asaj të dëshiruar?” Blanchard dhe Johnson (1981) në librin e tyre mbi menaxhimin efektiv (Menaxher për 1 Minute) trajtojnë shkurtimisht një çështje të tillë:

“...Nëse ju nuk mund të më thoni se çfarë preferoni të arrini... kjo do të thotë se ende nuk keni një problem. Ju thjesht, po ankoheni. Një problem ekziston vetëm atëherë kur ekziston një diferencë ndërmjet asaj që ndodh

aktualisht dhe asaj që ju dëshironi të ndodhë”.

Pasi diferencat ndërmjet vetes reale dhe ideale, situatës reale dhe asaj të dëshiruar, ndërmjet natyrës së lidhjes tani dhe asaj të preferuar, e të tjera si këto, janë të qarta, çështjet mund të konfrontohen në mënyrë të qartë dhe të saktë. Ekziston një varietet i larmishëm aftësish, teknikash dhe teorish të cilat ndihmojnë në eksplorimin dhe përballjen e konfliktit me të cilin përballlet klienti.

Si shembull, referojuni pesë modeleve të fjalive:

Vendimmarrje: *“Në njërën anë, problemi mund të përkufizohet si...dhe në anën tjetër, rezultati i preferuar nga ju është... dhe ju keni këto aftësi dhe pika të forta të cilat ju ndihmojnë në arritjen e një qëllimi të tillë...”*

Roxheriane: *“Sipas përshkrimit tuaj, vetja juaj e vërtetë është....Ndërkohë, ju e shikoni veten tuaj ideale si...dhe ju keni disa cilësi pozitive si...”*

Bihevisoriste: *“Sjellja juaj aktuale është...por ju preferoni të silleni ndryshe. Për shembull, ju do të dëshironit shumë të....dhe ju vini në dukje sjellje dhe veprime të tilla pozitive në të kaluarën..”*

Këshillim martesor: *“Marrëdhënia juaj aktuale përshkruhet si..., por ju do të preferoni të shikoni disa ndryshime si...Si çift, ju karakterizoheni nga disa pika të forta si... të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit”*

Këshillim profesional (klient konfuz): *“Ju jeni në kërkim të një arsimimi (ose karriere) dhe nuk jeni të sigurt mbi përgjegjësitë tuaja. Megjithatë, ju i paraqitët qëllimet tuaja në perspektivën afatshkurtër dhe afatgjatë në mënyrë të qartë...ju keni patur përvoja profesionale pozitive në të kaluarën...si do t'i përdornit të gjithë këto element?”*

Mund të konstatooni se të gjitha fjalitë e mësipërme evidentojnë dhe grupojnë të gjitha diferencat ndërmjet përcaktimit të problemit dhe rezultateve të dëshiruara. Një përmbledhje e pikave të forta është përdorur gjithashtu për të ndihmuar klientin të kuptojë se ai është i aftë të zgjidhë problemin që e shqetëson. Mjaft klientë verbalë mund të përdorin një përmbledhje të tillë si pikënisje për veprimet e tyre. Ato do të zgjidhin diferencat e konstatuara me ndihmën tuaj ose në mënyrë të pavarur. Klientë të cilët përfshihen lehtë emocionalisht kanë nevojë për më tepër shprehje ndikuese dhe drejtim aktiv të ofruar nga këshilluesi. Vëzhgimi i reagimit verbal dhe joverbal të klientit ndaj një përmbledhjeje të tillë, mund të ndihmojë në përcaktimin e stilit të intervistës në fazën e katërt.

Faza 4: Eksplorimi i alternativave dhe përballja e papajtueshmërisë së klientit

“Çfarë do të bëjmë për një çështje të tillë?” Qëllimi i kësaj faze të intervistës është zgjidhja e problemit dhe lehtësimi i klientit. Problemi mund të konsistojë në zgjedhjen ndërmjet dy alternativave pozitive, marrjen e një vendimi në fushën e karrierës, ose një situatë tjetër e përmendur më lart. Klienti në këtë fazë e ka të vështirë të japë alternativa për zgjidhje. Detyra e këshilluesit ose intervistuesit është të shqyrtojë mundësitë dhe të ndihmojë klientin në identifikimin e mënyrave, të cilat e bëjnë atë të ndryshojë qëndrimin ndaj botës në përgjithësi.

Si arrin intervistuesi të konfrontojë dhe eksplorojë papajtueshmërinë?

Ekzistojnë dy mundësi në përgjigje të kësaj pyetjeje. Së pari, mund të realizohet një përmbledhje e shkurtër e konfliktit të klientit dhe e perspektivës së tij dhe të përdoret sekuenca e të dëgjuarit bazë për të lehtësuar procesin e zgjidhjes së problemit. Së dyti, mund të realizohet një përmbledhje e shkurtër e konfliktit të klientit dhe perspektivës së tij dhe të shtohet perspektiva e vetë intervistuesit, nëpërmjet paraqitjes së të shprehive ndikuese (dhënia e feedback-ut, vetëhapja, udhëzimi, dhënia i direktivave, interpretimit) dhe aplikimi i teorive të ndryshme në procesin e dhënies së ndihmës (geshalt, psikodinamike, bihevjoriste). Për intervistues të rinj në këtë praktikë pune është e preferueshme të përqendrohen në alternativën e parë-atë të lehtësimit të klientit vetëm nëpërmjet aplikimit të shprehive dëgjuese.

Le të supozojmë një shembull, ku një menaxher biznesi bisedon me një të punësuar mbi një konflikt ndërmjet departamentit të blerjes dhe departamentit të prodhimit. Në strukturën e intervistës të sugjeruar këtu, detyra e parë e menaxherit është të vendosë marrëdhënie me të punësuarin. Vendosja e raportit vijon me mbledhjen e informacionit dhe përcaktimin e problemit dhe këtu mund të identifikohen mjaft mospërputhje. Çfarë dëshiron i punësuar (dhe menaxheri në këtë rast) të bëjë? Çfarë rezultati është i pritshëm, i dëshiruar? Pas përcaktimit të botës reale dhe ideale, menaxheri mund të ndihmojë të punësuarin të përballet me kontradiktat. Menaxheri mund të vetëhapet duke folur mbi mënyrat sesi ai zgjidhi problemet e tij në të kaluarën. Menaxheri mund t'i japë të punësuarit disa këshilla ose një udhëzim të thjeshtë për të zgjidhur problemin. Gjithashtu, problemi mund të zgjidhet me përdorimin vetëm të shprehive dëgjuese.

Për ta sjellë këtë të punësuar në fazën e katërt, përmbledhjet e dhëna si shembull në përfundim të fazës së tretë janë mjaft të nevojshme. “Në njërën anë, problemi që ju prezantoni është...por gjithashtu, ju keni përcaktuar mjaft qartë dhe objektivat për zgjidhjen e tij. Ata janë..... Nisur nga problemi dhe qëllimet

tuaja, çfarë mendoni se mund të jetë një zgjidhje për një çështje të tillë?” Në seanca të ndryshme këshillimi, mjaft klientë ndjehen konfuzë mbi çështjet, problemet dhe qëllimet. Një përmbledhje e qartë e situatës aktuale e kombinuar me një prezantim të situatës ideale, mundëson qartësimin e problemit në mënyrë që klienti të jetë në gjendje të përcaktojë alternativa për zgjidhjen e tij. Në vazhdim, mund të konstatohet se sekuenca e të dëgjuarit bazë dhe drejtimi i pyetjeve me takt, ndihmojnë klientin të eksplorojë përgjigjet dhe zgjidhjet e mundshme. Më poshtë jepet një listë e shkurtër pyetjesh të cilat mund të drejtohen për të mbështetur klientin gjatë procesit të zgjidhjes së problemit:

- “Cilat mund të jenë disa alternativa të tjera të menduara nga ju?”
- “A mund të mendoni për disa alternativa—ato që ju vijnë në mend në mënyrë spontane?”
- “Cilat alternativa kanë funksionuar mirë për ju në të kaluarën?”
- “Cila pjesë e problemit mund të zgjidhet tani nëse i gjithë problemi mbetet i pazgjidhur për momentin?”
- “Cilat nga idetë që ju keni prezantuar ju duket më optimale?”
- “Cilat do të ishin rezultatet që do të gjeneronin nga zgjedhja e nje alternative të tillë?”

Në fakt, të gjitha këto pyetje synojnë të nxisin klientin të mendojë për zgjidhje të reja. Ju mund të merrni në konsideratë gjithashtu dhe shprehi inkurajuese, të cilat përdoren për të ndihmuar klientin të ndalojë dhe të eksplorojë mundësi të reja. Përsëritja e fjalëve kyçe ndihmon klientin të eksplorojë mundësi të reja të ndryshme për veprim.

Këshillimi dhe terapia afat-gjatë janë të orientuara drejt zgjidhjes së problemit në mënyrë të natyrshme dhe të favorshme për jetën e klientit. Këshilluesi ka nevojë të vendosë një raport, të përcaktojë problemin dhe rezultatet e pritshme nga klienti. Dallimi ndërmjet problemit dhe rezultatit të dëshiruar është inkonsistenca e madhe të cilën këshilluesi synon ta eliminojë. Kjo inkonsistencë mund të adresohet në tre mënyra. Këshilluesi mund të përdorë shprehinë e të ndjekurit me vëmendje për t’u qartësuar mbi pikëpamjen e klientit dhe pastaj të ofrojë feedback mbi problemin dhe qëllimet për zgjidhjen e tij. Në mjaft raste, klientët e realizojnë vetë sintezën e problemit duke e zgjidhur atë vete. Nëse klientët nuk gjenerojnë vetë përgjigje, atëherë terapisti mund të përdorë shprehi të tilla, si sugjerim, vetëhapje apo shprehi ndikuese për të adresuar dhe zgjidhur këtë inkonsistencë. Në një rast të tillë, këshilluesi do të mbështetej në një teori ose pikë reference të vetën. Së fundi, gjatë procesit sistematik të zgjidhjes së problemit, klienti dhe këshilluesi së bashku mund të gjenerojnë alternativa për veprim dhe të vendosin prioritete

për alternativat më efektive. Është e preferueshme që gjatë intervistës, modeli i zgjidhjes së problemit të mbahet parasysht sidomos në këtë fazë:

1. përcakto shqetësimin, duke mbajtur parasysht qëllimin dhe rezultatin e pritshëm
2. gjenero alternativa
3. vendos mbi veprimin

Gjatë kësaj faze, problemi duhet mbajtur parasysht edhe gjatë kohës së identifikimit të alternativave për një zgjidhje të mundshme si dhe përcaktimit të hapave të veprimit për t'u ndërmarrë në të ardhmen. Megjithatë, një vendim për veprim nuk është i mjaftueshëm, mendimet, ndjenjat dhe sjellja duhet të përgjithësohen përtej kornizës së intervistës në vetvete.

Faza 5: Përgjithësimi dhe transferimi i të mësuarit

“A do ta ndërmarrësh një hap të tillë?” Nëse nuk i kushtohet vëmendje e duhur transferimit dhe përgjithësimi të intervistës në jetën e përditshme, të gjitha fazat e përmendura më lart që nga mbledhja e informacionit, tek formimi i koncepteve të caktuara gjatë intervistës, do të jenë një punë e shkuar dëm. Kompleksiteti i jetës është i tillë i cili e bën të vështirë transferimin e sjelljes së mësuar në intervistë në kontekste të tjera, në jetën e përditshme. Referojuni përsëri skenarit të këshillimit dhe menaxhimit të prezantuar më parë. Menaxheri mund të ofrojë këshilla të vlefshme rreth zgjidhjes së problemit ndër mjet departamentit të prodhimit dhe blerjes, por nëse i punësuar vazhdon të mbetet i “fiksuar” në sjelljen e mëparshme, problemi do të vazhdojë të ekzistojë në të ardhmen. Klienti dhe këshilluesi mund të punojnë së bashku mbi një plan të shkëlqyer përsa i përket një zgjedhje të re në karrierë apo mbi zgjidhjen e një konflikti në familje. Por nëse klienti kthehet në të njëjtin kontekst profesional ose familjar, transferon atë që ka mësuar, një transferim i tillë mund të jetë i vështirë dhe ndonjë herë thuajse i pamundur. Këshilluesi dhe klienti mund të vendosin të vazhdojnë të punojnë bashkë për të kuptuar dhe ndryshuar sisteme madhore të jetës së klientit.

Mjaft terapi, moderne dhe tradicionale, bazohen mbi supozimin se ndryshimi i sjelljes apo i qëndrimit mund të ndodhë si pasojë e një procesi të mësuarit të pandërgjegjshëm; sipas tyre klientët do të ndryshojnë në mënyrë spontane. Ndryshimi nuk ndodh lehtë dhe ruajtja e këtij ndryshimi në nivelin e mendimeve, ndjenjave apo sjelljeve është edhe më i vështirë. Psikologjia bihevisoriste i ka kushtuar vëmendje të veçantë transferimit të trainimit dhe ka zhvilluar një seri teknikash për transferim e megjithatë klientët tentojnë të kthehen në origjinë, në sjellje më pak të qëllimshme. Metoda dhe teori

specifike kanë përdorur transferimin e të mësuarit të ilustruar nëpërmjet intervistës së mëposhtme.

Role-play. Sikurse është prezantuar dhe në seksionet praktike të këtij teksti, klienti mund të praktikojë sjelljen e re nëpërmjet një role-play me këshilluesin apo intervistuesin. Një teknikë e tillë thekson aspekte të veçanta të mësuarit dhe rrit shanset që klienti të ndërgjegjësohet mbi rëndësinë e aplikimit të kësaj sjellje dhe në kontekste të tjera jashtë intervistës.

Imagjinata. Klienti ftohet të imagjinojë një ngjarje në të ardhmen si dhe të parashikojë nevojat e tij dhe çfarë do të bëjë për ta menaxhuar situatën në mënyrë më efektive.

Paraqitja e sjelljes me grafik dhe vlerësimi i progresit. Klienti mund të regjistrojë numrin e rasteve kur disa sjellje të caktuara manifestohen dhe t'i raportojë ato këshilluesit. Me klientë të tjerë, mbajtja e një ditari informal ku përshkruhen reagimet subjektive personale, mund të jetë një alternativë më e favorshme.

Detyrat e shtëpisë. Intervistuesi mund t'i sugjerojë klientit të realizojë disa “detyra” në kuadër të intervistës gjatë javës në vijim. Një praktikë e tillë ndeshet gjithnjë e më shpesh në situata këshillimi.

Këshillimi në familje ose në grup. Ndonjëherë problemet e klientit janë të vendosura në një kontekst përtej planit individual sikurse mund të jetë një martesë e vështirë, situata komplekse në familje, punë etj. Kështu, një numër gjithnjë në rritje këshilluesish tentojnë të përfshijnë në procesin e këshillimit bashkëshortët dhe anëtarë të tjerë të familjes. Gjithashtu, edhe në ambiente pune, menaxheret dhe drejtuesit e personelit e konsiderojnë zhvillimin organizativ dhe zhvillimin e grupeve si vendimtare për përmirësimin e shprehive të individit dhe transferimin e sjelljes.

Ndjekja (follow-up) dhe mbështetja. Klientit mund t'i kërkohet të rikthehet periodikisht për t'u takuar me profesionistin dhe për të diskutuar mbi gjendjen e sjelljes. Gjatë kësaj kohe, këshilluesi mund të vazhdojë të ofrojë mbështetje emocionale dhe sociale gjatë periudhave të vështira.

Sikurse shihet, përdorimi i shprehive të ndikimit është mjaft i rëndësishëm gjatë fazave të fundit të intervistës. Gjatë drejtimit të një interviste duke përdorur vetëm shprehinë e të dëgjuarit, elementët e ndjekjes dhe mbështetjes mund të jenë gjithashtu të favorshëm për t'u përdorur. Më poshtë prezantohen disa pyetje të cilat ndihmojnë klientët të planifikojnë përgjithësimin e tyre mbi intervistën:

- “Cila nga karakteristikat e kësaj interviste është e rëndësishme për ju të cilën mund ta aplikoni dhe më vonë në shtëpi?”

- *“Ju gjeneruat disa ide dhe zgjidhët një për ta zbatuar. Si do të arrini të kuptoni se po e zbatoni një vendim të tillë të ndërmarrë?”*
- *“Çfarë dëshiron të kesh si “detyrë shtëpie” për të reflektuar gjatë javës dhe më pas e diskutojmë bashkë herën tjetër kur të takohemi?”*

Secila prej këtyre pyetjeve mund të kombinohet me sekuencën e të dëgjuarit bazë për të hartuar një plan përgjithësues në një mënyrë të detajuar. Në fund të intervistës, ju mund të pyesni klientin tuaj “A do ta zbatoni një plan të tillë?” duke propozuar kështu një formë kontrate për ju të dy në të ardhmen. Këto janë disa nga mundësitë të cilat ndihmojnë të zhvillojnë dhe ruajnë ndryshimin e klientit. Çdo individ do t’i përgjigjet efektivisht këtyre teknikave dhe shprehitë vëzhguese mund të përdoren për të përcaktuar cila teknikë ose grupim teknikash është më e favorshme për t’u përdorur me një person të veçantë. Për të arritur një impakt dhe transferim maksimal të sjelljes, sugjerohet kombinimi i disa teknikave. Faktet tregojnë se qëndrimet dhe sjelljet e mësuara në intervistë nuk transferohen lehtësisht në jetën e përditshme pa një planifikim paraprak dhe të kujdesshëm.

Cikli i vendimmarrjes: një element i rëndësishëm i intervistës

Modeli me pesë faza i intervistës u hartua mbështetur në një model linear të procesit të vendimmarrjes. Jo të gjithë klientët ndihen komfort me të gjitha fazat e prezantuara, pavarësisht nga historiku (background) i tyre kulturor. Për shembull, çështjet e vendosjes së raportit dhe strukturimi mund të konsiderohen si mjaft të rëndësishme në krahasim me elementët e tjerë. Në disa raste, gjatë intervistës mund të ndahet informacion i ri, i cili do të rezultojë në kthimin mbrapa në fazën 2 e cila konsiston në ripërcaktimin e shqetësimeve të klientit në një mënyrë të re.

Megjithëse të pesë dimensionet duhet të mbahen parasysh gjatë intervistës dhe planit të trajtimit, jo gjithnjë është e nevojshme që intervista t’i kalojë pesë fazat në mënyrë të paracaktuar. Si rezultat, ekziston dhe një model tjetër në formë rrethi i cili emërtohet: “cikli i vendimmarrjes” (figura 2).



Një rreth nuk ka fillim dhe fund dhe shpeshherë përdoret si simbol i një marrëdhënie të barabartë në të cilën këshilluesi dhe klienti punojnë së bashku mbi një problem të caktuar. Mund të konstatohet se disa klientë ndërsa fitojnë më shumë besim tek profesionisti, preferojnë të jenë aktivë dhe të pavarur sidomos në fazat e para. Megjithatë në fazat në vijim, prezenca dhe asistenca e këshilluesit është e nevojshme duke e bërë të domosdoshëm bashkëpunimin e tyre reciprok gjatë punës për arritjen e qëllimit të përcaktuar. Gjithsesi, nuk duhet mbivlerësuar rëndësia e strukturimit-pjesë e fazës së parë dhe përcaktimi i qëllimit të përbashkët-pjesë e fazës së tretë. Nëse këshilluesi dhe klienti janë të qartë mbi atë që pritët të ndodhë gjatë intervistës dhe bien dakort për qëllimin e përcaktuar për t'u arritur, mund të thuhet se janë ngritur themelet e besimit dhe ndihmës reciproke të ofruar nga të dy palët.

Mund të ndodhë që sesioni i këshillimit të “falimentojë” nëse ekzistojnë boshllëqe në njohuritë e këshilluesit dhe klientit mbi pritshmëritë e tyre ndaj këshillimit si dhe çfarë mund të arrihet nëpërmjet një teknike të tillë. Nëse të dy palët janë të qarta mbi atë që do të ndodhë, sesionet e intervistave në vijim do të jenë pozitive. Klientë të cilët marrin pjesë në mënyrë aktive gjatë procesit të formulimit të qëllimit janë më të predispozuar të ndërmarrin veprime për realizimin e tyre, më të hapur për të ndryshuar dhe të modifikojnë qëllimet fillestare nëse lind nevoja për t'i rishikuar ato. Cikli i vendimmarrjes mund të na ndihmojë të mbajmë mend se procesi i ndihmës është një përpjekje reciproke ndërmjet këshilluesit dhe klientit.

5.2. INTERVISTIMI DHE KËSHILLIMI I FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Intervistimi i fëmijëve / adoleshentëve

Fëmijët në Shqipëri përbëjnë mbi 40 % të popullsisë së vendit dhe ata përfaqësojnë një nga grupet moshore më të mëdha. Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve të OKB-së çdo fëmijë gëzon të drejtën e marrjes së një informacioni në përshtatje me moshën si dhe të drejtën e fjalës, të shprehjes së mendimit dhe të marrjes në konsideratë si një individ me të drejta të patjetërsueshme.

Ne si profesionistë na del si detyrë, të marrim në konsideratë respektimin e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet zbatimit të një etike dhe rregullash që vendosin në qendër fëmijën.

Ky material do të përqëndrohet në këto momente kryesore:

1. Specifika e intervistimit të fëmijëve nga profesionistët;
2. Disa shprehje të komunikimit me fëmijët;
3. Pyetje, sjellje dhe qëndrime që duhen mbajtur parasysh gjatë intervistimit të fëmijëve në situata të caktuara;

Kush konsiderohet fëmijë?

Fëmijë konsiderohet çdo individ deri në 18 vjeç. Në këtë përkufizim duhen mbajtur parasysh edhe interpretimet kulturore të moshës feminare. Përgjithësisht tentohet të ulet kjo moshë deri më 16 apo 14 vjeç.

Disa parime që duhen mbajtur parasysh në përmbushje të kësaj përgjegjësie janë:

- Interesi më i lartë i fëmijës,
- Fëmijët kanë të drejtë absolute për privatësi,
- Luftimi i paragjytimeve,
- Raportimi i saktë, i plotë dhe i profesional i ngjarjes,
- Pjesëmarrja e fëmijës.

Specifika e intervistimit të fëmijëve/adoleshentëve nga profesionistët

Ka një numër vështirësish, specifikash dhe rreziqesh që duhen mbajtur parasysh kur kemi të bëjmë me fëmijët/adoleshentët.

- Gjatë intervistimit të tyre ka shumë rëndësi ambjenti ku ata janë vendosur.

Mundësisht duhet të jetë një dhomë e veçantë, ku nuk ka hyrje dhe dalje të personave të tjerë. Dhoma mund të jetë e pajisur me lojra dhe objekte që ofrojnë qetësi për fëmijë të moshave të ndryshme.

- Profesionistët duhet të mbajnë parasysh se mënyra se si ata komunikojnë me fëmijën ka një ndikim shumë të madh në informacionin që ofron fëmija. Ata duhet të jenë shumë të kujdesshëm edhe me detaje të tilla si mënyra se si ulen, ku ulen, çfarë raporti trupor vendosin me fëmijë. Mundësisht të përdoren të njëjtat karrige, pa tavolina në mes dhe në varësi të moshës mund të ulen edhe në dyshe apo në karrige të vogla që përdoren për t'ju dhënë atyre më shumë siguri dhe mbështetje.
- Këshillohet që fëmijët në varësi nga kosha të lejohen të luajnë me lodra që ndodhen në ambjentin e dhomës për t'ju siguruar atyre një lehtësim nga ankthi dhe frika që i mundon.

Pasi të jenë siguruar disa elementë minimalë dhe të domosdoshëm të ambjentit ku realizohet intervistimi, vëmendja përqëndrohet tek mënyra e komunikimit dhe e intervistimit të fëmijëve:

- Fëmijët janë shpesh të pazotë të pohojnë veten dhe të kundërshtojnë një të rritur, prandaj do t'i përgjigjen pyetjeve në një mënyrë që ata e mendojnë se ju dëshironi që ata të përgjigjen. Ndërsa më vonë, në adoleshencë, ata kanë prirjen që të kundërshtojnë të rriturin. Në çdo rast është e rëndësishme të ruheni nga të dhënit atyre të informacionit se çfarë presim ne që ata të thonë. Ata duhen inkurajuar të zbulojnë opinionet e tyre. Kjo arrihet duke i siguruar ata se ju jeni të interesuar vetëm në çfarë ata mendojnë dhe se nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara. Ndonjë përafrim që duket si test duhet të evitohet, pasi kjo mund t'i bëjë të heshtin ose të japin një seri përgjigjesh që ata mendojnë se të rriturve do t'i pëlqente të dëgjonin.
- Ka një tendencë të fortë për përgjigje në heshtje tek fëmijët. Në të njëjtën kohë, shumë fëmijë priren të thonë “po”, pavarësisht nga pyetja ose se çfarë mendojnë ata për të. Pyetjet duhet të jenë të tilla që të mos kërkojnë përgjigje të shkurtër me po/jo. P.sh. A do të dëshiroje ta bëje edhe ti atë veprim? (po/jo). Ne vend të saj mund të pyesim: Si do të ndjeheshit ju po ta bënit atë veprim?
- Përveç tendencën për t'u konformuar që vihet re shpesh tek fëmijët, ata shfaqin një tendencë tjetër për t'u përgjigjur me “nuk e di”. Ata thonë nuk e di për një seri arësyesh:
 - nuk janë të interesuar të përgjigjen,
 - nuk e kuptojnë pyetjen ashtu si është formuar ose

terminologjinë e përdorur;

- ata mendojnë se ju nuk prisnin që ata të dinë diçka mbi situatën,
 - ata nuk duan të pranojnë çfarë dinë ose ata vërtet nuk dinë;
 - ata kanë frikë të flasin;
 - ata mendojnë se duke mos folur mbrojnë të afërmit dhe familjarët e tyre (veçanërisht kur bëhet fjalë për prindërit).
 - Rrjedhimisht shprehja “nuk e di” është një përgjigje që ka nevojë për një trajtim të kujdesshëm. Është shumë e rëndësishme të dihet se asnjë konkluzion aq më tepër vendim nuk duhet të bazohet mbi “nuk e di”. Aq më pak mund të arrihet në konkluzionin se fëmijët nuk dinë.
- Fëmijët hutohen relativisht lehtë. Ata i kushtojnë vëmendje aspekteve të parashikueshme të situatës së intervistës ose pyetjeve. Ata mund të hutohen nga stilolapsi që ju mbani në duar, nga një zhurmë jashtë dritares, nga njerëzit që hyjnë dhe dalin nga dhoma, etj. Përvetse bëhet shqetësues për intervistuesin, kjo mund të rezultojë në humbje kohe dhe informacion i parëndësishëm. Për të tërhequr vëmendjen e tyre, një intervistë duhet të përfshijë çështje të ndryshme si dhe teknika të ndryshme. Në këtë rast mund të përdoren si pyetjet verbale ashtu edhe lojrat apo vizatime të ndryshme, të cilat fëmija i shpjegon gjatë kohës së realizimit të tyre.
 - Një vend qetë për të realizuar intervistën, jo i vëzhguar dhe i çliruar nga përfshirje të forta emocionale mund të përmirësojë përqëndrimin e fëmijës. Sidoqoftë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që kohëzgjatja e përqëndrimit varet shumë nga moshë por në mënyrë të veçantë nga natyra e fëmijës. Me fëmijët e vegjël është e vështirë të presësh një përqëndrim afatgjatë dhe cilësor edhe në kushte të zakonshme. Është e rëndësishme të mbahet parasysh që intervista të jetë e relativisht e shkurtër.
 - Fëmijët priren t’i interpretojnë pyetjet fjalë për fjalë. Është kjo arësyeja që gjatë intervistimit të tyre duhet të përjashtohen figurat letrare si metafora, analogjitë, për ta lehtësuar procesin e të kuptuarit të pyetjes. Pyetja duhet formuluar në atë mënyrë që fëmija i moshës x të kuptojë supozimin.
 - Fëmijët kanë prioritete krejt të ndryshme nga ato të të rriturve. Ata mund të mos kuptojnë që rregulli i intervistës është që njëri pyet e tjetri përgjigjet. Mund të duan të pyesin e të përgjigjen dhe të bëhen kuriozë rreth intervistuesit. Mënyra më e mirë e reagimit është t’ju përgjigjemi sa më shkurt, duke mos shfaqur asnjë shenjë nervozizmi apo zemërimi me ata. Për fëmijën që fillon të përdorë pa fund “pse?”, gjëja më e mirë është

t'i hutosh me diçka tjetër dhe t'i largosh nga objekti i tyre i pyetjeve.

- Shumë shpesh fëmijët shpjegojnë atë që bëjnë të tjerët me termat e ndjenjave dhe karakteristikave të tyre. Ata e kanë të vështirë të shikojnë botën nga pozicioni i të tjerëve. Kjo është një karakteristikë e zhvillimit të tyre ku egocentrizmi fëmënor kontrollon gjithë mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit të tyre. P.sh. ju mund të pyesni një fëmijë se pse i ka bërëtitur nëna dje dhe ai mund të përgjigjet: Ajo ishte shumë e trishtuar. Në fakt, do të ishte me shumë rëndësi të verifikohej nëse trishtimi i përket ndjenjave të vet fëmijës apo ndjenjave të nënës.
- Fëmija dëshiron të flasë me të tjerët rreth intervistës dhe kështu mund të ndikojë tek të intervistuarit e tjerë. Këta të fundit mund të zhvillojnë një ide të gabuar rreth asaj që ju po bëni. Ju duhet të pyesni se çfarë kanë dëgjuar dhe se çfarë presin ata për rastin në fjalë, dhe më pas të qartësoni keqkuptimet e mundshme.
- Gjatë intervistës me fëmijë të moshave të ndryshme duhet të mbajtur parasysh se fëmijë të ndryshëm kanë ritëm të ndryshëm të reagimit. Kjo do të thotë që jo të gjithë reagojnë me të njëjtën shpejtësi, jo të gjithë krijojnë besim në të njëjtën kohë, jo të gjithë janë natyra të hapura dhe komunikuese. Gjëja më e mirë është që të kemi durim dhe t'i lëmë ata të veprojnë në ritmin e tyre. Çdo përpjekje për t'i nxitur ata të flasin mund të veprojë në të kundërt, duke i bërë ata edhe më të mbyllur. Në thelb, reagimet e fëmijëve nuk duhen marrë asnjëherë si reagime ndaj personit tuaj. Ato janë reagime të lidhura me traumën, eksperiencat dhe natyrën e fëmijës.
- Bëjini të qartë fëmijës se ju jeni atje për të, se ai është tashmë i sigurtë dhe lërinë të kuptojë se ai është në vendin dhe kohën e duhur dhe gjithçka bëhet për të mirën dhe sigurinë e tij.

Disa shprehje të komunikimit me fëmijët/adoleshentët

Kujdes i duhet kushtuar mënyrës se si komunikojmë me këtë target grup, në varësi të moshës dhe nivelit të zhvillimit. Në këtë aspekt tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- Pyetjet që ju drejtohen fëmijëve duhet të jenë të qarta dhe të drejtpërdrejta.
- Pyetjet nuk duhet të përmbajnë përgjigjen brenda pasi si të tilla shërbejnë për të sugjestionuar fëmijën.
- Pyetjet nuk duhet të jenë traumatizuese për fëmijën.

- Pyetjet duhet të jenë të kombinuara midis atyre të hapura dhe të mbyllura.

a) *Pyetjet e mbyllura*

- kërkojnë përgjigje me “po” ose “jo”
- fillojnë me “a është...?”, “a janë...?”, “a ke...?” etj. P.sh. “a ke frikë të shkosh në shtëpi?”

b) *Pyetjet e hapura*

Pyetjet e hapura nuk mund t’ju përgjigjesh lehtësisht me “po” ose “jo”. Ato kërkojnë shpjegim dhe e ftojnë fëmijën të flasë. Këto lloj pyetjesh fillojnë me “Çfarë...?”, “Si...?”, “Pse...?”, “A mund...?” etj.

Çfarë? Përdoret për të pyetur për fakte dhe informacion (Çfarë do të më tregosh për rastin? Çfarë ke parë ti? Çfarë di ti?)

Si? Mundëson bashkëbisedimin të kalojë nga një pjesë në një tjetër dhe të eksplorojë mbi emocionet (Si ndjehesh?)

A mund? Mundëson një eksplorim maksimal nga ana e fëmijës (A mund të na tregosh se si u sollën prindërit e tu kur hynë në shtëpi?)

Pse? Mundëson identifikimin e arsyeve, shkaqeve nga këndvështrimi i fëmijës.

Kujdes

- Nuk këshillohet intervistimi i të njëtit fëmijë për të njëtin problem nga profesionistë të ndryshëm.
- Nuk këshillohet intervistimi i shpeshtë i fëmijës për të njëjtin problem qoftë edhe nga i njëjti profesionist.
- Nëse fëmija nuk dëshiron të flasë, kjo duhet respektuar.
- Fëmija nuk duhet joshur të flasë duke i ofruar dhurata apo premtime.
- Nëse fëmija gjatë komunikimit emocionohet, duhet kërkuar mbështetja nga specialistë të tjerë.
- Fëmija duhet ruajtur nga riviktimizimi.

5.3 INTERVISTIMI DHE KËSHILLIMI I RASTEVE TË ABUZIMIT

Intervistimi me fëmijët/adoleshentët

Fëmijët në veçanti mund të kërkojnë ndihmë të konsiderueshme nga ana e intervistuesit, para se ata të mund të ndajnë çdo gjë. Me fëmijët një person i gjallë, i ngrohtë, që i pëlqen ata dhe i pranon, do të jetë i aftë të marrë informacion më lehtësisht.

Kështu ndarja e diçkaje gazmore dhe interesante me ta ndihmon për fillimin e sesionit. Lojërat në dhomën e këshillimit janë të dobishme kur kemi të bëjmë me fëmijë. Ju do të gjeni se fëmijët kur flasin preferojmë të mbajnë diçka në duar, përdorimi i vizatimeve gjatë bisedës mund të e dobishme për fëmijët dhe intervistuesin. Vizatimet shpesh tregojnë se çfarë po ndodh në jetën e fëmijëve.

Sugjerimet e mëposhtme është mirë ti marrim në konsideratë.

- Përshkrim i përgjithshëm i asaj çfarë ka ndodhur;
- Fakte kryesore të situatës;
- Emocionet;
- kur është e përshtatshme, arsyet e situatës nëpërmjet pyetjeve pse.

Por mos prisni që ky informacion të vijë në mënyrë të rregullt. Nëse jeni të duruar dhe përdorni mirë shprehje të ndjekjes, do të jeni eventualisht të aftë të nxirrni historinë e tyre të plotë. Shprehjet e dëgjimit dhe vëzhgimit janë të rëndësishme të përdoren me fëmijët. Fëmijët shpesh në jetën e përditshme u thuhet se çfarë të bëjnë. Në qoftë se i dëgjojnë ata dhe ndërtimin e botës, realitetit nga ana e tyre, ne do të mund të përforcojmë cilësitë unike të tyre dhe t'i ndihmojmë ata të zhvillojnë besim tek vetja dhe vlerat e tyre.

Ndjekja

- Shmangni vështrimin poshtë tek fëmijët.
- Energjia e tyre është e tillë, saqë ndihmon nëse kanë ndonjë gjë tjetër për të bërë me duart e tyre. (ndërsa flasin mund të luajnë).
- Kërcime nga tema më tepër se të rriturit; përdorimi i shprehjeve të ndjekjes për ti kthyer në çështjet kritike që nevojiten të diskutohen)

Pyetjet

Përdoren fjali të shkurtra, fjalë të thjeshta dhe stil konkret i gjuhës duke shmangur abstragimet.

Fëmijët mund të kenë vështirësi me pyetjet e hapura dhe të përgjithshme:

- “Mund të më tregosh në përgjithësi se çfarë ndodhi?”

Kjo pyetje mund të zbërthehet nëpërmjet përdorimit të një përzjerje pyetjesh të hapura dhe të mbyllura:

- “Ku ishte ti kur ndodhi sherri?”
 - “Çfarë po ndodhte pak para se të plaste sherri?”
 - “Po më pas çfarë ndodhi?”
 - “Si u ndje ai?”
 - “A ishte ajo e zemëruar?”
 - “Çfarë ndodhi më pas?”
-
- Në pyetjen e fëmijëve për tema prekëse jini veçanërisht duhet jemi të kujdesshëm në përdorimin e pyetjeve të mbyllura udhëheqëse.
 - Duhet të përpiqemi të marrim perspektivën e tyre dhe jo tonën.

Inkurajimi, perifrazimi dhe përmbledhja

- Mësueset me eksperiencë dhe efektive të shkollës fillore përdorin këto shprehje në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht perifrazimin dhe përmbledhjen.
- Këto shprehje, shoqëruara me ndjekje dhe pyetje të mira janë shumë të rëndësishme në të ndihmuarit e fëmijëve për të thënë historinë e tyre.

Çështje të tjera

- Siguroni një atmosferë të përshtatshme për fëmijët, me karrige të vogla, mure me ngjyra dhe objekte interesante në dhomë.
- Ngrohtësia dhe pëlqimi është i rëndësishëm për fëmijët.
- Përdorni emra në vend të përemrave.

a. Raste të abuzimit seksual

Viktima të përdhunimit janë përgjithësisht të turpëruara, ndjehen fajtoresh dhe kanë frikë nga reagimi i njerëzve të tjerë. Shpesh ndodh që viktima të

stigmatizohet dhe fajësohet më shumë se përdhunuesi. Ato përballen me egërsinë e familjarëve, dyshimet e miqve dhe të afërmeve, por në ndonjë rast edhe me paragjykimet dhe keqtrajtimet poftë ato të profesionistëve që supozohet se duhet t'i ndihmojnë ato.

Qëndrimet negative ndaj viktimave të përdhunimit e kanë origjinën tek qëndrimet ndaj grave, viktimave të përdhunimit që të çojnë tek mite dhe paragjyime mbizotëruese në shoqëri. Vajzat mendohen se e provokojnë përdhunuesin nga mënyra se si vishen, se si ecin, si flasin dhe sillen.

Gazetarët janë ndër të parët që mund të përballen me viktimat e përdhunimit por njëkohësisht për të qenë nën ndikimin e miteve dhe stereotipeve që lidhen me viktimën dhe abuzuesin. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë kur rasti është i dyshimtë, kur nuk ka shenja dëmtimi, kur denoncimi është relativisht i vonuar dhe kur vajza paraqitet relativisht e qetë dhe pa emocione.

Në të tilla raste kërkohet që profesionistët në përgjithësi t'i japin gjithë vëmendjen e duhur viktimës. Ata duhet të jenë të paanshëm, jo paragjygues, dhe të përdorin metodat profesionale në trajtimin e viktimës. Ata duhet të mbajnë parasysh faktin se viktimë mund të vuajë nga trauma e përdhunimit, që i shfaq efektet e saj pas aktit të dhunshëm.

Viktima duhet trajtuar në një ambjent të veçantë, pa lëvizje dhe hyrje dalje, në një vend të sigurtë dhe aspak kërcënues për viktimën.

Në këtë rast duhet mbajtur parasysh se:

- një profesioniste femër mund të bëjë intervistën e parë të viktimës
- viktimë mund të qëndrojë e shoqëruar edhe nga ndonjë i afërm i saj, nëna kryesisht, për t'u ndjerë e sigurtë dhe e mbrojtur
- shmangni paragjykimet dhe stereotipet tuaja personale gjatë intervistimit të viktimës.

Disa këshilla për intervistimin e viktimës mund të jenë:

- realizoni një intervistë me viktimën në fokus - çfarë do të thotë mbani parasysh moshën, arsimin, klasën, fenë, dhe pozicionin social, etj
- përpikuni të jeni sa më objektiv, duke shmangur çdo lloj axhende të parapërgatitur
- shmangni pyetjet dhe xhestet sugjestionuese - mësoni viktimën të tregojë sa më shumë që të jetë e mundur - vlerësoni informacionin që vjen nga viktimë dhe mos u përpikni të konfirmoni mendimet dhe informacionin tuaj

- shmangni çdo lloj manipulimi
- kërkon informacion shtesë që konfirmon denoncimin e viktimës (p.sh. shenja që konfirmojnë dhunën e ushtruar, etj).

b) Raste të dhunës në familje

Situata psikologjike e një fëmije që vjen nga eksperienca e dhunës në familje nuk është aspak e lehtë. Ndërkohë që ai është rritur mes atyre pjestarëve të familjes (të mirë apo të këqinj qofshin), atij i duhet tashmë të ngrihet kundër tyre. Ndjenjat e tij/të saj mund të jenë të shumfishta. Në disa raste si rezultat i dhunës në familje ai mund të ketë humbur një ose disa anëtarë të familjes si nënën, babain apo motra dhe vëllezër. Kjo e komplikon edhe më shumë situatën. Në ndonjë rast atij/asaj mund t'i duket vetja në një pozicion për të mbrojtur nderin dhe privatsinë e familjes. Ndonjëherë ata ndjehen të turpëruar dhe fajtor për atë çfarë ka ndodhur në familjen e tyre. Shpesh ata kërcënohen nga dhunuesi për të mos treguar të vërtetën mbi situatën në familjen tyre. Të gjithë këta faktorë, por edhe të tjerë ndikojnë në procesin e intervistimit të fëmijës.

Në këto kushte profesionisti duhet:

- të sigurojë privatesinë e fëmijës që intervistohet dhe ta bëjë atë të ndjehet i sigurt për të folur për situatën në fjalë
- duhet të jetë i ndjeshëm
- duhet të dëgjojë me vëmendje fëmijën që intervistohet
- të vlerësojë dhe të tregojë se e kupton situatën në të cilën ndodhet fëmija
- duhet të ndihmohet fëmija, të qetësohet dhe të ndjehet mirë
- të mos e detyrojë fëmijën të flasë nëse ai nuk ndjehet gati për të folur
- të mos e kërcënojë dhe detyrojë të tregojë atë që në fakt nuk ka ndodhur
- të mos jetë ai që fyen dhe etiketon dhunuesin që mund të rezultojë njeriu më i dashur për fëmijën

Në rastin e dhunës në familje duhet patur parasysh se edhe mbas aktit të dhunës, fëmija por edhe anëtarë të tjerë të familjes mund të vazhdojnë të jetojnë së bashku.

c) Raste të trafikimit

Trafikimi i fëmijëve për qëllime prostitucioni apo shfrytëzimi për punë bëhet nga grupe të krimit të organizuar të cilët bashkëpunojnë ndërkombëtarisht

edhe përtej kufinjve. Përvoja e trafikimit zakonisht përfshin akte në seri të dhunës së ushtruar ndaj tyre si dhe poshtërime, fyerje, izolime dhe keqpërdorime. Si rezultat i dhunës shumëplanëshe, fëmijët e trafikuar përfjetojnë dëmtime të ndërgjegjes, paaftësi për të menduar dhe vepruar, kanë ritëm të ulët të proceseve mendore dhe janë tejet të traumatizuar. Në këto kushte, ata humbasin aftësinë për të vepruar në mënyrë të pavarur, humbasin ndjenjën e identiteti personal, humbasin besimin tek vetja dhe aftësitë për t'u përballur dhe reaguar në situata të komplikuar. Si rezultat i ndikimit të traumës, viktimat shfaqin pasiguri dhe dyshim ndaj ndihmës që ju ofrohet dhe reagojnë me zemërim ndaj atyre që mundohen t'i ndihmojnë. Në disa raste ata janë të ndërgjegjshëm që kanë kryer veprime të paligjshme dhe për këtë arsye kanë frikë të përballen edhe me gazetarët.

Në këto kushte procesi i intervistimit të tyre nuk është i lehtë dhe duhet realizuar me shumë profesionalizëm.

Gjatë intervistimit duhet:

- të sigurohet fëmija se tashmë periudha e abuzimit dhe e keqtrajtimit të tij/ të saj ka marrë fund
- të sigurohet se që nga ky moment gjithshka bëhet për të mirën dhe në mbështetje të tij
- të sigurohet se askush dhe për asnjë arsye nuk do të abuzojë me të
- t'i jepet kohë për t'u ndjerë mirë dhe të tregojë eksperiencën e tij
- si edhe në rastet e tjera atij/asaj i duhet lënë të kuptojë se jemi të vëmendshëm dhe se e kuptojmë ata çfarë ai/ajo ka përjetuar
- të mos bëhen pyetje që e bëjnë të ndjehen keq
- të mos shfaqen paragjykime ose fajësime nga ana e profesionistit në kohën e intervistimit
- në asnjë rast nuk duhen konsideruar qëndrimet dhe reagimet e fëmijës si personale, ndaj profesionistit. Duhet mbajtur parasysh se ata vijnë nga eksperienca tepër të dhimbshme.
- në varësi të moshës mund të përdoren teknika të ndryshme komunikimi si vizatimet, ngjyrosjet apo lodrat qetësuese.

KAPITULLI VI

PUNA ME GRUPET PËR NDËRGJEGJËSIM DHE PARANDALIM

Hyrje

Ky kapitull trajton teorikisht dhe praktikisht punën me grupet si një element i rëndësishëm në procesin e ndërgjegjësimit dhe parandalimit të fenomenit të abuzimit të fëmijëve/adoleshentëve. Këtu janë përfshirë puna me grupe të ndryshme edukuese, socializuese, të rritjes, edukimi midis bashkëmoshatarëve të cilat përdoren më shpesh në praktikën me fëmijët/adoleshentët me nevoja të veçanta në mjediset shkollore.

6.1 GRUPET EDUKUESE

Qëllimi kryesor i grupeve edukuese është të ndihmojnë anëtarët të marrin informacion të ri dhe të mësojnë shprehi të reja. Ata përdoren në një sërë mjedisesh, si agjencitë e trajtimit, shkollat, azilet, institucionet e riedukimit dhe spitalet. Disa shembuj grupesh të tillë janë:

- Një grup edukimi seksual për adoleshentët, sponsorizuar nga një agjenci planifikimi familjar.
- Një grup i mirëqenies në punë i krijuar nga një punonjës social që drejton një program të mbështetjes ndaj punonjësve.
- Një grup për prindër të përkohshëm potenciale (kujdestarë), i sponsorizuar nga një agjenci për mirëqenien e fëmijëve.
- Një grup i sponsorizuar nga një agjenci planifikimi komunitar për të ndihmuar anëtarët e bordit për t'u bere më efektive.

Në shumicën e grupeve të tilla bëhen prezantime informacioni dhe njohurish nga ekspertët. Punonjësit përqendrohen si në nxënësin individual,

ashtu dhe në grupin si i tërë si mjet për mësim, përforsim dhe diskutim.

Anëtarët e grupit janë të lidhur nga një interes i përbashkët në materialin që duhet mësuar dhe nga karakteristika të përbashkëta, si të qenit adoleshent, anëtar bordi apo prind i përkohshëm potencial. Kur formojnë grupin, punonjësit marrin parasysh dijet e secilit si dhe nivelin e aftësive dhe të eksperiencës, që çdo anëtar të mund të përfundojë maksimumin. Nganjëherë zgjidhen anëtarë me nivel të ndryshëm njohurish për temën, kështu që fillestarët të mund të përfitojnë nga të përparuarit.

Vetë-hapja varion nga e ulët tek e moderuara. Zakonisht pritet e ulët, pasi materiali për t'u mësuar shihet si më i rëndësishëm se nevojat e anëtarëve për vetë-hapje. Megjithatë, nganjëherë punonjësit përdorin një model të personalizuar që thekson nevojat e çdo individi. Kjo është veçanërisht e vërtet në mjedise rezidenciale dhe institucionale ku funksionimi emocional ose social i anëtarëve është i dëmtuar.

Modele të tjera e theksojnë të mësuarit si një eksperience sociale dhe punonjësit fokusohen më shumë në veprimtarinë dhe diskutimet në grup sesa në metodat didaktike. Këtë model e përdorin shpesh punonjësit e qendrave komunitare për të tërhequr dhe ruajtur interesin e anëtarëve që marrin pjesë në grup për kënaqësi dhe pasurim personal.

6.1.1. Grupet edukuese midis bashkëmoshatarëve: Të mësosh nëpërmjet eksperiencës dhe fuqizimit.

Në grupet edukuese midis bashkëmoshatarëve përdoren një kombinim i argëtimit me metoda interaktive dhe të bërit eksperiencë, të tilla si luajtje rolesh, rrahje mendimesh, grupet levizëse, skenarë, të cilat u mundësojnë pjesëmarrësve të mesojnë “duke bërë” dhe në të njëjtën kohë zhvillojnë pronësi/autorësi të mesazheve të programit. Kjo metodë e të mësuarit dhe edukimit në grup është mjaft e përdorur me grupet e adoleshentëve dhe të rinjve.

Të mësuarit zhvillohet sepse pjesëmarrësit kanë mundësinë të bashkëveprojnë me njëri tjetrin dhe marrin në kontroll procesin e të mësuarit. Ata zhvillojnë vetëbesim për të shkëmbyer këndvështrimet e tyre me njëri tjetrin dhe drejtuar diskutimet bazuar në çështjet që lidhen me jetët e tyre. Lehtësuesit që e bejnë të mundur këtë proces duhet të jenë fleksibël me aktivitetet dhe përshtatjen e tyre me fokusin në çështjet që adoleshentët/të rinjtë dëshërojnë të adresojnë më thellësisht.

Objektivi kryesor i edukimit midis bashkëmoshatarëve është që ata të fuqizohen dhe përfshihen në ndryshimet që duan të shohin tek vetja dhe mjedisi i tyre. Kjo qasje është fuqizuese sepse u jep pjesëmarrësve “një zë”, stimulon vetëbesim se nevojat, këndvështrimet dhe opinionet e tyre dëgjoen dhe vlerësohen. Duke u trajnuar si edukatorë bashkëmoshatarë pjesëmarrësit aftësohen të shohin tek vetja potencialet për tu marrë role si model dhe persona që do të bëjnë nesër ndryshim. Ata kanë mundësinë të zhvillojnë shprehje të tilla si udhëheqja, palnifikimi, lehtësimi, komunikimi, dhe empatia.

Qasjet e edukimit midis bashkëmoshatarëve janë gjithashtu efektive sepse përdorin ndikimin e bashkëmoshatarëve në mënyrë pozitive. Në dallim nga lehtësuesit e rritur, edukatorët bashkëmoshatarë kanë status të barabartë me të adoleshentët e tjerë dhe mund të fitojnë kështu besim dhe kredibilitet. Ata shihen më pak si figura autoritare të cilët predikojnë nga një pozicion gjykues për mënyrën se si njerëzit duhet të sillen. Ata ndajnë referenca kulturore dhe flasin të njëjtën gjuhë si pjesëmarrësit në sesionet e tyre dhe mund të kuptojnë më mirë ndjenjat, mendimet dhe eksperiencat e tyre. Edukatorët mund të krijojnë kështu një mjedis ku adoleshentët ndihen rehat të eksplorojnë çështje të ndjeshme sic janë pabarazia gjinore ose çështjet e dhunës e bazë gjinore. Ata janë më të prirur që të ndihmojnë lidhin këto çështje me jetën e adoleshentëve.

6.2 GRUPET E RITJES

Grupet e rritjes iu ofrojnë mundësi anëtarëve të bëhen të ndërgjegjshëm për mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e tyre në lidhje me veten dhe të tjerët dhe t'i zgjerojnë dhe ndryshojnë ato. Grupet fokusohen në promovimin e shëndetit social-emocional dhe jo në kurimin e sëmundjeve/ simptomave. Disa prej këtyre grupeve janë:

- një grup ndjeshmërie (që synon të zhvillojë tek individët aftësinë për të shprehur ndjenjat dhe për të formuar lidhje emocionale) për prindërit;
- një grup qartësimi vlerash për adoleshentët;
- një grup për ndërgjegjësim i sponsorizuar nga një qendër komunitare për fëmijët.

Grupet e rritjes theksojnë vetë-përmirësimin dhe potencialin e qenieve njerëzore për të jetuar një jetë të plotë dhe realizuar, veçanërisht përmes përmirësimit të marrëdhënieve me të tjerët. Aty ofrohet një atmosferë

mbështetëse ku individët fitojnë thellësi mendimi eksperimentojnë me sjellje te reja, marrin feedback dhe rriten si qenie njerëzore. Lidhja në grup krijohet nga përkushtimi i anëtarëve për të ndihmuar secilin të zhvillojë dhe maksimizojë potencialet e tij.

Punonjësit zgjedhin ose anëtarë që kanë karakteristika të ndryshme dhe potencialin për të zgjeruar dhe pasuruar eksperiencat e te tjerëve, ose anëtarë me karakteristika të ngjashme për të rritur empatinë dhe mbështetjen brenda grupit. Në shumicën e këtyre grupeve vete-hapja varion nga e moderuar në e lartë dhe komunikimi është i fokusuar rreth anëtarëve.

6.4 GRUPET SOCIALIZUESE

Grupet socializuese i ndihmojnë anëtarët të mësojnë shprehje sociale dhe modele sjellje shoqërisht të pranueshme, që të mund të funksionojnë në mënyrë efektive në komunitet. Këto grupe shpesh përdorin veprimtari si lojëra, luajtje rolesh ose veprimtaritë në natyrë për t'i ndihmuar anëtarët të arrijnë qëllimet e tyre individuale. Nevojat personale të anëtarëve dhe qëllimet e grupit shpesh arrihen përmes veprimtarive të programuara dhe jo vetëm përmes diskutimeve në grup. Kështu, këto grupe përdorin modelin mësoj-duke-bërë.

Disa prej këtyre grupeve janë;

- Një grup veprimtarish i Organizatës së Rinisë Katolike.
- Një klub social për pacientet e jashtëm të një qendre psikiatrike.
- Një grup i Prindërve pa partnerë, që përfshin piknike, kërcim dhe veprimtari të tjera sociale.

Lidershipi i grupeve socializuese mund të jetë direktiv ose jodirektiv, në varësi nga kompleksiteti i veprimtarive të programit dhe i kompetencave të anëtarëve të grupit. Ky lloj grupi është një mjet për veprimtari, pjesëmarrje dhe përfshirje - dhe përmes këtyre anëtarët lidhen me njëri-tjetrin. Përbërja e grupeve socializuese mund të bazohet në interesat dhe nevojat e ngjashme të anëtarëve ose në eksperiencat e përbashkëta të ofruara nga një veprimtari e veçantë e programit.

Ekzistojnë të paktën tre forma të grupeve të socializimit: a) grupet e shprehive sociale, b) grupet e qeverisjes dhe c) grupet argëtuese ose rekreative. Në ndryshim nga llojet e tjera të grupeve, *grupet e shprehive sociale*

janë veçanërisht të dobishme për individët që janë të paaftë të komunikojnë në mënyrë efektive dhe për ata që e kanë të vështirë të përfshihen në marrëdhënie sociale të kënaqshme. Disa nga llojet e klientëve që mund të përfitojnë janë fëmijët e vegjël, adoleshentët e turpshëm dhe të vonuarit e lehtë të rritur. Veprimtaritë e programit ofrojnë ndërveprim dhe komunikim pa nevojën për komunikim direkt verbal.

LISTA E REFERENCAVE:

- Alberti, R., Emmons, M., Your perfect right, 6th edition, San Louis Obispo Calif. Impact., 1980.
- Bhasin. K., 2006. “Të Kuptosh përkatësinë gjinore”. Botim i GADC.
- Black, M.M. & Dubowitz, H. (1999). Child neglect: research recommendations and decisions. Nw H. Dubowitz, Neglected Children: Research, Practice, and Policy (2nd ed., pp. 261/267). Thousand Oaks: Sage Publications, Inc.
- Corey, G., Corey, M., Groups; processes and techniques, Brooks/Cole, 2010.
- Crosson-Tower, C. (2005). Understanding Child Abuse and Neglect (6 ed.). Boston: Allyn & Bacon, fq. 69.
- Erickson, M.F., & Egeland, B. (2002). ‘Child Neglect’. Në Berliner, L., Briere, J. N., Hendrix, C.T., Jenny, C.A., Myers, J. E., & Reid, T.A. (2002). Child neglect. APSAC Handbook on Child Maltreatment (2d ed., pp. 3-20). Thousand Oaks: Sage Publications, Inc.
- Garvin, D.C., Contemporary groupWork, Allyn and Bacon, 1997.
- Hamilton. C., Malby. S., & Ross. G., 2007. “Analysis of the Child Protection System on Albania”, UNICEF. The children’s legal center.
- Haxhiymeri. E., Kulluri. E., Hazizaj. A., 2005. “Abuzimi i fëmijëve në familje”, CRCA, IRÇRA. Joffe, M. (2002). ‘Child neglect and abandonment’. New Recognition of child abuse for the mandated reporter, eds. A.P. Giardino and E.R. giardino. St. Louis, MO: G.W. Medical.
- Ivey, A., Developmental strategies for helpers individual, family and network interweaving, Pacific Grove, Calif. Brooks/Cole, 1991.
- Ivey, A., Developmental therapy: theory and practice, San Francisco, Jossey-Buss, 1996

- INSTAT; UNDP (2013), "Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën"
- Kadushin, A., & Martin, J. A. (1988). *Child Welfare Services* (4 ed.). Boston, MA: Allyn & Bacon, fq. 26-28.
- Kirst-Ashman, K. K., & Zastrow, C. (2003). *Understanding Human Behavior and the Social Environment* (6 ed.). Belmont, CA: Wadsworth Publishing.
- Kulluri, E., 2008. *"Dhuna në familje; Incidenca, prevalenca dhe mekanizmat e përballimit të saj: Analizë cilësore e eksperiencave të grave të dhunuara*, Punim doktore (I pabotuar).
- Kulluri, E., et.al. "Shprehi të intervistimit dhe këshillimit", (përkthyer dhe përshtatur për studentët e Shkencave Sociale), Dituria, 2003.
- Kulluri, E., *"Cikël leksionesh në praktikën e punës sociale me grupet dhe komunitetin"*.
- Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
- Mandro, A., Kalaja, E., 2009. *"Dhuna në familje ndaj fëmijëve. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve-Manual Trajnimi"*, Botim i Qendrës Fëmijët Sot.
- MASH dhe Terre des Hommes (2009). Udhëzues praktik për mbrojtjen e fëmijëve. Tipografia g&k DOLLONJA. Fq. 213-215.
- Mara, B. A., & Winton, M. A. (2000). *Child Abuse and Neglect: Multidisciplinary Approaches*. Boston, MA: Allyn & Bacon, fq. 59-76.
- Mara, B. A., & Winton, M. A. (2000). *Child Abuse and Neglect: Multidisciplinary Approaches*. Boston, MA: Allyn & Bacon, fq. 87.
- Moore, E. (2009) *"Case management for community practice"* - Oxford University Press.
- National center on child abuse and neglect (1992). *Child abuse and neglect: a shared community concern*. Washington, DC: US Department of Health and Human Services.
- Qendra Kombëtare për Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve, 1992.
- QAGJZH, 2006. "Dhuna në familje. Një paraqitje e situatës aktuale në Shqipëri". Pegi. Tiranë.
- Qendra Kombëtare për Abuzimin dhe Neglizhimin e Fëmijëve, 1992.
- QAGJZH, 2005. "Unë nuk do ta godisja KURRË një grua...do të doja që im atë të thoshte të njëjtën gjë...!" Broshurë për fëmijët dhe të rinjtë. Pegi. Tiranë.

- Resolution on the need to establish a European Union Wide campaign for 0 tolerance of violence against women, 1997/10/06.
- Save the Children, Case Management Practice within Save the Children Child Protection Programmes, 2011.
- Sedlak, A. J., & Broadhurst, D. D. (1996). Third national incidence study of child abuse and neglect. Washington, DC: U.S. Department of Health and Human Development.
- Shehu. E., Gramo. A., 2008. *“Dhuna me bazë gjinore. Manual për punonjësit e shëndetësisë”*, Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë.
- Tahsini. I., 2010. *“Trajtimi dhe parandalimi i abuzimit të fëmijëve në shkollë përmes një qasjeje multidisiplinare – roli i punonjësit social shkollor, si anëtar i skuadrës multidisiplinare”*, Punim doktore (I pabotuar).
- Terre des Hommes, UNICEF, *“Protokolli i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve”*, 2010. Ministria e Punës,.
- Tamo. A., Karaj. Th., 2005. *“Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri”*, Qendra e Zhvillimeve Humane, UNICEF.
- Tahiraj. E., 2008. *“Fëmijët në Shqipëri”*, Botim i Qendrës ‘Fëmijët Sot’.
- Toseland, W. R., Rivas, F.V., An introduction in group work practice, 7th edition, Allyn and Bacon, 2011.
- USAID, Social Work Education and the Practice Environment in Europe and Euroasia, 2008.
- VKM nr. 334 datë 17.2.2011 *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”*.
- VKM nr.265 datë 12.4.2012 *“Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”*.

SHTOJCA I

ORGANIZATAT DHE STREHËZAT QË PUNOJNË ME VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE

TIRANE

- Qendra Kombëtare për Trajtimin dhe Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës në Familje
- Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza
(04) 2233 408
- Strehëza për Gratë dhe Vajzat
(04) 2261 885
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
(04) 2259 795
- Qendra Aleanca Gjnore për Zhvillim
(04) 2255 514
- Shoqata “Refleksione”
(04)2340434
- Të Ndryshëm & të Barabartë (trafikimi +DHF)
(04) 2221 892
- Shoqata “Në Dobi të Gruas”
(04) 22 475 02 / 022 409 53
- Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci”
(0355) 2400 712
- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
(04) 2242 264
- ALO 116 Telefoni i ndihmës për fëmijë
- Shoqata “Për Gratë dhe Fëmijët”
0672936699

DURRES

- Qendra Komunitare Sot për të ardhmen
(05)2 37003 / 069 20 94622 / 069 20 73421
- Qendra Sociale për Gra dhe Vajza
05223815

SHKODER

- Qendra e Gruas “Hapat e Lehtë”
022440 22
- Gruaja tek Gruaja
022411 54

KORÇE

- Fondacioni KENEDI
Rr “Niko Dodona, Korçë, Albania

POGRADEC

- Shoqata “Unë Gruaja”
083222 140

BERAT

- Qendra e Gruas “Kristal”
03231 004

ELBASAN

- Forumi i Gruas, Elbasan
054 255 509
- “Tjetër Vizion”
054 252919

VLORE

- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”
033 224 078

FIER

Me Ju dhe për Ju Vajza”

034 22 884

SARANDE

Forumi i Pavarur i Gruas

085 22 22 76

GJIROKASTER

Qendra Komunitare Gjirokaster

084668866

Kujt mund ti telefononi për ndihmë:

Telefononi policinë në numrin **129** ose urgjencën

Linja e Këshillimit për Fëmijë **116**

Shërbimet në Bashkitë e rretheve:

Bashkia Tiranë 08009888

Bashkia Durrës 08009888

Bashkia Shkodër 02241316

Bashkia Korçë 08003434

Bashkia Pogradec 083226927

Bashkia Fier 034410700

Bashkia Burrel 021723536

Bashkia Lushnje 08002325/035226008